

Strategjia e Zhvillimit të Qytetit të Fierit



Bashkia Fier

Adresa: Lagja Kastriot, Rruga Ramiz Aranitasi 15

Tel/Fax : +355 34 229 69

E-mail: bashkiafier@albaniaonline.net



Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit

Adresa: Rr. Dervish Hima, Kulla Ada, Apt. 11, K.P. 2995, Tiranë.

Web:

www.co-plan.org

Të gjitha të drejtat të rezervuara Bashkisë Fier.

Botimi i parë viti 2006

ISBN [katalogimi / regjistrimi]

Shtëpia Botuese: [emri dhe adresa]

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT

TË QYTETIT TË FIERIT

Strategjia e Zhvillimit të Qytetit të Fierit u përgatit në kuadër të Programit “Drejt një Qeverisjeje të Mirë Urbane (EGUG II), të zbatuar nga Bashkia e Fierit dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, në partneritet me Ministrinë e Brendshme (ish Ministria e Decentralizimit dhe Pushtetit Vendor) dhe Shoqatën e Bashkive Shqiptare (SHBSH).

Financuar nga Qeveria Holandeze përmes Ambasadës së Vendeve të Ulëta në Tiranë.



Strategjia e Zhvillimit të Qytetit të Fierit

Nje fjali vleresuese per kryetarin te bashkise Z. Baftjar Zeqo dhe drejtorin e Co-PLAN Z. Dritan Shutina. Psh. Qe kjo pune nuk do te ishte bere pa mbeshtetjen e te kryetari te bashkise z. dhe drejtorit.....

Nje fjali vleresuese per ambasadën si financuese permes projektit

Autorë: Eriselda Cobo (Bashkia Fier), Sotir Dhamo, Florian Nuri, Dritan Shutina, Indrit Faja, Jorida Cila, Rudina Toto (Co-PLAN)

Kontribues përmbajtësorë: Flamur Mato, Marinela Lena, Eriselda Cobo

Këshilli editorial: Rudina Toto, Dritan Shutina, Sotir Dhamo, Florian Nuri, [emer nga Bashkia Fier]

Supervizimi editorial: Rudina Toto

Editimi përmbajtësor: Indrit Faja

Editimi Gjuhësor: Indrit Faja, Olta Cakciri

Përkthimi dhe Përshtatja në Anglisht: Rebekah Lambert

Konsulentë të përkohshëm: Andre Herzog, Ferry van Wilgenburg, Frank Wältring

Realizimi Grafik në Kompjuter: Suad Barbullushi

Shtepia botuese: [emri]

Përpunimi Hartografik: GEO Consulting

Imazhi dhe komunikimi mediatik: NVS, Net Vision Studio

Publikues: Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit
Mirënjohje

Bashkia Fier i shpreh mirënjohjen dhe falënderimet të gjithë atyre që kontribuan në krijimin e Strategjisë së Zhvillimit të Qytetit të Fierit.

Ekipi Realizues i Programit: Dritan Shutina, Eriselda Cobo, Sotir Dhamo, Florian Nuri, Indrit Faja, Flamur Mato, Niketa Mucelli, Armida Saliaj, Jorida Cila, Rudina Toto, Anila Gjika, Bardhyl Leka;

Bashkia Fier:

Kryetari i Bashkisë Baftjar Zeqo dhe N/kryetarët Jani Fuli dhe Eriselda Cobo për përkushtimin në këtë proces;

Këshilli Bashkiak i Qytetit dhe Kryetaren e Këshillit Donika Ristani për mbështetjen e kësaj iniciative;

Grupin Menaxhimit të Programit të Zhvillimit të Qytetit të krijuar në Bashki i ngarkuar me koordinimin e përgjithshëm të procesit.

Administratën e Bashkisë për (bashkë)koordinimin e punës së grupeve tematike;

Kryetarët e katër Rajoneve të qytetit: Andrea Panda, Arqile Spiro, Maksim Zarka, Vejsel Toto ;

Individët dhe institucionet pjesëmarrëse dhe qytetarët:

Përfaqesuesit e shumtë të institucioneve publike, sektorit privat të biznesit, organizatave dhe komunitetit për përkrahjen e kësaj iniciative dhe rolin dhe kontributin e tyre unik përgjate procesit.

Televizionet lokale dhe mediat e tjera për krijimin e mundësisë për të komunikuar me publikun e gjerë dhe pasqyrimin e procesit me reportazhe dhe debate në studio përgjatë zhvillimit të Strategjisë.

Të gjithë qytetarët e Fierit.

“Qyteti Im, Shtëpia Imë” – Qëllimi ynë i përbashkët për një Fier të qëndrueshëm

Qyteti është një aktivitet i përbashkët ku çdonjëri përpiqet të përfshihet dhe të gëzojë përfitime. Procesi i zhvillimit të qytetit të Fierit në periudhën që pasoi vitin 1990 ishte mjaft i vrullshëm dhe shpeshherë mjaft i çrregullt. Për këtë arsye vendosëm të rikthejmë vëmendjen drejt objektivave afatgjatë, të cilët do të mund të garantojnë një zhvillim të qëndrueshëm të Fierit në të ardhmen. Në këtë kontekst, kjo strategji merr kuptimin dhe veprimin e mjetit themelor që analizon të sotmen dhe drejton qytetin e Fierit drejt së ardhmes së zhvillimit të tij.

Strategjia e zhvillimit të qytetit të Fierit ngrihet mbi një proces të shëndoshë konsultimi me përfaqësues të sektorit publik (institucionet) dhe sektorit privat të biznesit, me organizatat e zhvillimit dhe, në mënyrë të veçantë, me komunitetin e banorëve. Si e tillë, strategjia e zhvillimit është një mjet i rëndësishëm jo vetëm për sektorin publik, por për mbarë shoqërinë civile në Fier.

Qyteti i Fierit po lëviz drejt një të ardhmeje më të rregullt dhe më të sigurt. Strategjia e zhvillimit të qytetit është një hap i madh përpara dhe ky është vetëm fillimi. Ne arritëm të hartojmë një vizion të përbashkët për të punuar për të ardhmen e qytetit tonë. Ky vizion është pikëtakimi i interesave tona dhe njëherazi krijuesi i nismave të reja. Dialogu tashmë ka filluar dhe ne duhet ta vazhdojmë duke e zgjeruar vazhdi-

misht rrethin e njerëzve dhe institucioneve që marrin pjesë në të, sepse kjo do të bëjë më të lehtë që vizioni i përbashkët të shndërrohet në realitete të prekshme. Ne jemi të vetëdijshëm për angazhimin këmbëngulës që kërkohet nga ana jonë për të çuar përpara këtë proces.

Është një nevojë e qytetarëve tanë që të shohin “dritën e re” të transformimit të lëndës jetësore shoqërore, ekonomike dhe hapësinore të qytetit të Fierit, që kjo strategji përmban. Ne do të vazhdojmë të përpiqemi për të bërë të mundur që ky transformim të përfshijë njëllëj çdo qytetar. Ftoj çdo qytetar të reflektojë thellë dhe të bashkohet në përpjekjen tonë për transformim të udhëhequr nga motoja jonë “Qyteti im, Shtëpia ime” dhe nga qëllimet dhe interesat tona. Mbi të gjitha, ne jemi përpjekur dhe do të vazhdojmë të përpiqemi që të zgjojme në ndërgjegjen e çdo qytetari elementin më të rëndësishëm: dashurinë për qytetin.

Strategjia e zhvillimit të qytetit shpalos perspektiva të reja për qytetin, që shtrihen në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit Rajonal të Fierit dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin Social Ekonomik. Ne kemi krenarinë të pohojmë se kjo strategji e zhvillimit do të jetë një kushtetutë për qytetin e Fierit, e cila do të drejtojë dhe nxisë përpjekjet tona të vazhdueshme drejt qëllimeve të synuara.

Baftjar Zeqo
Kryetar i Bashkisë Fier
fjala e Co-PLAN

Vizioni për Zhvillimin e Qytetit të Fierit

Fieri, një e rëndësishme rajonale në sistemin poli-centrik të qyteteve përgjatë Korridorit Veri-Jug, qendër e rëndësishme shkëmbimesh dhe transporti prej dhe drejt tij në zemrën e zonës agroindustriale më të rëndësishme të Shqipërisë. Qendër e rëndësishme progresi, arsimit dhe kulture, që frymëzon dhe orienton zhvillimin rajonal nëpërmjet pajisjes së vazhdueshme me funksione të reja në harmoni me qendrat e tjera të rajonit.

Fieri, qytet i cili ka rindezur shpirtin e qytetarisë dhe është “qytet i banorëve” të tij, ku e ardhmja e qytetit kalon përmes fjalës së qytetarëve dhe është produkt edhe i vendimmarrjes së tyre, është fryt i integritetit social dhe i zgjidhjeve për nevojat e qytetarëve; Fieri, qendër urbane që pasurohet vazhdimisht me funksione të reja, hapësira publike dhe të gjelbra, kënde lojërash e ambiente argëtimi, jetë kulturore aktive; Fieri, qytet që u ka kthyer banorëve elementet më të rëndësishëm qytetformues dhe simbolet që përbëjnë thelbin e ekzistencës dhe identifikimit të tyre në vite, si Lumi Gjanica, lidhjet me Apolloninë, zona industriale, muzeu historik dhe biblioteka, ‘rrapenjtë’, kisha dhe xhamia, teatri Bylis, bar Rinia dhe qendra e qytetit; Fieri, qytet me infrastruktura dhe pa zona informale, ku të gjithë qytetarët, si në qendër edhe në periferi, kanë

akses të barabartë në shërbimet publike dhe sociale; Fieri, qytet ku transporti publik ka “revolucionarizuar” konceptimin hapësinor të qytetit dhe perceptimin e banorëve për të, cilësinë e ajrit nga ulja e ndotjeve të makinave dhe nivelin e zhurmave në qytet.

Fieri, qytet me prosperitet ekonomik i cili projektton të ardhmen mbi bazën e vlerave territoriale dhe shfrytëzimit të mençur të potencialeve ekonomike të agrobiznesit, tregtisë, tokës, turizmit bregdetar dhe kulturor, mjedisit të pastër dhe burimeve të çmuara natyrore. Kështu, Fieri ka krijuar një klimë të favorshme për fuqizimin e biznesit dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, gjë që ka rritur mundësitë për punësim dhe tërheqjen e investimeve nga brenda dhe jashtë vendit.

Fieri, qytet me burime njerëzore të kualifikuara në administratën publike dhe në sektorin privat dhe jo-qeveritar, të cilët bashkëpunojnë ngushtësisht me njëri-tjetrin dhe me qeverinë qendrore; qytet me një administratë që e mat suksesin e punës bazuar në strategjinë dhe objektivat të cilat bashkëndahen nga të gjithë qytetarët dhe në plotësimin e kërkesave të “qytetarëve-klientë”.

Përmbajtja

[Hyrje](#) 13

[Hyrje](#) 13

[KAPITULLI I PROFILI I ZHVILLIMIT TË FIERIT](#) 16

[Seksioni 1 Fieri: Një Rajonale](#) 18

[1.1 Vizioni](#) 19

[1.2 Mendimi qytetar](#) 19

[1.3 Profili i Qytetit: Zhvillimi Rajonal i Fierit](#) 19

[1.4 Problematika e zhvillimit rajonal](#) 22

[Seksioni 2 Fieri: Qytet i Banorëve të Tij](#) 23

[2.1 Vizioni](#) 24

[2.2 Mendimi qytetar](#) 24

[2.3 Profili i Qytetit: Proceset urbane dhe shoqërore në Fier](#) 25

[2.4 Problematika e zhvillimit urban dhe social](#) 54

[Seksioni 3 Fieri: Qytet i Mundësive të Zhvillimit](#) 55

[3.1 Vizioni](#) 56

[3.2 Mendimi qytetar](#) 56

[3.3 Profili i Qytetit: Ekonomia, burimet dhe mundësitë](#) 56

[3.4 Problematika e zhvillimit të qëndrueshëm](#) 66

[Seksioni 4 Fieri: Qytet me Qeverisje të Mirë Vendore](#) 67

[4.1 Vizioni](#) 68

[4.2 Mendimi qytetar](#) 68

[4.3 Profili i Qytetit: Qeverisja vendore](#) 68

[4.4 Problematika e zhvillimit të qeverisjes](#) 77

[KAPITULLI II FORMULIMI I STRATEGJISË](#) 78

[Seksioni 1 Vizioni dhe Qëllimet Strategjike të Zhvillimit të Qytetit të Fierit](#) 80

[1.1 Vizioni](#) 81

[1.2 Qëllimet dhe Objektivat Strategjike](#) 83

[Seksioni 2 Fieri në rrugëtimin e Zhvillimit të së Ardhmes](#) 85

[2.1 Zhvillimi i Fierit si Një Rajonale](#) 86

[2.2 Zhvillimi i Fierit si Qytet i Banorëve të tij](#) 88

[2.3 Zhvillimi i Fierit si Qytet i Mundësive](#) 94

[2.4 Zhvillimi i Fierit si Qytet me Qeverisje të Mirë](#) 100

[KAPITULLI III PORTOFOLI I PROJEKTEVE](#) 103

[EPILOG: Procesi i Hartimit të Strategjisë dhe Vazhdimësia](#) 139

[ANEKS 1: Analiza e Ndikimeve të Fuqive, Mundësive, Dobësive dhe Kërcënimeve të Qytetit të Fierit \(SWOT\)](#)

144

[ANEKS 2: Matrica e Qëllimeve, Objektivate, Programeve, Hapave/Projekteve Konkrete të Strategjisë së zhvillimit të Fierit](#) 148

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Vendndodhja rajonale e qytetit të Fierit	19
Figura 2: Problematika rajonale e zhvillimit	22
Figura 3: Rritja e qytetit të Fierit (1950-2005)	26
Figura 4: Shtrirja e zonave të reja (informale) në territorin e qytetit	26
Figura 5: Tipologjitë urbane të Fierit	27
Figura 6: Dinamika e rritjes së popullsisë në Bashkinë Fier (1991-2004)	30
Figura 7: Ndryshimi midis shtesës mekanike dhe asaj natyrore (1992-2004)	30
Figura 8: Pjesa e popullsisë së ardhur në Fier pas vitit 90	31
Figura 9: Arsyet e migrimit në Fier	31
Figura 10: Niveli i kënaqjes së popullsisë së ardhur me kushtet e reja	31
Figura 11: Niveli i papunësisë (1997-2002)	32
Figura 12: Shpërndarja e vendeve të punës sipas sektorit	33
Figura 13: Nivelet e punësimit në sektorin privat sipas gjinisë	35
Figura 14: Numri i familjeve të trajtuara me ndihmë ekonomike (2000-2002)	36
Figura 15: Një vlerësim i familjeve për gjendjen e tyre ekonomike	37
Figura 16: Struktura e pronësisë së banesave	38
Figura 17: Përbërja e stokut sipas llojit të banesës	39
Figura 18: Problematika e infrastrukturës fizike të qytetit vlerësuar nga banorët	40
Figura 19: Rrjeti i rrugëve të asfaltuara dhe të ndriçuara	41
Figura 20: Lidhja e banorëve me rrugë të asfaltuar	42
Figure 21: Rrjeti i furnizimit me ujë	43
Figura 22: Lidhja e banorëve me rrjetin e ujit dhe kanalizimeve	44
Figura 23: Mbulimi i shërbimit të pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave	46
Figura 24: Shpeshësia e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave	46
Figura 25: Niveli arsimor i popullsisë	48
Figura 26: Problematika arsimore vlerësuar nga banorët	49
Figura 27: Shpërndarja e distancave të shkollave në qytet	49
Figura 28: Shpërndarja e shërbimit të qendrave shëndetësore	50
Figura 29: Problematika shëndetësore vlerësuar nga banorët	51
Figura 30: Ecuria e çeljes së bizneseve të reja (1990-2004)	57
Figura 31: Vlerësimi i ecurisë së zhvillimit të ekonomisë nga biznesi (2002-2004)	57
Figura 32: Sektorët kryesorë të ekonomisë së Fierit	58
Figura 33: Shpërndarja e numrit të firmave sipas madhësisë	58
Figura 34: Tipi i pronësisë së biznesit	59
Figura 35: Shtrirja e aktivitetit të biznesit	59
Figura 36: Shpërndarja e zonave ekonomike dhe të prodhimit	60
Figura 37: Problematika kryesore mjedisore	63
Figura 38: Shkalla e njohurisë së biznesit për ndikimin në mjedis	64
Figura 39: Struktura organizative e Bashkisë Fier 2005	69
Figura 40: Niveli i mbështetjes së institucioneve vendore për biznesin	70
Figura 41: Vlerësimi i biznesit për nivelin e taksave	71
Figura 42: Vlerësimi i biznesit për taksën e sigurimeve shoqërore	71
Figura 43: Justifikimi i taksave me shërbimet	72
Figura 44: Koha e shpenzuar nga biznesi për procedurat administrative	72
Figura 45: Biznese që kanë marrë kredi	73
Figura 46: Vlerësimi i biznesit për kreditë	73
Figura 47: Vlerësimi i ndikimit të sistemit bankar në zhvillimin e biznesit	73
Figura 48: Vlerësimi për konkurrencën	74
Figura 49: Ndikimi i infrastrukturës në zhvillimin e biznesit	75
Figura 50: Shkalla e plotësimit të nevojave të komunitetit nga Bashkia	76
Figura 51: Paraqitja skematike e mekanizmit institucional në Bashkinë Fier	139

Lista e Tabelave

Tabela 1: Statusi i punësimit sipas gjinisë	34
Tabela 2: Punëkërkuës të papunë sipas gjinisë, grup-moshës dhe nivelit arsimor (2002)	35
Tabela 3: Burimet dhe shpërndarja e të ardhurave familjare	36
Tabela 4: Një nga vlerësimet mbi përmasën jomonetare të varfërisë (2004)	37
Tabela 5: Shpërndarja e banesave sipas sipërfaqes së banueshme	39
Tabela 6: Kostot mesatare të qirasë dhe shitjes së apartamenteve në Fier (2002)	40
Tabela 7: Komponentët e prodhimit dhe shërbimit të grumbullimit të mbeturinave	45
Tabela 8: Njësitë arsimore dhe regjistrimet sipas nivelit dhe llojit të arsimit (2003-2004)	47
Tabela 9: Niveli i arsimit të popullsisë	48
Tabela 10: Braktisja e shkollës (2003)	48
Tabela 11: Subjektet e reja sipas sektorëve (2002-2004)	57
Tabela 12: Shpërndarja e numrit të bizneseve sipas rajoneve (2005)	59
Tabela 13: Vlerësimi i ndotjes së mjeteve të transportit	65
Tabela 14: Ecuria e numrit të bizneseve dhe të ardhurave (2000-2006)	70

HYRJE

Konteksti

Transformimi i shoqërisë shqiptare pas ndryshimeve politike dhe makroekonomike që nisën në fillim të viteve '90 është i pranishëm dhe i gjithanshëm. Liritë dhe energjitë e reja të shoqërisë gjatë periudhës së tranzicionit ushqyen një rritje të vullshme urbane të qyteteve tona. Krahas urbanizimit, demokratizimi dhe decentralizimi janë dy faktorët e tjerë themelorë që kanë ndikuar thellësisht në kontekstin e zhvillimit të qyteteve dhe të qeverisjes së tyre në Shqipëri.

Zhvillimi i qytetit të Fierit, i cili analizohet dhe parashtrohet në këtë strategji, ka pësuar gjithashtu ndryshime të rëndësishme. Popullsia e tij është dyfishuar gjatë periudhës së tranzicionit dhe, si pasojë e një urbanizimi intensiv më së shumti informal, në strukturën urbane dhe hapësinore të qytetit të Fierit është imponuar një model i çrregullt zhvillimi. Një dukuri e cila shfaqet rëndom në qytet, në pakësimin dhe humbjen e hapësirave publike dhe zonave të gjelbra në pjesën e ndërtuar dhe, në mënyrë të theksuar, në konvertimin e tokës bujqësore dhe krijimin e zonave informale dhe pa shërbime në periferi. Hapësira të tjera, të tëra të braktisura, ish-industriale qëndrojnë të pashfrytëzuara në nevojën që t'u kthehet funksionaliteti si zona potenciale për zhvillim ekonomik dhe që të frenohet dëmtimi i mëtejshëm i mjedisit. Aq më tepër kur ndotja industriale e mjedisit është një nga çështjet më të mprehta për qytetin e Fierit.

Në këtë model zhvillimi dalin në pah gjithashtu edhe vështirësitë e mëdha me të cilat përballet një pjesë e popullsisë në sigurimin e strehimit, tokës dhe infrastrukturës bazë, krahas shërbimeve sociale dhe punësimit, të cilat ndikojnë në nivelin aktual ekonomik të popullsisë. Njëkohësisht ky zhvillim, në një masë të konsiderueshme jashtë kornizave ligjore dhe institucionale të qeverisjes, megjithatë jo jashtë vëmendjes publike, dëshmon edhe mosfunksionimin normal të mjeteve tradicionale të planifikimit të qytetit, siç është rasti i planit të mëparshëm rregullues të qytetit të Fierit hartuar në vitin 1989, dhe nevojën për të zhvilluar instrumenta në funksion të politikave konkrete që kontribuojnë në menaxhimin e procesit të transformimit urban dhe funksionimit më efikas të Fierit.

Në këtë kontekst, nevoja për një frymëmarrje të re, për të dalë nga problematika kaotike aktuale dhe për t'i dhënë rrugë një zhvillimi të ri dhe të organizuar, duke u orientuar në një dimension më afatgjatë të zgjidhjes së çështjeve dhe shfrytëzimit të burimeve, natyrshëm e çuan Bashkinë Fier të ndërmarrë hartimin e një strategjie të përgjithshme zhvillimi për qytetin. Aq më tepër në një kohë kur zhvillimi i qytetit po përqendrohet gjithnjë e më shumë në duart e vetë komunitetit dhe të Bashkisë Fier.

Procesi i decentralizimit, i parashtruar në Strategjinë Kombëtare të Decentralizimit dhe Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjeve Vendore (Nr. 8652, 2000), po fuqizon qytetet me një autoritet të ri vendimmarrjeje dhe një autonomi më të madhe fiskale. Decentralizimi synon në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe të qeverisjes vendore. Tashmë zhvillimi në nivel vendor ka kaluar si një përgjegjësi ekskluzive e vetë pushteteve vendore. Në të njëjtën kohë, reformat demokratike vënë edhe më shumë theksin në përfshirjen e qytetarëve në zonat urbane në procesin e vendimeve të zgjedhjes publike.

Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit të Qytetit të Fierit është një moment i shumëpritur. Në radhë të parë sepse kjo strategji është e para në tërësi dhe e para e këtij lloji në veçanti që ballafaqon zhvillimin e Fierit me realitetin e ri të krijuar pas vitit '90, duke plotësuar njëherazi boshllëkun e përgjithshëm në planifikim të periudhës së tranzicionit. Nga ana tjetër, kjo strategji pasqyron edhe një shkallë më të lartë të përvojës së grumbulluar gjatë kësaj periudhe në nivel vendor.

Çfarë është kjo strategji?

Por, për herë të parë, qytetit të Fierit i ofrohet një strategji e tillë, një kornizë afatgjatë, shumëplanëse dhe gjithëpërfshirëse zhvillimi, e cila barazpeshon çështjet strategjike të zhvillimit për të siguruar zgjidhje të qëndrueshme. Zhvillimi i qytetit të Fierit është analizuar me vetëdijen ndaj ndërvarësive të zhvillimit hapësinor, social dhe ekonomik, dhe vendimeve politike që ndikojnë në të; në përputhje me prioritetet

vendore të grupuara gjerësisht në katër fusha: zhvillimi urban, zhvillimi ekonomik, mjedisi, dhe arsimit dhe kultura; të para nga këndvështrimi i potencialeve, pikave të forta dhe të dobëta, shanseve dhe rreziqeve.

Strategjia e Zhvillimit të Qytetit të Fierit është hartuar duke i paraprirë lidhjes me zhvillimin hapësinor dhe ekonomik, sikurse parashtruar përkatësisht në Planin e ri Rregullues të Përgjithshëm dhe Planin e Zhvillimit Ekonomik të qytetit të Fierit¹. Kjo lidhshmëri ka bërë të mundur që të ketë një trajtim tërësor të problemit, përkundrejt një trajtimi të fragmentarizuar që do të çonte për pasojë në zgjidhje të njëanshme. Kjo strategji ka revolucionarizuar dhe reformuar konceptin dhe praktikën e planifikimit dhe të politikave të zhvillimit të qytetit të Fierit.

Informacioni dhe vizioni i strategjisë mundësojnë një qartësi më të madhe në rolin aktual dhe potencial të Fierit rreth drejtimeve të mundshme të zhvillimit të tij, duke mundësuar një bashkim dhe shpërndarje të burimeve publike dhe private të qytetit në fushat më prodhuese. Fieri është qytet me një zhvillim ekonomik në rritje. Potenciale të rëndësishme vijnë nga prania e biznesit të madh të suksesshëm dhe fuqitë për eksport, nga niveli i lartë i arsimit dhe rinisë, nga afërsia me zonën bregdetare e kështu me radhë. Struktura ekonomike e prodhimit ka ndryshuar nga industria e rëndë, me ndërmarrje të mëdha socialiste, në krijimin e një sërë bizneseve të sektorit privat, duke u orientuar drejt këtyre potencialeve.

Por kjo strategji nuk përfaqëson thjesht një dokument strategjik vizionar dhe qëllime të përgjithshme për zhvillimin e Qytetit të Fierit. Në mënyrë thelbësore, nëpërmjet projekteve për zbatim të parashtruara në këtë strategji, të cilat shtrihen në afatin e shkurtër, të mesëm, dhe të gjatë, strategjia bëhet udhërrëfyese kryesor në rrugën për zhvillimin e Fierit.

Për herë të parë, Qyteti i Fierit ka një strategji që nuk është vetëm një produkt por përfaqëson dhe një proces. Kjo strategji është hartuar nëpërmjet pjesëmarrjes dhe kontributit të mjaft palëve të interesuara. Duke sjellë krijimin e mekanizmave të rinj institucionalë për të nxitur ndërgjegjen e përbashkët qytetare dhe duke zbritur në nevojat e komunitetit në vend që të imponojë ide apo të neglizhojë këto nevoja, strategjia ka bërë

komunitetin pjesë në procesin e pandalshëm të zhvillimit. Ky proces është i rëndësishëm sepse ka bashkuar njëzëri mendjet e njerëzve mbi vizionin dhe prioritetet e zhvillimit të Fierit.

Strategjia ka shënuar tashmë fillimin e një faze të re në marrëdhëniet ndërmjet qeverisë vendore, shoqërisë dhe qytetarëve, bazuar në parimet demokratike të qeverisjes. Si e tillë, strategjia i shërben përmirësimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të vetë qeverisjes së qytetit, për të krijuar kapacitete të cilat të vazhdojnë të prodhojnë për rritje. Qëllimi përfundimtar në këtë nismë planifikimi afatgjatë është zhvillimi i një sistemi efikas dhe demokratik planifikimi që do të fuqizojë komunitetin në rolin dhe influencën e tij mbi mënyrën e caktimit dhe shpërndarjes së burimeve për zhvillim dhe mbi vendimmarrjen lokale.

Rëndësia

Në këtë vështrim të përgjithshëm, është e kuptueshme se kjo strategji nuk qëndron si një aktivitet dhe/ose dokument vetëm i Bashkisë. Strategjia aktuale është një pikë referimi dhe sinergjie për bashkërendimin e veprimeve jo vetëm brenda sektorit publik, por për të gjithë shoqërinë në Fier: spektrin e sektorit privat të biznesit, shoqërinë civile dhe, në veçanti, komunitetin qytetar; si dhe më gjerë, për inisiativat rajonale dhe kombëtare të parashtruara në dy dokumenta kyçe siç janë Strategjia Rajonale e Zhvillimit të Fierit (2003) dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Social Ekonomik (2003).

Strategjia e zhvillimit të qytetit të Fierit i drejtohet, pra, të gjithë këtyre palëve dhe pjesëmarrësve që kanë kontribuar në hartimin dhe do të vazhdojnë të kontribuojnë në zbatimin e saj; duke vështruar dhe planifikuar në mënyrë strategjike dhe duke vepruar në mënyrë konkrete, për të arritur një nivel të ri zhvillimi të qytetit të Fierit dhe mirëqenieje për të gjithë qytetarët e tij.

Dokumenti i strategjisë përmban tre kapituj. Kapitulli i parë, profili analitik, na njeh me zhvillimin aktual dhe çështjet kryesore të qytetit të Fierit. Kapitulli i dytë përshkruan vizionin e ardhshëm të qytetit të Fierit, qëllimet dhe objektivat strategjike dhe lidhjen ndërmjet tyre. Kapitulli i tretë, Portofoli i Projekteve, shtjellon projekte konkrete të zbatueshme që shkojnë në funksion të realizimit të qëllimeve dhe objektivave të strategjisë në afatin e shkurtër, të mesëm dhe të gjatë.

¹ Procesi i hartimit të Planit të ri të Përgjithshëm Rregullues që trajton dhe përcakton zhvillimin hapësinor të qytetit të Fierit ka vazhduar paralel me hartimin e strategjisë aktuale. E njëjta gjë edhe për sa i përket Planit të Zhvillimit Ekonomik Lokal.

KAPITULLI I

PROFILI I ZHVILLIMIT TË FIERIT

Qyteti i Fierit me të vërtetat e tij

Një ndër qendrat urbane kryesore në vend, Fieri ka pësuar transformime të rëndësishme gjatë një periudhe përtej dekadës së fundit. Rritja e qytetit është e evidentueshme gjatë kësaj periudhe, sikurse janë një sërë çështjesh dhe sfidash të rëndësishme që prekin aktualitetin dhe të ardhmen e zhvillimit të tij.

Çdo qytet përfaqëson një realitet të ndërlikuar dhe shumëplanësh që ndryshon në mënyrë të përditshme përgjatë trajektores së zhvillimit, një realitet ku njerëzit bashkohen dhe organizohen rreth nevojës për të ndarë një mirëqenie të përbashkët, sipas frymës së kohës. Në këtë kuptim, edhe njohja dhe vlerësimi i hollesishëm i qytetit paraqiten të ndërlikuar dhe për këtë arsye është e nevojshme që të vihen disa pika reference paraprake.

Kapitulli i parë analizon qytetin e Fierit në katër drejtime kryesore, të cilat përbëjnë njëherazi seksionet e këtij kapitulli, si më poshtë:

(i) Së pari, një vështrim i përgjithshëm në kontekstin rajonal të qytetit të Fierit, lidhur me pozicionimin e tij jo vetëm gjeografikisht dhe historikisht por edhe ekonomikisht;

(ii) Së dyti, qyteti i Fierit si shprehje e komunitetit për sa i përket ndikimit të individit qytetar në proceset urbane të qytetit;

(iii) Së treti, fuqitë kryesore zhvilluese të qytetit të Fierit, për sa i përket organizimit të burimeve dhe asetëve ekonomike, dhe qëndrueshmëria e tyre; dhe

(iv) Së katërti, qeverisja e qytetit dhe zhvillimi gjithëpërfshirës.

Çdo seksion udhëhiqet dhe orientohet nga një fragment vizionar dhe nga mendimi qytetar, të cilët reflektojnë tematikën përkatëse të seksionit dhe vendosin referencën e qytetit sot me perspektivën e dëshiruar. Analiza e informacionit sjell një vështrim kritik mbi ecurinë e zhvillimit, çështjet strategjike, problematikën dhe potencialet, të cilat rimerren në mënyrë të përmbledhur në fund të çdo seksioni dhe përbëjnë thelbin e hartimit të strategjisë në Kapitullin e Dytë.

Për sa i përket informacionit të përdorur në këtë analizë, krahas të dhënave zyrtare nga Bashkia Fier dhe burimeve të ndryshme zyrtare, janë shfrytëzuar gjerësisht edhe rezultatet e dy vrojtimit që u ndërmorën gjatë fazës së grumbullimit të të dhënave. Këto janë

përkatësisht Vrojtimi Social-Ekonomik dhe Vrojtimi i Biznesit. Të dy vrojtimit janë kryer me anë të metodës së intervistimit direkt të të anketuarve në terren, nëpërmjet pyetësorëve të strukturuar të përgatitur për këtë qëllim. Vrojtimet kanë mbuluar me shtrirjen e tyre të gjithë territorin e qytetit. Përzgjedhja e kampionit, brenda kategorive të caktuara, në të dy vrojtimit, si në rastin e familjeve edhe në atë të bizneseve, ishte rastësore, nëpërmjet programeve kompjuterike.

Vrojtimi Social-Ekonomik përfshiu 758 familje. Modeli statistikor i përzgjedhjes së familjeve u përgatit mbi bazën e kriterëve si vendndodhja dhe tipologjia e banesave, banesë formale/informale, dendësia e popullsisë, zonat me problematika të theksuara, kategoritë në nevojë, përfshirja e etnive të ndryshme etj. Vrojtimi mbulon disa fusha dhe problematika si varfëria, kushitet e jetesës, punësimi, arsimit, shëndetësia, mjediset argëtuese etj, me qëllim që të masë perceptimin dhe vlerësimin qytetar për këto çështje.

Vrojtimi i Biznesit përfshiu një numër prej 242 biznese, konkretisht: 63 biznese të mëdha, 152 biznese të vegjël dhe 27 biznese të palicensuar. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar përfshirjes në studim të bizneseve më të rëndësishme të qytetit si edhe garantimit të përfshirjes së sektorëve dhe llojeve të ndryshme të aktivitetit ekonomik. Informacioni i nevojshëm për hartimin e pyetësorit dhe përzgjedhjen e bizneseve është mundësuar nëpërmjet takimeve me zyrën e Tatim-Taksave në bashki, Degën e Tatim-Taksave (në nivel rrethi), si edhe me Dhomën e Tregtisë.

Si përfundim, vlen të theksohet se këto vrojtme u ndërtuan jo aq me qëllimin për të matur krejt saktësisht aspekte të caktuara se sa për të arritur në një përafërim të shëndoshë me realitetin e zhvillimit të qytetit të Fierit dhe për të sjellë perspektiva të ndryshme në këtë strategji. Mbi të gjitha, këto vrojtme do të shërbejnë për të lehtësuar ngritjen e një baze të dhënash për Bashkinë Fier (baseline), e cila do të monitorohet sistematikisht për të matur ndryshimin gjatë rrjedhës së zbatimit të strategjisë.

Seksioni 1 Fieri: Një Rajonale

Ky seksion përshkruan qytetin e Fierit në kontekstin rajonal. Ndikimet që vijnë në këtë kontekst nga “influenca territoriale” natyrorë dhe gjeografikë si dhe nga ata artificialë, të tillë si infrastruktura të rëndësishme rajonale dhe kombëtare, afërsia me qytete apo vendbanime të tjera ose me nyja të rëndësishme transportuale etj., janë faktorë të rëndësishëm të cilët hedhin dritë mbi perspektivën e zhvillimit të qytetit të Fierit. Këta faktorë krijojnë avantazhe konkurruese të mjaftueshme që Fieri të jetë një qendër progresi dhe faktor zhvillimi në rajon.

1.1 Vizioni

Fieri, një e rëndësishme rajonale në sistemin policentrik të qyteteve përgjatë Korridorit Veri-Jug, qendër e rëndësishme shkëmbimesh dhe transporti prej dhe drejt tij në zemrën e zonës agroindustriale më të rëndësishme të Shqipërisë. Qendër e rëndësishme progresi, arsimit dhe kulture, që frymëzon dhe orienton zhvillimin rajonal nëpërmjet pajisjes së vazhdueshme me funksione të reja në harmoni me qendrat e tjera të rajonit.”

1.2 Mendimi qytetar

Mendimi qytetar mbi perspektivën e zhvillimit të Qytetit të Fierit në rajon:

- *Drejtimet kryesore të zhvillimit të qytetit janë drejtimi perëndimor dhe jug-perëndimor, të orientuar nga zhvillimi i zonës turistike;*
- *Të bëhet lidhja më e mirë e mundshme e qytetit me superstradën Fier-Vlorë që ende nuk ka filluar të ndërtohet;*
- *Elemente identifikues të qytetit të Fierit: Lumi Gjaniçca, Apollonia, Uzina e Azotikut, uzinat e TEC-it, muzeu historik, bar Rinia, Albpetrol/ARMO, Biblioteka e vjetër, ish-Turizmi, ‘rrapenjtë’, kisha dhe xhamia, teatri Bylis dhe qendra e qytetit.*

1.3 Profili i Qytetit: Zhvillimi Rajonal i Fierit

Fieri është ndër qytetet kryesore në vend, aktualisht qyteti më i madh i trevës së Myzeqesë. Njëkohësisht është qendra administrative e Rrethit, Prefekturës dhe Qarkut

me të njëjtin emër¹. Qytetit shtrihet në rajonin perëndimor të vendit, në pjesën jugore të fushës së Myzeqesë, nga lumi Seman e deri në breg të Vjosës në jug dhe nga pjesa e sipërme e Mallakastrës në lindje e deri në detin Adriatik në perëndim. Nga pikëpamja administrative dhe territoriale, Qyteti i Fierit kufizohet me rrethet Lushnjë, Berat, Mallakastër dhe Vlorë, sikurse tregohet në Figurën 1 më poshtë.

Një ndër veçoritë më të rëndësishme të qytetit të Fierit është pozicioni i favorshëm gjeografik i tij. Historikisht Fieri ka shërbyer si një nyjë lidhëse me pjesën qendrore, jugore dhe jugperëndimore të vendit. Qyteti përshkohet nga tri arterie të rëndësishme komunikacioni: rruga nacionale veri-jug që lidh Tiranën me Gjirokastrën si dhe linjat hekurudhore, Tiranë-Ballsh dhe Tiranë-Vlorë. Kjo rrugë do të jetë një arterie e fuqishme transporti nga dhe në drejtim të Fierit. Një arterie e tërë e fuqishme transporti është gjithashtu ndërtimi i autostradës Lushnjë-Fier-Vlorë, e cila pritet të kalojë në një distancë afërsisht 5 km nga qendra e Fierit. Kjo përbën një ndër zhvillimet më të rëndësishme në periudhën afatshkurtër për qytetin e Fierit për sa i përket infrastrukturës transportuale jashtëqytetëse.

¹ Në kontekstin aktual të qeverisjes dhe administrimit të territorit në Shqipëri, Prefektura përfaqëson një institucion të deleguar të qeverisë (pushtetit qendror), i cili ndjek dhe mbikëqyr zbatimin e politikave të qeverisë, zbatimin e legjislacionit dhe të vendimmarrjes në nivel vendor. Nga ana tjetër, institucioni i Qarkut përfaqëson nivelin e dytë të qeverisjes, duke luajtur një rol që mund të përcaktohet si koordinues në nivel rajonal ndërmjet njësive të qeverisjes vendore të nivelit të parë. Në këtë nivel bëjnë pjesë komunat dhe bashkitë. Nga një këndvështrim territorial, ndërmjet Qarkut dhe Prefekturës nuk ka dallime për sa i përket territorit që kanë nën juridiksionin e tyre. Ndërsa Rrethi përfaqëson ndarjen e mëparshme administrative në vend, e cila për nga madhësia është më e vogël se sa Qarku. Megjithatë, të dhëna statistikore të ndryshme i referohen ende këtij termi.



Figura 1: Vendndodhja rajonale e qytetit të Fierit

- KUPI QARKU
- KUPI RRETHI
- KUPI KOMUNE

 BASHKIA FIER <small>SH. NR. 14/2009</small>	PLANI I PËRQJITISHËM PËRQJLLËS I QYTETIT FIER	
	HARTA ADMINISTRATIVE	
	<small>TITULLI I PARTES</small> KP-01	<small>DATA</small> 01.06.2015
	<small>ADGTO</small>  GJ. PALAJI, M. PËRLLI, P. PËRLLI, P. PËRLLI	
<small>QIS</small>  GEO CONSULTING		<small>QIS</small>  GEO CONSULTING

Pozicioni i rëndësishëm dhe i favorshëm i Fierit në rajon dëshmohej nga burimet historike më të hershme dhe nga lidhjet aktive të kësaj treve me brigjet italiane. Qyteti antik i Apollonisë i themeluar në shekullin 6 p.e.s, më tej kryeqendra historike e Fierit, njohu një zhvillim të rëndësishëm kulturor dhe ekonomik për kohën, si një qendër e rëndësishme tranziti ndërmjet botës mesdhetare dhe prapatokës ilire. Porti i madh i ndërtuar në bregun e lumit Vjosa lidhej me një sistem rrugësh, që përhapeshin më pas me shpejtësi në drejtim të vendit, ndër të cilat më kryesorja ishte dega jugore e rrugës Egnatia. Qendra e banuar "Fieri i Madh" që u krijua më pas në fushat buzë lumit Gjanica, duke qenë në kryqëzim të rrugëve, tërhoqi vendosjen aty të stacionit të dytë të degëzimit "Adriatika Novam" në rrugën Egnatia, që i siguroi lidhje Apollonisë me Dyrrahun.

Zhvillimi ekonomik e tregtar i Fierit, i cili prej kohërash njihej si qendër panairësh, ka ndikuar në formimin e Fierit sot si qendra më e madhe e tregtisë dhe industrisë në zonën e jugut. Në këtë kontekst gjeografik ndërthuren burime të pasura të naftës, burime hidrike, natyrore etj. Shfrytëzimi i tyre gjatë periudhës së socializmit e vendosi Fierin në rangun e qyteteve më të rëndësishme industriale dhe bujqësore në vend. Në vitet '60 në këtë rajon u ngrit një bazë industriale e rëndësishme që përbëhej nga industria e naftës, industria kimike, industria energjitike (termocentrali) etj.

Gjatë kësaj periudhe, një zhvillim shumë të rëndësishëm mori bujqësia, nxitur nga kushtet mjaft të përshtatshme për zhvillimin e këtij sektori në këtë rajon. Treva e Myzeqesë, në të cilën bën pjesë Fieri, arriti prodhime bujqësore mjaft të larta, duke u njohur në vend si "hambari i grurit". Terreni krejt fushor përgjatë lumit Gjanica, klima e butë dhe burimet e pasura hidrike të krijuara nga tre lumenjtë që përshkojnë qytetin, Vjosa, Gjanica dhe Semani, kanë krijuar me prurjet e tyre tokat mjaft pjellore në fushën e gjerë të Myzeqesë, të përshtatshme për të kultivuar të gjitha llojet e drithërave dhe kulturave të arave, pemëve frutore dhe vreshtave.

Pjesa fushore përfshin fushën e Myzeqesë së Vogël, Frakullës dhe Cakranit, ndërsa pjesa kodrinore përfshin kodrat e Ardenicës, vargun e kodrave të Radostinës, Pojanit dhe Peshtanit, kurrizin kodrinor të Varibobit dhe zonën kodrinore të Mallakastrës së Poshtme. Dy vargjet ndahen midis tyre nëpërmjet luginës së Lumit Seman dhe Lumit Gjanicë. Ndërkohë, mjedisi natyror dhe piktoresk që rrethon plazhin e Semanit në një distancë 18 km nga qyteti, në prani të një sërë lagunave me bimësi të larmishme dhe mjaft të populluara nga zogj shtegtarë dhe të rrallë, është një nga resurset më

të rëndësishme dhe më pak të shfrytëzuara.

1.4 Problematika e zhvillimit rajonal

Zhvillimi i Fierit merr një rëndësi të veçantë si qendra kryesore urbane në rajonin e Myzeqesë dhe një nga qytetet kryesore të Shqipërisë. Në kontekstin rajonal, zhvillimi i qytetit të Fierit mbështetet nga disa faktorë të rëndësishëm: pozicioni gjeografik i tij, si një lidhëse dhe ndërthurje e rrugëve për rrjetin e transportit rruqor dhe hekurudhor kombëtar për në jug dhe qendër të Shqipërisë; ndërtimi i superstradës Lushjë-Fier-Vlorë do të ketë gjithashtu një ndikim të rëndësishëm. Afërsia me bregdetin Adriatik të Semanit dhe portin e Vlorës, hapësirat e pashfrytëzuara bregdetare, si dhe elementët e pasur natyrorë dhe historikë në Fier dhe përreth tij janë ndër potencialet më të rëndësishme. Rivlerësimi dhe shfrytëzimi i këtyre avantazheve në përputhje me kushtet e reja ekonomike pas vitit 1990, krahas trajtimit të problematikës aktuale rajonale paraqitur në Figurën 2, krijon mundësi të reja zhvillimi për qytetin e Fierit, në perspektivën për të luajtur rolin e një poli tërheqës ekonomik, kulturor dhe njerëzor në rajon.




Figura 2: Problematika rajonale e zhvillimit

PERSHIRJE	DP ha
KENETA (LIGATINA)	2111.58
PYLL ME PISHA	390.28
ZONA EKONOMIKE	10.14
ZONE INDUSTRIALE PROBLEMATIKE	46.00
ZONE UJEMBLEDHESHE + UJE MBAJTESE	275.47
LIGENI	1.81
ZONA E TRENIT	16.52
ZONE BANIM BRENDA VIJES SE VERDHE	738.80
GRUMBULLIM MBETURINASH URBANE	1.14
KURORA E GJELBER	4195.32
LIGENI GJEMIS (I KRIPUR)	25.86
QENDRA TE BANUARJA JASHTE QYTETIT	1004.10
SERA	21.00

 BASHKIA E FERIT 14 100 14 20 14	PLANI BREGUESIOR QYTETI FER	
	PROBLEMATIKAT RAJONALE	
	KODI	DATA
	KP-02	01.06.2005
	FUNDI	BASHKIA FER
ASISTENT	ZEMER DITAN RUSTI (PËR ZHVLIMIN E MBETURIT)	
GE	GEO CONSULTING	



Seksioni 2 Fieri: Qytet i Banorëve të Tij

Instikti Njerëzor dhe Energjia Qytetare në Proceset Urbane në Fier

Ky seksion vijon me paraqitjen e qytetit të Fierit si shprehje e komunitetit. Përcaktimi i qytetit të Fierit në funksion të qytetarëve të tij është thelbësor, pasi janë qytetarët ata që me instiktin e tyre kanë populluar qytetin dhe kanë ndikuar në formimin e tij si vendndodhje dhe venbanim. Të parët e qytetit në këtë këndvështrim bëhet akoma dhe më i rëndësishëm duke u nisur nga fakti se gjatë periudhës pas vitit 1990 qyteti i Fierit ka tërhequr një numër të konsiderueshëm banorësh të rinj. Për këtë arsye është e rëndësishme të kuptohet se çfarë veçorish ka komuniteti i qytetit të Fierit dhe, akoma më e rëndësishme, se cilat janë çështjet që prekin zhvillimin e tij në kontekstin e proceseve urbane lidhur me kushtet e jetesës dhe nivelin social dhe ekonomik si dhe infrastrukturën dhe shërbimet sociale të cilat ofron qyteti i Fierit.

1.1 Vizioni

“Fieri, qytet i cili ka rindezur shpirtin e qytetarisë dhe është “qytet i banorëve” të tij, ku e ardhmja e qytetit kalon përmes fjalës së qytetarëve dhe është produkt edhe i vendimmarrjes së tyre, është fryt i integritit social dhe i zgjidhjeve për nevojat e qytetarëve; Fieri, qendër urbane që pasurohet vazhdimisht me funksione të reja, hapësira publike dhe të gjelbra, kënde lojërash/ambjente argëtimi, jetë kulturore aktive; Fieri, qytet që u ka kthyer banorëve elementet më të rëndësishëm qytetformues dhe simbolet që përbëjnë thelbin e ekzistencës dhe identifikimit të tyre në vite, si Lumi Gjanica, lidhjet me Apolloninë, zona industriale, muzeu historik dhe biblioteka, rrapenjtë, kisha dhe xhamia, teatri Bylis, bar Rinia dhe qendra e qytetit; Fieri, qytet me infrastruktura dhe pa zona informale, ku të gjithë qytetarët, si ata të qendrës edhe ata të periferisë, kanë akses të barabartë në shërbimet publike dhe sociale; Fieri, qytet ku transporti publik ka “revolucionarizuar” konceptimin hapësinor të qytetit dhe perceptimin e banorëve për të, cilësinë e ajrit nga ulja e ndotjeve të makinave dhe nivelin e zhurmave në qytet.”

1.2 Mendimi qytetar

Si e shikojnë banorët qytetin e tyre pas pesë vjetësh:

Nivel më të lartë mirëqenieje; më pak papunësi, sidomos ndërmjet të rinjve; mjedise të gjelbëruara; kënde lojërash/mjedise çlodhjeje dhe argëtimi; një jetë kulturore më aktive; pa probleme të infrastrukturës fizike; me një menaxhim më të mirë të territorit; ven-

dosje të shërbimit të transportit publik; ulje të nivelit të ndotjes; dhe sigurim të disa shërbimeve 24 orë.”

- *Shërbime të tilla si furnizimi me ujë të pijshëm, pastrimi dhe gjelbërimi i qytetit, transporti urban etj., të jenë publike*
- *Më shumë rëndësi brendësisë së lagjeve dhe ndërhyrje më e madhe në to*
- *Ndërhyrjet për përmirësimin e infrastrukturës rrugore në qytet të mos kufizohen vetëm në qendër, por të përfshijnë edhe periferinë.*
- *Rëndësi t'i kushtohet jo vetëm infrastrukturës fizike por edhe komponentit social të zhvillimit të komunitetit.*
- *Bashkia të sigurojë legalizimin e zonave informale*
- *Përmbytjet e shkaktuara nga Lumi Gjanica, shqetësim në zona të caktuara.*

2.3 Profili i Qytetit: Proceset urbane dhe shoqërore në Fier

2.3.1 Zhvillimi dhe struktura urbane e qytetit

Themelimi i Fierit si qytet në vitin 1864 lidhet me rënien e qytetit të Voskopojës, nga ku filloi një shpërngulje e grupeve të blegtorëve drejt fushave të Myzeqesë, të joshur nga klima e butë dhe kullotat si dhe nga pozita gjeografike e kësaj zone si pikë ndërthurjeje e rrugëve Lushnjë-Vlorë dhe Berat-Mallakastër-Skelë e Semanit. Ndërtimet simbol të kësaj periudhe janë Ura e Gurtë (1777) dhe Kisha e Shën Gjergjit (1781). Elemente të tjerë qytetformues me rëndësi ishin fusha e pazarit buzë Gjanicës, stacioni i rrugës Egnatia (Apolloni-Dyrrah) si dhe qendra e banuar që po lindte.



Pamje e Fierit nga viti 1939

Në vitin 1877, topografët italianë Tabolini dhe Monari konceptuan për herë të parë qytetin sipas një sistemi bashkëkohor, duke piketuar qendrën tregtare dhe rrugët e qytetit me forma të rregullta gjeometrike. Këto zhvillime kontribuan në tërheqjen e më shumë banorëve në Fier, kryesisht tregtarë, nga Berati, Gjirokastra dhe qytete të tjera. Në fillim të shekullit të njëzetë, Fieri kishte marrë një fizionomi më të plotë, me një arkitekturë moderne të godinave. Deri në vitin 1912 Fieri ishte një komunë (mydyrjet) dhe në vitin 1927 numëronte rreth 270 godina (shtëpi), me një popullsi prej 1510 banorësh.

Në vazhdim gjatë shekullit njëzetë, qyteti i Fierit filloi të rritej me ritme të shpejta. Nga 90 ha që ishte sipërfaqja e qytetit në vitin 1950, në prag të viteve '80 qyteti ishte shtrirë në rreth 300 ha; dhe aktualisht ka një sipërfaqe 899 ha, nga e cila 785,8 ha janë brenda vijës aktuale kufizuese të ndërtimit (Figura 3).

Pas vitit 1990, qyteti i Fierit pësoi një zhvillim të vrul-

Ishëm dhe të shfrenuar si pasojë e lëvizjeve të brendshme demografike dhe urbanizimit spontan që vijuan me ndryshimet e rendit politik dhe ekonomik në vend. Zona të reja me ndërtime informale dhe të çrregullta u shfaqën si një dukuri në të gjithë hapësirën e qytetit në periferi, sikurse tregohet në Figurën 4. Siperfaqja e zënë me ndërtime informale përlllogaritet aktualisht në rreth 200 ha. Qyteti i Fierit, si shumë qytete të tjera në vend, përballet me sfidën e rëndësishme të menaxhimit të rritjes së qytetit, duke siguruar zgjidhjet e duhura optimale përse i përket çështjeve ligjore, urbane, sociale dhe atyre ekonomike të krijuara.

Forma dhe organizimi i përgjithshëm funksional i qytetit të Fierit përcaktohen nga skeleti rrugor kryesor i tij i kombinuar, radial unazor dhe kuadratik. Arteriet qytetformuese dhe elementet orientues kryesorë të formës dhe zhvillimit urban të qytetit deri në ditët e sotme janë rrugët Tiranë-Vlorë dhe Seman-Patos, të cilat ndërpriten në qendrën e qytetit pothuajse në të njëjtën pikë me Lumin Gjanica. Këto arterie sigurojnë




Figura 3: Rritja e qytetit të Fierit (1950-2005)

lëvizjen e trafikut dhe, në njëfarë mënyre, përbëjnë aksin “gravitacional” të jetës sociale të qytetit. Korridori urban i hyrjes në qytet nga Tirana përfundon me bulevardin qendror të qytetit, që përcakton hapësirën urbane më të ndërtuar dhe ku përdorimet e tokës tenojnë të jenë të përziera.

Një problem aktual për qytetin e Fierit është zhvillimi i paintegruar dhe krejt i ndryshëm që haset në brendësi të zonave të ndryshme të tij, si pasojë e “barrierave” të krijuara ndërmjet Lumit Gjanica dhe vijës hekurudhore. Këto elemente kanë bërë që qyteti të funksionojë si i ndarë në tri pjesë – unitete. Pjesa ose


PLANI I PËRGJITHSHMËN RREGULLUES I QYTETIT FIER
 DETAJI I HARTES
RRITJA E QYTETIT NE 50 VITET E FUNDIT
 KODI: UR-02 DATA: 08.06.2008
 PUNIK: BASHKIA FIER
 ASISTENT: ZSHP/CAJLARI INSTITUTI PER ZHVILLIMIN E HARTIMIT
 GIS: GEO CONSULTING



Figura 4: Shtirirja e zonave të reja (informale) në territorin e qytetit

- ZONE BANIMI INFORMALE
- Rruge
- Vija kufizuese e ndertimeve
- Hekurudha

SIPERFAQJA E ZONAVE INFORMALE BRENDIA VIJES KUFIZUESE TE NDERTIMEVE : 200.87 ha

brezi midis lumit Gjanica dhe unazës ekzistuese të qytetit është më e vjetra në qytet dhe dendësia e ndërtimit aty është më e lartë. Pjesa nga linja hekurudhore në drejtim të perëndimit është zhvilluar kryesisht vitet e fundit, në të cilën janë shumë ndërtimet informale dhe ka një mungesë të përgjithshme të shërbimeve. Më e zhvilluar është pjesa midis lumit Gjanica dhe linjës hekurudhore ose brezi i mesit, i cili përshkohet nga arteria kryesore rrugore e qytetit, rruga Tiranë-Vlorë.

Struktura urbane e qytetit paraqitet me disa lloje tipologjish, të krijuara nga kombinimi i elementeve të sistemit rrugor me ndërtimet dhe hapësirat urbane gjatë evolucionit të qytetit (Figura 5). Duke u nisur

PLANI PËRQUTSHMËR PËRQULLUESI QYTETI FIER	
TITULLI HARTËS	ZONAT INFORMALE
KODI	UR-08
DATA	01.06.2005
PUNCI	BASHKË FIER
ASISTENT	DIPLOMANTË PËR ZHARRIMIN E HARTATIT
GIS	GEO CONSULTING




Figura 5: Tipologjitë urbane të Fierit


- QYTETI I HAPUR
- QYTETI KOPESHT
- QYTETI LABIRINT
- QYTETI ME OBORRE TE MEDHA

- Akse kryesore
- Akse kryesore Qyteti i Hapur
- Akse kryesore Qyteti i Kopesht
- Akse kryesore Qyteti Labirint
- Akse kryesore Qyteti me Oborre te Medha
- Hekurudha
- Vija kufizuese e ndertimeve

PERSHKRIMI	SIP ha
QYTETI I HAPUR	415.20
QYTETI KOPESHT	137.20
QYTETI LABIRINT	93.23
QYTETI ME OBORRE TE MEDHA	19.45
TOTALI	665.08

 BASHKIA FIER <small>Tel. +355 36 229 00</small>	PLANI I PERGJITHSEM RREGULLUES I QYTETIT FIER			
	TITULLI HARTES			
	TIPOLOGJITE URBANE TE FIERIT			
	KODI	UR-04	DATA	01.06.2005
	FUNDI	BASHKIA FIER		
ASISTO	Zyrtar Co-PLAN INSTITUTI PER ZHVLIMIN E HABITATIT			
GIS	GEO CONSULTING			

Figura 6: Dinamika e rritjes së popullsisë në Bashkinë Fier (1991-2004)



Të dhënat: Zyra e Gjendjes Civile Fier

nga pjesa qendrore dhe pranëqendrore e qytetit, situata i ngjan një “qyteti labirint”, pasi ndërtimet janë 4-5 katëshe dhe përshkueshmëria është shumë e ulët si pasojë e mungesës së hapësirave dhe shesheve publike.

Me largimin nga qendra shfaqen karakteristikat e një “qyteti me oborre të mëdha”, ku kërkesat për tregun e tokës kanë qenë më të ulëta dhe mbizotëron vetëm funksioni i banimit me pak përjashtime. Zonat e banimit dhe hapësirat publike kanë ruajtur fizionominë e ndërtimeve 4-5 katëshe të para viteve ‘90 dhe, për këtë arsye, në këto zona është e nevojshme ruajtja e identitetit.

Zonat e banimit me kopshte formojnë tiparet e një “qyteti kopësht”, me një sistem rrugor kryesisht kënddrejtë dhe mbizotërim të banesave të ulëta deri në 3 katëshe, të vendosura në blloqe kuadrate. Shpërhapja urbane që vërehet përgjatë rrugëve, të cilat përfundojnë në ambientin rural pranë qendrës, krijon një “qytet të hapur”, me ndërtime kryesisht informale që ndodhen më së shumti në kufirin e zonës periferike urbane dhe shpesh përzihen edhe me zonat ekonomike ose ish-ekonomike të qytetit. Për këto zona është i nevojshëm integrimi me pjesën tjetër të qytetit, nëpërmjet pajisjes me infrastrukturë rrugore. Nga ana tjetër, është i nevojshëm përcaktimi i qartë i kufijve të zhvillimit të mëtejshëm të këtyre zonave periferike, që do të jenë njëkohësisht edhe kufijtë e qytetit.


2.3.2 Demografia dhe urbanizimi

Fieri është ndër qytetet me ritmet më të shpejta të rritjes së popullsisë në vend. Në harkun kohor të 15 viteve të fundit popullsia pothuajse është dyfishuar. Në fund të vitit 2004, popullsia arriti në 82,262 banorë,

sikurse dëshmohet nga të dhënat e Gjendjes Civile ilustruar në Figurën 6. Vetëm ndërmjet vitit 1991 dhe 1992, popullsia u rrit në mënyrë të pazakontë me mbi 30%, duke kapërcyer kufijtë e rritjes në të gjithë dhjetëvjeçarët e mëparshëm. Ky moment përkon me lejimin e lëvizjes së lirë të popullsisë në vend, e cila ishte frenuar dhe kontrolluar për një kohë të gjatë në regjimin e mëparshëm komunist.

Popullsia vazhdoi të rritet me ritme të larta deri në vitin 1998, ritme që mesatarisht stabilizohen në 2.32%. Figura 7 në vazhdim tregon mbizotërimin e dukshëm të faktorit të migrimit në rritjen e popullsisë, ndërkohë që shtesa natyrore ka qenë pothuajse konstante, mesatarisht 0.77% për annum. Pas dobësimit të fluksit të migrimit, norma e rritjes u ul mesatarisht në 1% dhe në vitin 2002 balanca bëhet negative, pra numri i njerëzve që shpërngulen nga Fieri e tejkalon atë të të ardhurve në Fier. Si rrjedhim, shtesa natyrore bëhet faktori kryesor i rritjes së popullsisë. Shtesa natyrore, si balancë e lindjeve dhe vdekjeve, në Fier është përafërsisht 9.3 për 1000 banorë: lindjet janë 10.2 për 1000 banorë dhe vdekjet janë 4.01 për 1000 banorë.

Figura 7: Ndryshimi midis shtesës mekanike dhe asaj natyrore (1992-2004)



Të dhënat: Bashkia Fier, Zyra e Gjendjes Civile

LLOJET E TIPOLOGJIVE URBANE TË QYTETIT



Qyteti labirinth



Qyteti me oborre të mëdha



Qyteti kopësht




Qyteti i hapur



Pamje nga qendra

Figura 8: Pjesa e popullsisë së ardhur në Fier pas vitit '90



Burimi: Vrojtimi Social-ekonomik 2004


Duke pranuar normën mesatare të rritjes prej 0,74% të 5-vjeçarit të fundit, e cila mund të merret si një periudhë më e stabilizuar për sa i përket migrimit, parashikimi për rritjen e popullsisë së Fierit në fund të periudhës së ardhshme 15-vjeçare është përafërsisht 91,000 banorë¹. Si përfundim, rritja e ndjeshme e popullsisë është një prej çështjeve themelore për t'u mbajtur parasysh në zhvillimin e qytetit të Fierit.

Migrimi. Qyteti i Fierit është përshkruar nga një urbanizim i vrullshëm si rezultat i fluksit masiv të migrimit që u orientua drejt Fierit gjatë 15 viteve të fundit. Popullsia e ardhur në Fier pas vitit 1990 përbën sot rreth ¼ e popullsisë (Figura 8). Migrimi u nxit nga heqja e kufizimeve mbi lëvizjen e popullsisë dhe ishte më i theksuar nga fshatrat, pasi në zonat rurale jetesa ishte më e vështirë dhe kishte një mungesë të mjeteve të jetesës. Kjo gjë dëshmohej në Fier, ku 2/3 e familjeve të ardhura të anketuara janë nga zonat rurale përreth tij. Ky migrim ishte deri diku kolektiv në sajë të lidhjeve familjare.

Duke u nisur nga zhvillimi i Fierit si një qendër urbane e rëndësishme me një pozitë gjeografike të favorshme, një numër i madh banorësh u shpërngulën në Fier për të kërkuar një të ardhme më të mirë, sidomos për brezat e rinj, nëpërmjet mundësive më të mëdha të shkollimit dhe shërbimeve të tjera sociale, si dhe punësim dhe strehim, arsye të cilat paraqiten në Figurën 9.

¹ Skenarët më të plotë të rritjes së popullsisë për Bashkinë Fier do të ndërtohen duke marrë parasysh një sërë faktorësh ekonomikë, socialë, territorialë etj. Në parashikimin e popullsisë për Fierin do të përfshihen të dhëna demografike aktuale nga Gjendja Civile, REPOBA 2001 (Instat), si dhe të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë dhe Ndërtesave 2004 kryer nga Bashkia Fier.

Figura 9: Arsyet e migrimit në Fier



Burimi: Vrojtimi Social-ekonomik 2004


Pjesa më e madhe e migrantëve përbëjnë një grup popullsie relativisht të kënaqur me kushtet e reja në Fier, sikurse paraqitet në Figurën 10. Megjithatë, një tendencë e pritshme largimi (shpërnguljeje) nga qyteti i Fierit mund të shfaqet në vazhdim ose në një të ardhme të afërt. Kjo u vërejt në rreth 3.2% të familjeve të anketuara, të cilat kanë në plan të lëvizin nga qyteti i Fierit për arsye sociale, ekonomike, të lidhjeve familjare, gjendjes shëndetësore, kushtet e jetesës etj. Ky numër rritet edhe me 5% nga një pjesë tjetër e të anketuarve që dëshirojnë të lëvizin nga qyteti i Fierit por kufizohen për shkak të mundësive.

Ndryshimet e rëndësishme gjatë 15 viteve të fundit kanë ndikuar ndjeshëm në nivelin e përgjithshëm të jetesës në Fier për sa i përket punësim, të ardhurave të popullsisë, strehimit, kushteve të banimit, infrastrukturave, shërbimeve etj., të cilat janë shtjelluar në vazhdim.

2.3.3 Punësimi dhe të Ardhurat


Punësimi. Mundësitë më të mëdha për punësim ishin një nga shtysat kryesore të popullsisë së ardhur në Fier. Por megjithatë periudha e vështirë e tranzitit

Figura 10: Niveli i kënaqjes së popullsisë së ardhur me kushtet e reja



Burimi: Vrojtimi Social-ekonomik 2004

Figura 11: Niveli i papunësisë (1997-2002)




Të dhënat: Profili i Qytetit Fier 2002

cionit ekonomik ndikoi që papunësia të zhvillohej si një dukuri masive dhe e zgjatur në Fier. Luhatjet e papunësisë kanë qenë të shpeshta për shkak të reformave ristrukturuese në ndërmarrjet e mëdha të Nxjerrjes dhe Përpunimit të Naftës, TEC-it, Telekomit etj., si burime të rëndësishme punësimi në Fier. Papunësia zyrtare për periudhën 1997-2002, paraqitur në Figurën 11, pësoi rritjen më të madhe në vitin 1999 në 12.9% ose 10,542 vetë të papunë dhe në vitin 2002 ishte 10.1% ose 8,148 vetë të papunë.

Edhe 2-3 vitet e fundit karakterizohen nga një punësim jo në nivelet e duhura. Çështja e papunësisë evidentohet nga 92% e banorëve të anketuar si një ndër çështjet aktuale më shqetësuese për Fierin. Krahu i punës në Fier, i përbërë nga 67% e meshkujve dhe 60.8% e femrave në moshë pune, mbetet faktori më pozitiv

Figura 12: Shpërndarja e vendeve të punës sipas sektorit



Burimi: Vrojtimi Social-ekonomik 2004

në drejtim të punësimi¹.

Gjetja e një vendi pune, pavarësisht dallimeve dhe kualifikimeve të grupeve të ndryshme të popullsisë, paraqitet e vështirë si pasojë e numrit të pamjaftueshëm të vendeve të reja të punës të krijuara. Gjatë vitit 2004, sikurse rezulton nga vrojtimi i biznesit, punësimet e firmave luhateshin në vlera të ulëta prej 0.5 dhe 4 vetësh, përkatësisht për biznesin e vogël dhe biznesin e madh, ndërkohë që vetëm më pak se 40% e këtyre rasteve ishin vende të reja pune nga zgjerimi i biznesit. Në këtë situatë, struktura e punësimi për shumicën e familjeve ka ndryshuar pak në drejtim të punësimi, madje është në rënie. Vetëm për rreth 6% të familjeve të anketuara janë punësuar më shumë anëtarë, në sektorin formal apo informal. Si përfundim, as biznesi i vogël formal dhe as ai i palicensuar, duke ditur rëndësinë e tyre në ekonominë lokale, nuk janë burime masive dhe të sigurta punësimi për qytetin.

Strukturimi ose integrimi jo i plotë, shkalla relativisht e ulët e pjesëmarrjes së krahut të punës si dhe informaliteti, janë disa nga problemet më karakteristike të tregut të punës në Fier gjatë periudhës së tranzicionit. Sipas deklarimeve të të anketuarve ekonomikisht aktivë mbi punësimin e tyre, sektori formal dhe sektori informal konkurrojnë ndërmjet tyre përkatësisht me 59% dhe 41% të vendeve të punës² (Figura 12). Si i tillë,

1 Shifrat e paraqitura kanë si bazë llogaritjeje të gjithë anëtarët e familjeve të vrojtuar dhe janë rakorduar me përcaktimin "në moshë pune" për femrat 15-54 vjeç dhe për meshkujt 15-59 vjeç, sipas Vjetarit Statistikor, INSTAT 2003

2 Dallimi formal/informal që është bërë këtu bazohet mbi po-

Tabela 1: Statusi i punësimit sipas gjinisë

Nr.	Statusi i punësimit	Njësia	Mashkull	Femër	Total
1	Sektori shtetëror	Rastet	169	159	328
		% brenda seksit	15.4%	14.6%	15.0%
2	Sektori privat	Rastet	237	98	335
		% brenda seksit	21.6%	9.0%	15.3%
3	Ushtrim i një biznesi privat	Rastet	104	51	155
		% brenda seksit	9.5%	4.7%	7.1%
4	Punë e rastit	Rastet	74	6	80
		% brenda seksit	6.8%	.6%	3.7%
5	Pensionist	Rastet	21	90	111
		% brenda seksit	1.9%	8.3%	5.1%
6	I papunë punëkërkues	Rastet	140	169	309
		% brenda seksit	12.8%	15.5%	14.1%
7	I papunë që nuk kërkon punë	Rastet	17	259	276
		% brenda seksit	1.6%	23.8%	12.6%
8	Emigrant	Rastet	123	26	149
		% brenda seksit	11.2%	2.4%	6.8%
9	Tjetër	Rastet	4	6	10
		% brenda seksit	.4%	.6%	.5%
10	PA ¹	Rastet	207	226	433
		% brenda seksit	18.9%	20.7%	19.8%
Total		Rastet	1096	1090	2186
		% brenda seksit	100.0%	100.0%	100.0%

Burimi: Vrojtimi Social-ekonomik 2004

sektori informal, pavarësisht përcaktimeve mbi të dhe formave në të cilat shfaqet, ka një rëndësi të madhe për punësimin e një pjese të konsiderueshme të popullsisë në Fier. Nga ana tjetër, informaliteti i periudhës së tranzicionit përbën një nga sfidat kryesore të zhvillimit ekonomik për qytetin e Fierit, duke ndikuar në funksionimin normal të ekonomisë.


Karakteristika të mëtejshme të punësimit sipas statusit të punësimit pasqyrohen në Tabelën 1 e cila përfshin të gjithë anëtarët në moshë pune, 15-60 vjeç, të familjeve të vrojtura. Duke përgjithësuar mbi këto të dhëna, sektori shtetëror (publik) dhe sektori privat konkurrojnë ngushtë ndërmjet tyre, përkatësisht me 15% dhe 15.3% të të gjithë vendeve të punës. Në sektorin privat përfshihet gjithashtu ushtrimi i biznesit privat, me të cilin merren 7.1% e të anketuarve. Ndërsa, 3.7% e të anketuarve bëjnë punë të rastit, e cila reflekton një aspekt të informalitetit.

Të dhënat e mësipërme tregojnë dy kategori të papunësh si dhe dallime të rëndësishme për sa i përket pu-

himin nëse i anketuari paguan apo jo sigurimet shoqërore. Sipas këtij përkufizimi, "formal" është përdorur me kuptimin që i punësuarit i anketuar deklaroi se "derdh sigurimet shoqërore"; ndërsa "informal" janë personat që janë në marrëdhënie pune, por nuk derdhen sigurime shoqërore, pra këta persona nuk kanë një numër sigurimesh shoqërore dhe nuk janë pjesë e këtij sistemi.

nësimit apo papunësisë ndërmjet meshkujve dhe femrave. Të papunët punëkërkues përbëjnë 14.1% dhe të papunët që nuk janë në kërkim të një pune 12.6%. Në kategorinë e parë ndryshimi ndërmjet meshkujve dhe femrave është relativisht i vogël, përkatësisht në shifrat 12.8% dhe 15.5%. Ky dallim theksohet në mënyrë të ndjeshme në rastin e dytë të të papunëve që nuk janë në kërkim të një pune, ku spikat një mbizotërim i theksuar, pothuajse tërësor, i femrave me 23.8%. Kjo dukuri e grave të papuna (shtëpiake) që nuk kërkojnë punë, që mund të konsiderohet si pasojë i një mentaliteti kulturor të periudhës së tranzicionit, ul ndjeshëm pjesëmarrjen aktive në forcë pune të femrave në moshë pune duke rritur artificialisht papunësinë. Në mënyrë të ngjashme, edhe në zërin pensionist, që nënkupton

Figura 13: Nivelet e punësimit në sektorin privat sipas gjinisë



Burimi: Vrojtimi i Biznesit 2004

Tabela 2: Punëkërkuës të papunë sipas gjinisë, grupmoshës dhe nivelit arsimor (2002)

Kategoritë e punëkërkuësve		Numër	Përqindje
Total		8148	
Sipas gjinisë	Meshkuj	4816	40.8%
	Femra	3332	59.2%
Sipas grupmoshës	15-19	216	2.6%
	19-24	650	7.9%
	24-34	2094	25.7%
	mbi 34	5188	63.7%
Sipas nivelit arsimor	8-vjeçar	3902	47.8%
	i mesëm	2549	31.3%
	i mesëm profesional	1614	19.9%
	i lartë	83	1%

Burimi: Profili i Qytetit Fier 2002

personat në moshë pune (deri në 60 vjeç) të cilët kanë dalë në pension të parakohshëm, ka një mbizotërim të femrave.

Problemi i një papunësie më të përhapur tek femrat vjen edhe për shkak të mundësive të pabarabarta për punësim që shfaqen ndërmjet sektorëve kryesorë. Sektori publik (shtetëror) mbetet burimi kryesor që ofron punësim më të barabartë për femrat. Dallimet më të theksuara janë brenda sektorit privat, në firmat private apo dhe në drejtimin e një biznesi, sikurse tregohet në Figurën 13, ku numri i të punësuarve femra është 2-3 herë më i vogël se ai i meshkujve. Gjithashtu, kategoria punë e rastit mbizotërohet pothuajse tërësisht nga meshkujt.

Të dhënat zyrtare në Tabelën 2 pasqyrojnë edhe një dimension moshor dhe arsimor të papunësisë në qytetin e Fierit. Këto të dhëna tregojnë se mosha dhe arsimi ndikojnë në mënyra të ndryshme mbi papunësinë. Numri i të papunëve rritet në proporcion të drejtë me moshën e punëkërkuësve dhe nga ana tjetër ulet, po

në proporcion të drejtë, me rritjen e nivelit arsimor. Si rrjedhim, numri më i madh i të papunëve punëkërkuës haset në moshën mbi 34 vjeç, si dhe në ata të cilët kanë kryer vetëm arsimin e detyruar.


Të Ardhurat. Situata e mësipërme e punësimit është gjithashtu faktori kryesor që ndikon drejtpërdrejt në nivelin e të ardhurave të popullsisë. Duke filluar nga vitet 1990-91, vlen të theksohet se biznesi privat, prona private dhe emigracioni kanë kontribuar në mënyrë të ndjeshme në ekonominë familjare. Shpërndarja e të ardhurave familjare paraqitet në Tabelën 3. Pagat në sektorin shtetëror apo privat janë burimi kryesor i të ardhurave për më shumë se gjysmën e popullsisë. Biznesi familjar siguron të ardhura më të larta për rreth 18% të familjeve të anketuara. Emigracioni është një nga burimet më të rëndësishme për shumë familje gjatë periudhës së tranzicionit. Të ardhurat (dërgesat) nga emigracioni përlogariten afërsisht për 18% nga 21% e familjeve të anketuara në Fier, të cilat kanë të paktën një anëtar të familjes së tyre në emigrim.

Tabela 3: Burimet dhe shpërndarja e të ardhurave familjare

Nr.	Burimi i të ardhurave	Mesatarja mujore e familjes (Lekë)	% e familjeve të anketuara që disponojnë këtë burim
1.	Pagë	32,656	60.3%
2.	Pension	10,215	43.0%
3.	Pagesë papunësie	5,931	2.2%
4.	Asistencë sociale	3,288	3.6%
5.	Migram i brendshëm	10,409	3.2%
6.	Dërgesa nga emigracioni	22,475	17.8%
7.	Biznes familjar	44,008	17.5%
8.	Pronë	13,261	4.3%

Burimi: Vrojtimi Social-ekonomik 2004

Figura 14: Numri i familjeve të trajtuara me ndihmë ekonomike (2000-2002)




Të dhënat: Profili i Qytetit 2002

Familjet pa burime alternative të ardhurash trajtohen nga Bashkia, sipas ligjit, me ndihmë ekonomike (asistencë sociale). Sipas të dhënave zyrtare, për periudhën 2000-2002, numri i këtyre familjeve ishte përafërsisht 7-8% e gjithë familjeve në qytetin e Fierit dhe ishte në rënie (Figura 14). Në vitin 2004, siç shihet nga Tabela 3, numri i këtyre familjeve rezultoi 3.6%, duke treguar nga njëra anë një përmirësim të gjendjes ekonomike të më shumë familjeve dhe nga ana tjetër përmirësimin e sistemit të ndihmës ekonomike. Në 16% të rasteve, familjet e anketuara të cilat trajtoheshin me këtë lloj ndihme rezultoi se kanë siguruar tashmë burime të tjera të ardhurash, ku përfshihet edhe biznesi familjar.

Rrethanat e vështira të trashëguara nga regjimi i mëparshëm dhe tranzicioni i zgjatur janë ndër faktorët kryesorë të nivelit të ulët ekonomik që vërehet në një pjesë të konsiderueshme të familjeve. Sipas një klasifikimi të vetë familjeve të anketuara, ilustruar në Figurën 15, rezultoi se mbi 45% e familjeve ndodhen nën ose shumë nën "nivele mesatar", pothuajse 45% janë në "nivel mesatar", ndërsa një pjesë e vogël prej 10% janë "mbi mesataren e familjeve që i rrethojnë". Kjo situatë gjatë 3 viteve të fundit ka pasur përmirësim më të ndjeshëm vetëm në pak më shumë se 10% të familjeve të vërtetuara. Pjesa tjetër nuk ka ndryshim dhe, në më shumë se ¼ e rasteve, vërehet rënie në gjendjen ekonomike.

Vlerësime më metodike tregojnë gjithashtu se varfëria luhetet përafërsisht në të njëjtat nivele të larta që u vërejtën në vlerësimet e mësipërme. Duke aplikuar standardin e INSTAT mbi gjetjet e vërtetimit social-eko-

Figura 15: Një vlerësim i familjeve për gjendjen e tyre ekonomike



Burimi: Vërtetimi Social-ekonomik 2004

nomik, 11% e popullsisë në Fier mund të përkufizohet brenda varfërisë së skajshme dhe 30% brenda kufirit të plotë të varfërisë¹, çka gjen përputhje me vlerësimet e mësipërme "nën mesatare" dhe "mjaft nën mesatare". Sikurse vërehet, 36.4% ose mbi 1/3 e familjeve të anketuara kanë vështirësi financiare për plotësimin e nevojave të përditshme ushqimore. Ky nivel zbritet deri në "blerje me listë" të artikujve më jetikë të konsumit në 18.5% të rasteve, për shkak të pamundësisë së pagimit të tyre të menjëhershëm me para në dorë.

Një ndikim të ndjeshëm në përcaktimin e varfërisë kanë edhe komponentët jomonetarë. Banorët rendisin infrastrukturën e dobët, kushtet jo të mira të jetesës, që lidhen kryesisht me strehimin, praninë e zonave të paurbanizuara etj., si disa nga faktorët që ndikojnë në gjendjen e tyre ekonomike. Në përgjithësi, periferia e qytetit, në të cilën është përqendruar rreth 20% e popullsisë së anketuar, cilësohet si zona më e varfër e cila mbulohet pjesërisht ose aspak nga shërbimet publike bazë të ujësjellës-kanalizimeve dhe të pastrimit. Tabela 4 më poshtë pasqyron këta tregues jomonetarë të lidhur me nivelin dhe kushtet e jetesës së popullsisë. Situata e strehimit dhe e infrastrukturave fizike e sociale trajtohet gjerësisht në paragrafet në vazhdim.

2.3.4 Strehimi

Lëvizjet demografike dhe procesi i urbanizimit, njo-hja e pronësisë private mbi tokën, ndjekja e një politike për një ndërhyrje të vogël të shtetit në sektorin e strehimit, të gjithë këta faktorë kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në situatën e strehimit dhe tregun e banesave gjatë periudhës së tranzicionit. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, sektori privat, individët dhe ndër-tuesit privatë, kanë mbajtur peshën kryesore në procesin e sigurimit, shpërndarjes dhe konsumit të banesave

1 Për përllogaritjen e nivelit të varfërisë, në anketimin social-ekonomik janë përfshirë shpenzimet për ushqim, veshmbathje, fatura, arsim dhe argëtim.

Tabela 4: Një nga vlerësimet mbi përmasën jomonetare të varfërisë (2004)

Nr.	Komponenti	% familje
1.	Lidhje me rrjetin e ujit	80.8
2.	Lidhje me rrjetin e kanalizimeve	80.8
3.	Lidhje me rrjetin e energjisë elektrike	99.6
4.	Lidhje me/dalje në një rrugë të asfaltuar	56.7
5.	Lidhje me rrjetin e telefonisë fikse	53.8
6.	Ngrohje qendrore / kaldajë	2.5
7.	Rrjet kabllor	24.1
8.	Lidhje me internetin	3.6
9.	Çezmë brenda	93.4
10.	Çezmë jashtë	55.7
11.	WC brenda	94.8
12.	WC jashtë	15.5
13.	Gropë septike	17.7
14.	Pus individual / kolektiv	31.8

Burimi: Vrojtimi Social-ekonomik 2004


në Fier gjatë kësaj kohe. Privatizimi masiv, në vitin 1993, i banesave kolektive në pronësi shtetërore çoi në një mbizotërim të theksuar - në masën 92% - të banesave në pronësi private në strukturën e strehimit në Fier, e cila tregohet në Figurën 16¹.

Mbivlerësimi i rolit të tregut privat në strehim ka ndikuar në pakësimin e banesave publike (sociale); banesat në qira private në Fier konsiderohen në rreth 6% dhe ato në qira publike, të subvencionuara nga shteti, janë në një përqindje pothuajse të papërfillshme. Si pasojë, kjo situatë nuk i ka shërbyer zgjidhjes së qëndrueshme të çështjes së strehimit për një numër të madh familjesh të pastreha në qytetin e Fierit, duke qenë se edhe mundësitë dhe gama e zgjedhjes së formave të tjera të strehimit është e kufizuar, sidomos për kategoritë ose shtresat e popullsisë në nevojë.

Bashkia Fier në vitin 2003 kishte një numër prej 1,600 familjesh të regjistruara të pastreha. Numri i vërtetë i të pastrehëve vlerësohet të jetë edhe më i madh pasi, në vitin 2004, 75% e banorëve të intervistuar evidentojnë si problem praninë e një numri të madh familjesh të pastreha në qytet. Në stadin aktual, ndërhyrja e autoriteteve vendore për zgjidhjen e çështjes së strehimit të kësaj pjese të popullsisë ka qenë e kufizuar për

1 Privatizimi i banesave në qira shtetërore në vitin 1992-93 u zbatua nëpërmjet ofrimit të së drejtës për të blerë nga qeveria, me çmime nominale, familjeve që jetonin në to. Privatizimi i shpejtë brenda një viti i mbi 97% të banesave në bashkëpronësi (qira) në zonat urbane, në shkallë vendi kishte si synim nxitjen e krijimit të tregut privat të banesave.

Figura 16: Struktura e pronësisë së banesave




Burimi: Vrojtimi Social-ekonomik 2004

shkak të kompetencave ligjore dhe mundësive financiare². Kështu, miratimi i tre shesheve nga Bashkia për ndërtimin e 45 apartamenteve në banesa sociale nuk është realizuar për mungesë fondesh.

Në këto kushte, një pjesë e mirë e popullsisë, sidomos banorët e ardhur pas vitit 1990, e kanë zgjidhur vetë strehimin me anë të kontributit të tyre. Megjithatë, zgjidhjet "private" të pakoordinuara gjatë periudhës së tranzicionit çuan në krijimin e mjaft problemeve.

2 Për sa i përket strehimit, autoritetet vendore kanë për detyrë të sigurojnë: përpilimin e listave të të pastrehëve në territorin e tyre dhe paraqitjen e këtyre listave rregullisht ministrisë përkatëse, për të planifikuar buxhetin, si dhe Entit të Banesave dhe Bankës së Kursimeve; zbatimin e ligjit në rast mospagimi ose zënieje në mënyrë të paligjshme nga banorët të një banese ndërtuar nga Enti; ofrimin nga Enti të tokës publike për ndërtim banesash për të pastrehët; dhe, së fundi, miratimin e planeve urbane dhe lejeve të ndërtimit për sektorin privat dhe kontrollin e zbatimit të lejeve të ndërtimit.

Figura 17: Përbërja e stokut sipas llojit të banesës



Burimi: Vrojtimi Social-ekonomik 2004

Një ndër problemet më të mprehta, i përhapur edhe në qytetin e Fierit, është ai i ndërtimeve informale (të jashtëligjshme). Krijimi i zonave informale tregon qartë mosfunksionimin si duhet të sistemit të strehimit gjatë periudhës së tranzicionit, si pasojë e mungesës së ndjeshme të një strehimi social (banesave në qira publike) si zgjidhje alternative strehimi për shtresat më nevojtare, si dhe e mungesës së mekanizmave të qartë rregullatorë të tregut.

Probleme të mëtejshme evidentohen edhe në stokun ekzistues të banesave nëpër qytet. Situata mjaft deficitare në të gjitha aspektet e strehimit, mbar-tur nga periudha para viteve '90, ka krijuar nevojat të mëdha për mirëmbajtjen e banesave. Në Figurën 17 tregohet përbërja e stokut ekzistues dhe parapëlqimet e familjeve të vrojtuar për llojin e banesës (banimit). Të shtyra nga kushtet aktuale të banimit nën nivelin e duhur dhe nga nevojat për strehim, familjet shpeshherë kanë ndërmarrë zgjedhjen e formave të ekstremizuara, për shembull duke ndërtuar shtesa nëpër pallatet në bashkëpronësi. Ndërhyrjet e individëve privatë në këto banesa dhe në banesat në tërësi, në të shumtën e rasteve kanë shkaktuar mangësi dhe një çrregullim

Tabela 5: Shpërndarja e banesave sipas sipërfaqes së banueshme

Sipërfaqja e banimit (m ²)	Stoku i banesave (%)
deri në 39	7.5
40-69	44.6
70-99	31.7
100-130	10.8
mbi 130	5.4

Burimi: Vrojtimi Social-ekonomik 2004

të theksuar të kushteve tekniko-urbanistike dhe ligjore në qytet.

Në përgjithësi, nga vrojtimi rezulton se të paktën 1/3 e banorëve të anketuar jetojnë në kushte banimi të këqija ose të papërshtatshme, në sipërfaqe banimi të pamjaftueshme, dhe nuk kanë mundësi për strehim për shkak të çmimeve të larta në treg. Sipërfaqet mesatare të banimit në bazë të të dhënave të vrojtimit tregohen në Tabelën 5.

Në Tabelën 6 pasqyrohen çmimet mesatare në tregun e banesave në qytetin e Fierit në vitin 2002. Çmimet më të larta vërehen sidomos në tregun privat të banesave të reja, i cili është furnizuesi kryesor i ofertës së strehimit dhe, në këto kushte, financimi i një banese bëhet i vështirë në raport me nivelin ekonomik të popullsisë nevojtare për strehim.

2.3.5 Infrastruktura Fizike dhe Shërbimet Sociale


Zhvillimet demografike gjatë periudhës së tranzicionit në Fier i kanë rritur ndjeshëm nevojat e popullatës për infrastrukturë dhe njëherazi presionin për plotësimin e tyre nga Bashkia Fier, aq më tepër që infrastruktura vendore dhe shërbimet publike ekonomike, sociale dhe kulturore, tashmë janë përgjegjësi ekskluzive e pushtetit vendor. Si pasojë e tendencave të mësipërme, në të gjithë elementet e ekosistemit urban ka ndodhur një përmbysje e balancave ekzistuese, gjë që ka ndikuar ndjeshëm në treguesit e standardeve

Tabela 6: Kostot mesatare të qirasë dhe shitjes së apartamenteve në Fier (2002)

Lloji i banesës	Apartamente të përdorura		Apartamente të reja
	Çmimi i qirasë (Lekë/muaj)	Çmimi i shitjes (në mijë lekë)	Kostoja e shitjes
1 dhomë + kuzhinë	6,000-7,000	1,500-1,800	
2 dhoma + kuzhinë	8,000-10,000	2,000-2,500	
3 dhoma + kuzhinë	12,000-15,000	2,700-3,000	
Enti i Banesave			20,000 (Lekë/m ²)
Tregu privat			300-350 (\$/m ²)

Burimi: Profili i Qytetit Bashkia Fier 2002

Figura 18: Problematika e infrastrukturës fizike të qytetit vlerësuar nga banorët



Burimi: Vrojtimi Social-ekonomik 2004

të jetesës urbane në Fier. Rrjedhimisht, ndërsa niveli i urbanizimit është rritur, cilësia dhe mënyra urbane e jetesës në përgjithësi është ulur¹.

Infrastrukturat bazë si furnizimi me ujë të pijshëm, kanalizimet, energjia elektrike, rrugët, pastrimi i mbeturinave, transporti publik, vlerësohen si të pamjaftueshme prej më shumë se 2/3 të popullsisë së anketuar. Problematika aktuale e infrastrukturave në Fier paraqitet në një shkallë rritëse, sipas këtyre komponentëve, në Figurën 18 më poshtë.

Rrjeti rrugor dhe transporti. Rrjeti rrugor i qytetit të Fierit ka një gjatësi totale prej 49,730 ml². Rrugët e kategorisë së I (parësore) të cilat përballojnë ngarkesën e trafikut në shkallë të mesme dhe të lartë dhe lidhin qendrën e qytetit me rrugët kryesore rurale që hyjnë në Fier kanë një gjatësi 15,530 ml; rrugët e kategorisë së II (dytësore) të cilat përballojnë trafikun mbledhës/shpërndarës ndërmjet rrugëve parësore si dhe realizojnë ndërlidhjet përreth njësive të rëndësishme të qytetit kanë një gjatësi 11,770 ml; dhe rrugët e kategorisë III (terciare) të cilat kanë kapacitet të ulët, të destinuara për hyrje në zonat lokale, kanë një gjatësi 22,430 ml.

Sikurse evidentohet ne Figuren 19, rrugët e brendshme të asfaltuara shtrihen në mënyrë të çrregullt vetëm në zonat qendrore të qytetit, dhe mungojnë në

mënyrë të ndjeshme në zonat e tjera të qytetit. Për sa i përket ndriçimit publik, me përjashtim të hapësirës qendrore të qytetit, mungesa ose pamjaftueshmëria e tij në zonat e tjera është gjithashtu e theksuar.

Si pasojë e mungesës së një rrjeti uniform rrugësh për të gjithë qytetin, rreth gjysma e familjeve të vrotuara rezultojnë të kenë një akses të kufizuar në rrugët e asfaltuara (Figura 20) Nderkohë, edhe mungesa e ndriçimit në lagjet të ndryshme të qytetit paraqet një problem i cili u evidentua nga 85% e familjeve të vrotuara.

Rritja urbane dhe zgjerimi i qytetit të Fierit ka sjellë gjithashtu nevojën e vendosjes së sistemit të transportit publik urban në qytet, çka përbën një nevojë kolektive të banorëve. Në pjesën më të madhe, 2/3 e banorëve lëvizin nëpër qytet në këmbë dhe pjesa tjetër përdorin mjetet e motorizuara private. Sipas Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor në Fier, në vitin 2002 numri i mjeteve të transportit kishte arritur në 10,857 gjithsej, çka shënonte një shtim të tyre me rreth 20%. Aktualisht, transporti publik urban realizohet kryesisht nga autobusët publikë me një kapacitet prej 60 vendesh dhe minibusët me një kapacitet prej 9 vendesh. Përmirësimi i shërbimit të transportit publik lidhet kryesisht me përmirësimin e kushteve të lidhjeve midis pjesëve më skajore të qytetit.

1 Migration in Albania, Research Publication, INSTAT 2001
 2 Klasifikimi i rrugëve në përputhje me kategoritë e përmendura më sipër është kryer nga Instituti i Studimeve të Transportit mbi bazën e nxjerrjes së inventarit të rrugëve nëpërmjet një inspektimi vizual të të gjithë rrjetit të rrugëve urbane.




Figura 19: Rrjeti i rrugëve të asfaltuara dhe të ndriçuara

GJENDJA E RRUGES

- Rruge me asfalt
- Rruge me asfalt dhe ndricim
- Rruge me ndricim
- Te tjera

QJENDJA E RRUGES	QJERTESIA (M)
RRUGE ME ASFALT	10687.9
RRUGE ME ASFALT DHE NDICIM	8606.5
RRUGE ME NDICIM	816.5
TE TJERA	82236.9
TOTALI	110028.8


- Vija kufizuese e ndertimeve
- Rrugët nacionale jashtë qytetit
- Hekurudha

		PLANI PËRZAFITIMOR BREGALLIJE I QYTETIT PËR: RRJETI I RRUGËVE TË ASFALTUARA DHE RRUGËVE TË NDICIUARA	
STATUSI	IV-06	DATA	15.04.2022
PROJEKTUESI	DEE CONSULTING	PRANO	BALLORE PËR
QJENDJA	DEE CONSULTING	QJENDJA	DEE CONSULTING

Për sa i përket transportit hekurudhor, ky sektor ka pësuar një rënie të përgjithshme në nivele minimale. Shpeshësia e trenave është mjaft e ulët dhe lidhja me qytetin e Ballshit funksionon vetëm për transport mallrash. Si pasojë, gjendja e stacionit hekurudhor të pasagjerëve dhe të mallrave është tepër e degraduar, pasi pjesa më e madhe e objekteve dhe mjediseve janë jashtë funksionit. Kjo bën që transporti ndërqytetës të zhvillohet, në pjesën më të madhe, në kushtet e mungesës së sigurisë së orareve dhe të komoditetit për pritjen e pasagjerëve.

Figura 20: Lidhja e banorëve me rrugë të asfaltuar

■ me dalje ne rrugë te asfaltuar ■ pa dalje



Burimi: Vrojtimi Social-ekonomik 2004

Furnizimi me ujë dhe kanalizimet. Sistemi ujësjellës i qytetit të Fierit ka një kapacitet të përgjithshëm 9,800 m³, i cili mbahet në tre depozita qendrore në Qafën e Koshovicës, ndërsa burimi i furnizimit të ujësjellësit është shtrati i lumit Vjosa. Furnizimi i përgjithshëm ditor i popullatës me ujë arrin në 5-6 orë gjithsej dhe ky kufizim përbën furnizimin normal të popullsisë të trashëguar nga sistemi i mëparshëm. Gjithashtu, cilësia e ujit të pijshëm është nën nivelet e dëshiruara, megjithëse 70% e popullsisë e përdor ujin e rrjetit për të pirë.

Ujësjellësi i Fierit i ndërtuar në vitin 1965 ishte parashikuar që të furnizonte një popullsi prej rreth 35 mijë banorësh, termocentralin, zonën industriale si dhe fshatrat përgjatë rrugës që përshkonte. Sistemi i ujesjellesit eshte i amortizuar në masën 40%, ndërsa sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza eshte i amortizuar në masën 70% për shkak të mungesës së investimeve kapitale prej më shumë se 20 vjetësh. Për përmirësimin e shërbimit drejt furnizimit të pandërprerë të qytetit me ujë synohet rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të brendshëm, duke përfshirë zonat e banimit të ndërtuara rishtazi në periferinë e qytetit. Megjithate, mbulimi i qytetit nga rrjeti i ujësjellësit është ende i kufizuar sikurse tregohet në Figurën 21.

Si pasojë e mungesave të mësipërme në furnizimin me ujë dhe kanalizime në të gjithë qytetin, deri 80% e familjeve të vrojtura të kenë një lidhje të rregullt me sistemin e furnizimit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve. Ndërkohë, pjesa tjetër nuk janë të lidhur në sistem ose janë lidhur në mënyrë informale (Figura 22). Banorët në këto zona (informale) përdorin, në shumë raste, gropat septike ose shkarkojnë në kanalet e ujitjes. Moslargimi i ujërave sipërfaqësore në kohë shiu shkaktohen përmbytje, gjë që është problematike

sidomos në zonat periferike, si për shembull Mbrostar, etj. Gjithashtu, si pasojë e mungesës së një impianti pastrimi të kanalizimeve të ujërave të zeza, këto ujëra shkarkohen në lumë të patrajtuara.

Shërbimi i ujësjellës-kanalizimeve në Fier realizohet nga Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve, e cila funksionon si shoqëri anonime nën varësinë juridike të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve. Mënyra e menaxhimit të ndërmarrjes së ujësjellësit është me kontratë menaxhimi nga operatori privat, firma gjermane BERLIN WASSER. Aktualisht, mbledhja e të ardhurave nga shërbimi arrin në masën 40%¹.

Energjia Elektrike Situata e furnizimit me energji elektrike të popullatës në qytetin e Fierit ndikohet nga situata e përgjithshme elektroenergjitike në vend, e shoqëruar me kriza të përsëritura. Furnizimi me energji i përdoruesve të qytetit Fier në periudhën e dimrit është i kufizuar mesatarisht 2-3 orë më pak se gjatë periudhave të tjera dhe cilësia e energjisë nuk është e sigurt. Një nga çështjet kryesore është që, në shumicën e rasteve, kategoritë e ndryshme të përdoruesve – popullatë, tregtarë, industriale të vegjël – janë të përziera së bashku.

Qyteti i Fierit furnizohet me energji elektrike nga dy nënstacione elektrike: nënstacioni i parë me fuqi 24,400 kva, i ndërtuar në vitin 1960 dhe krejtësisht i amortizuar dhe nënstacioni i dytë me fuqi 12,000 kva, i ndërtuar në vitin 1992, i cili ka një skemë që nuk garanton punë të sigurt dhe nuk përballon rritjen e ngarkesës për shkak të zhvillimit. Rrjeti shpërndarës i qytetit të Fierit përmban 32 km linjë ajrore dhe 24 km linjë kablllore, të cilat janë mbi 25 vjeçare dhe të amortizuara, me strukturë ndërtimi jo të rregullt dhe me shumë degëzime.

Rrjeti telefonik. Në territorin e administruar nga Bashkia Fier veprojnë disa operatorë, të telefonisë fikse dhe të lëvizshme. Rrjeti i telefonisë fikse mbulohet nga kompania shtetërore Albtelekom sh.a. Fier, me kapacitet aktual të rrjetit primar 9,100 kopje (nr) dhe 23 zona (kabina) dhe me 8,253 abonentë të lidhur. Teknologjia e Albtelekomit Fier ka mundësuar përmirësimin e cilësisë së shërbimit. Ndërlidhja interurbane realizohet nëpërmjet kabllorëve me fibra optike, gjë që realizon një cilësi shumë të lartë të ndërlidhjes dhe që ka gjithashtu mundësinë e përdorimit të shumë shërbimeve të

¹ Analiza e Varfërisë dhe Ndikimit Social (PSIA) për Reformën e Sektorit të Ujësjellësit në Shqipëri. Banka Botërore, 2003




Figure 21: Rrjeti i furnizimit me ujë


GJATESIA TOTALE E RRJETIT FURNIZUES
ME UJË : 57318.6 m

- RRJETI I FURNIZIMIT ME UJË
- Vija kufizuese e ndërtesave
- - - - Hekurudha

tjera bashkëkohore si interneti, ISDN etj. Kërkesat e qytetarëve janë 3,000.

Pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave urbane. Prodhimi ditor i mbeturinave në Bashkinë Fier përlogaritet mesatarisht 100 ton, ndërsa prodhimi vjetor 29,200-35,550 ton. Prodhimi specifik i mbeturinave varion 0,8-1 kg/banor në ditë. Volumi i mbeturinave dhe disa nga parametrat e shërbimit të pastrimit në qytetin e Fierit pasqyrohen në Tabelën 7.


Figura 22: Lidhja e banorëve me rrjetin e ujit dhe kanalizimeve



Burimi: Vrojtimi Social-ekonomik 2004

Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave aktualisht realizohet nëpërmjet 350 kontenerëve dhe 55 pika-ve të shpërndarjes. Mbulimi i shërbimit të pastrimit i paraqitur në Figurën 23 është i pamjaftueshëm në të gjithë qytetin, ku vërehet se mjaft rrugë të brendshme nuk shërbehen me pastrim. Një ndër problemet e evi-

Figura 24: Shpeshësia e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave



Burimi: Vrojtimi Social-ekonomik 2004

gjithë qytetit. Pjesa më e madhe, e përbërë prej 4.1%, janë sipërfaqe të papërdorura, si për shembull brigje të papërdorura të lumit Gjanica dhe gjelbërim jashtë funksionit. Si rrjedhim, sipërfaqja e gjelbër aktuale është 1.06 m²/banor në shkallë qyteti (duke përfshirë edhe terrenet sportive dhe pikën panoramike), që sipas normave është një sasi mjaft e ulët. Mangësitë në mjediset e gjelbëruara, si parqet dhe lulishtet, si dhe

Tabela 7: Komponentët e prodhimit dhe shërbimit të grumbullimit të mbeturinave

Sasia (ton)		Prodhimi (kg/banor)	Sipërfaqe (m ²)	Pastrimi i rrugëve (m2)		Fusha e depozitimit (m2)	Kazanë plehrash (copë)
ditore	vjetore			larje	fshirje		
98	35,770	0,9-1	550,000	144,000	312,000	100,000	400

Burimi: Bashkia Fier

dentuara nga 2/3 e familjeve të vrojtuar është se distancat e vendeve të caktuara për hedhjen e mbeturinave janë të papërshtatshme dhe numri i kazanëve është i pamjaftueshëm.

Shërbimi i pastrimit kryhet rregullisht në 7 ditë të javës për rreth 80% të familjeve të anketuara (Figura 24). Cilësia dhe shpeshësia e shërbimit është e ndryshme në zona të ndryshme të qytetit dhe në disa zona mungon fare, si në rastin e 7.8% të familjeve të vrojtuar. Si pasojë e mungesave të mësipërme në shërbimin e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, rreth 20% e banorëve i depozitojnë mbeturinat në vende të papërshtatshme të hapura, si lumi Gjanica ose hekurudha. Hedhja e mbeturinave në këtë mënyrë evidentohet si një problem nga rreth 60% e familjeve të anketuara. Në zonat periferike të qytetit familjet i djegin mbeturinat ose i groposin ato.

Terrenet e gjelbra. Terrenet e gjelbra dhe zonat sportive në Fier zënë rreth 5% të sipërfaqes së qytetit. Megjithatë, zona me gjelbërim publik të mirëfilltë zë vetëm 1.3 ha ose 0.69% të sipërfaqes së qytetit, ku përfshihen zona me gjelbërim të cilat i shërbejnë të

zvogëlimi i gjelbërimit aktual nga ndërtimet e pakontrolluara, kanë cuar në mosfrekuentim të asnjë park ose lulishteje nga 70% e banorëve të anketuar. Kjo situatë dëshmon nevojën për një qytet më të gjelbër dhe njëherazi për një mjedis më të shëndetshëm.

Arsimi. Arsimi ka një vëmendje të konsiderueshme në qytetin e Fierit. Gjatë 10-15 viteve të fundit, sektori privat i arsimit në Fier ka marrë një zhvillim të konsiderueshëm me hapjen e një numri shkollash jopublike. Në shkallë kombëtare, Bashkia Fier është ndoshta bashkia e vetme ku arsimit jopublik mbizotëron atë publik. Disa nga parametrat e sistemit arsimor në Bashkinë Fier pasqyrohen në Tabelën 8 më poshtë.

* vetëm kopshtet publike – mungojnë të dhënat për kopshtet jopublike

** mungojnë të dhëna për shkollën jopublike 'Drita e së Ardhmes'

Niveli arsimor i popullsisë paraqitet nëpërmjet të dhënave zyrtare në Tabelën 9 dhe nëpërmjet të dhënave nga vrojtimi social-ekonomik në Figurën 25.




Figura 23: Mbulimi i shërbimit të pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave

Gjatesia totale e rrugëve që shërbehen me pastrim : 38971.5 m
Pika grumbullimi : 67

- Pika grumbullimi
- Rrugët që pastrohen
- Rrugët që nuk shërbehen me pastrim
- Zona e grumbullimit të mbeturinave urbane
- Vija kufizuese e ndertimeve
- Hekurudha

	PLAN I PËRZËNIMIT DHE PASTRIMIT TË GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE URBANE			
	ITITALLI	SHËRBIMI I PASTRIMIT DHE GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE URBANE		
	NUMERI	IN-08	DATA	01.06.2005
	PRINDI	BASHKIA E RRETHIT TË MBETURINAVE		
	ADRESA	RRETHI I MBETURINAVE, INSTITUTI PËR ZHVILLIMIN E NDIERTIMIT		
QIS				

Shkalla zyrtare e analfabetizimit qëndron në nivelin 0,4%, ndërkohë që nga vërtetimi rezultoi 2%, pra më e lartë. Arsimit e detyruar në ciklin e ulët dhe 8-vjeçar e kanë përfunduar 32% e popullsisë¹. Të dhënat zyrtare tregojnë se mesatarisht 89% e nxënësve që përfundoj-

¹ Duke filluar nga viti akademik 2005, arsimi i detyruar në Shqipëri u bë 9 vjet nga 8 që ishte. Megjithatë, duke qenë në vitin e parë të zbatimit, mjaft nga të dhënat i referohen ende sistemit të mëparshëm.

Tabela 8: Njësitë arsimore dhe regjistrimet sipas nivelit dhe llojit të arsimit (2003-2004)

Niveli arsimor	Gjithsej			Publike			Jopublike		
	Njësi	Regjistrime	Staf	Njësi	Regjistrime	Staf	Njësi	Regjistrime	Staf
Parashkollor (kopshtet)	23	1470*	66*	11	1470	66	-	-	-
I detyruar (9-vjeçar)	15	8325	499	10	7173	379	5	1152	120
I mesëm	9	4048**	214	4	3097	147	5	951**	67

Burimi: Drejtoria e Arsimit Kulturës Bashkia Fier

në arsimin e detyruar regjistrohen në nivelin e mesëm.

Sipas të dhënave zyrtare, 46% e popullsisë kanë kryer arsimin e mesëm. Arsimi i mesëm i përgjithshëm përbën zërin kryesor me 33% në arsimin e mesëm, nderkohe që bashkë me shkollimin në shkollat e mesme teknike dhe profesionale, përkatësisht, 14% dhe 4% të të anketuarëve, rezultojnë se mbi 50% e të anketuarëve kanë kryer arsim të mesëm (Figura 25).

Në vitin 2004, 486 nga 539 ose 90,1% e atyre që përfunduan arsimin e mesëm publik në Fier vazhduan studimet në nivelet universitare. Nga Tabela 9, 5.8% e popullsisë janë me arsim universitar, ndërsa në Figurën 25 rezultojnë se 13% e të vrojtuarëve kanë arsim universitar. Shifrat e larta të ndjekjes së arsimit universitar nga studentët fierakë kanë demonstruar nevojën për hapjen e një universiteti në Fier, i cili renditet ndër prioritetet më të rëndësishme në fushën e arsimit.

Dukuria e braktisjes së shkollës në arsimin e detyruar, në Bashkinë e Fierit është më pak se 1%. Kjo dukuri paraqitet e minimizuar gjithashtu edhe në arsimin e lartë, ndërsa shfaqet më e e lartë, në kufirin e 20%, në arsimin e mesëm (Tabela 10).

Çështjet që prekin sferën e arsimit në qytetin e Fierit evidentohen nga banorët në mënyrë të përmbledhur të lidhura, nga njëra anë, me infrastrukturën në nivelin e duhur shkollor dhe, nga ana tjetër, zhvillimin në nivelin e duhur të procesit mësimor (Figura 26). Këto probleme janë të njohura nga Bashkia më konkretisht si më poshtë:

- Numri i pamjaftueshëm i godinave shkollorë në të tre nivelet e

Tabela 9: Niveli i arsimimit të popullsisë

Lloji i arsimit	Rrethi Fier	Bashkia Fier	%
Pa arsim	1,550	345	0,4
Me arsim të ulët	27,100	8,130	10
Me arsim 8-vjeçar	31,628	17,700	22
Me arsim të mesëm	112,259	37,379	46
Me arsim të lartë	5,929	4,686	5,8

Burimi: Drejtoria e Arsimit Kulturës Bashkia Fier


shkollimit. Kjo ka bërë që, si rrjedhim, një numër i konsiderueshëm i fëmijëve 4-5 vjeçarë të mbeten në shtëpi dhe të mos përfitojnë prej edukimit parashkollor. Në arsimin 8-vjeçar dhe të mesëm po çënohen kushtet për progres të shkollarëve për shkak të mesatares së lartë të numrit të nxënësve për klasë.

- Ekzistenca e shkollave 8-vjeçare dhe të mesme të stërmëdha për nga numri i klasave dhe i nxënësve vështirëson administrimin dhe menaxhimin e duhur të tyre.
- Lëvizjet demografike brenda vendit, emigracioni, pagat e ulëta si dhe thithja e mësuesve cilësorë në arsimin jopublik, kanë sjellë punësimin në shkollat e qytetit të mësuesve me kompetenca profesionale të pamjaftueshme, për pasojë është ulur mjaft niveli i arsimit dhe edukimit të fëmijëve dhe të rinjve.
- Mungesa e bibliotekave, këndeve të informatikës, terreneve sportive dhe mjediseve të përshtatshme për organizimin e kohës së lirë dhe argëtimin e shkollarëve, pengon seriozisht edukimin dhe transmetimin tek ata të vlerave të një shoqërie me të vërtetë demokratike.

Problemi i largësisë dhe i mbipopullimit të shkollave është i përhapur në të gjithë territorin e qytetit. Në Figurën 27 tregohet se me lëvizjen nga qendra problemi i distancave të largëta për në shkollë bëhet dhe më i theksuar.

Shëndeti Publik. Shërbimi i kujdesit shëndetësor në Fier mbulohet nga 1 poliklinikë, 8 ambulanca lagjesh, 1 farmaci shtetërore, 3 konsultore fëmijësh, 2 konsultore të nënës me fëmijë dhe 18 qendra të shërbimit të mjekut të familjes. Shërbimi shëndetësor aktual është i kufizuar pasi aktualisht 1 mjek kujdeset për një numër të madh banorësh dhe 1 qendër shëndetësore mbulon përafërsisht 10 mijë banorë. Problemi i mbulimit të pamjaftueshëm të qendrave shëndetësore është i

Figura 25: Niveli arsimor i popullsisë




Burimi: Vrojtimi Social-ekonomik 2004

përhapur në të gjithë qytetin, sikurse pasqyrohet në Figurën 28.

Kujdesi shëndetësor ka një rëndësi kritike në mirëqenien e popullatës, në të cilën ndikojnë drejtpërdrejtë gjendja dhe niveli i shërbimit shëndetësor. Një pjesë e madhe e popullsisë sot përballen me një numër çështjesh lidhur me shërbimin shëndetësor, të përmbledhura në Figurën 29. Këto lidhen me infrastrukturën fizike, duke përfshirë edhe kushtet e papërshtatshme në spitalin e qytetit për arsye të mungesës ose numrit të pamjaftueshëm të shtretërve, barnave dhe aparaturave mjekësore. Nga ana tjetër, cilësia e shërbimit të kujdesit shëndetësor kufizohet nga niveli i kujdesit mjekësor dhe aplikimi i pagesave nën dorë për shërbimin mjekësor.

Nga tetë ambulancat e lagjeve që ka qyteti, tre kanë nevojë për rikonstruksion dhe tre të tjera duhen ngritur të reja pasi janë në kushte të papërshtatshme. Të tjera kanë nevojë të zhvendosen dhe të afrohen pranë lagjeve përkatëse. Gjithashtu, edhe gjendja fizike e

Figura 26: Problematika arsimore vlerësuar nga banorët



Burimi: Vrojtimi Social-ekonomik 2004

Tabela 10: Braktisja e shkollës (2003)

Lloji i arsimit	% e braktisjeve
Arsimi 8-vjeçar	0,8 %
Arsimi i mesëm	19%
Arsimi i lartë	0,4 %

Burimi: Bashkia Fier 2003

spitalit civil dhe atij pediatrik është e degraduar. Zona e spitaleve me një sipërfaqe 4 ha ndodhet në pjesën kodrinore të qytetit dhe shumë pranë qendrës, por ndërtimet pa leje pranë zonës spitalore kanë shkaktuar përkeqësimin e kushteve të zonës. Pavarësisht se janë hartuar projekte për rehabilitimin e plotë të dy spitaleve dhe poliklinikës si dhe rehabilitimin e ambulancave ekzistuese dhe ndërtimin e ambulancave të reja, mungesa e fondeve nga Ministria e Shëndetësisë në disa raste, ka kushtëzuar zbatimin e tyre.

Kultura. Jeta kulturore në qytetin e Fierit është përqendruar në aktivitetin e disa institucioneve kulturore kyçe si Teatri “Bylis”. Teatri ka një kapacitet prej 450 vendesh dhe përfaqëson një nga qendrat më të rëndësishme të zhvillimit artistik dhe kulturor të qytetit. Rol të ndjeshëm ka luajtur shoqëria “Apolonia” me një veprimtari teatrore, kulturore, sportive dhe artistike. Në harkun kohor 1957-1987 në Fier u ngritën institucione kulturore të rëndësishme si estrada profesioniste, Ansambli “Myzeqeja”, trupa teatrore profesioniste dhe teatri “Bylis” si dhe Grupi i Këngës Popullore Qytetare Fierake.

Trupa profesioniste e teatrit bashkiak ka një angazhim të përhershëm artistik. Krahas vënies në skenë të veprave të ndryshme, zhvillon edhe aktivitete të rëndësishme mbarëkombëtare. Vitet e fundit janë bërë përpjekje për t’i dhënë impulse lëvizjes teatrore në shkallë mbarëkombëtare, siç është organizimi i Festi-







Figura 27: Shpërndarja e distancave të shkollave në qytet

valit të përvitshëm teatrore të Aktrimit “Apollon”. Në të janë organizuar shumë shfaqje nga trupa teatrore dhe të estradës së Fierit, festivale tradicionale lokale dhe plot veprimtari të larmishme me raste festash e ditësh të shënuara. Teatri i Kukullave dhe qendra kulturore e fëmijëve janë në gjendje aktiviteti të dobët për arsye mungesash të aksesorëve përkatës dhe ndërhyrjes restauruese në ambientet e godinave.

Biblioteka e qytetit të Fierit është një nga bibliotekat më të mira të vendit dhe një institucion kulturor mjaft

- KUFIRI I RAJONIT
- KUFIRI I LAGJES
- DISTANCE E LARGET
- DISTANCE JO E LARGET

POVERTY MAPPING - FIER MUNICIPALITY			
 BASHKIA FIER TEL: +355 34 229 88	MAP TITLE	DISTANCE FROM SCHOOL	
	CODE	PT-02	DATE 01.06.2006
AUTHOR	FIER MUNICIPALITY		
ASSISTED	 Geo-PLAN INSTITUTE FOR HABITAT DEVELOPMENT		
GIS	 GEO CONSULTING		






Figura 28: Shpërndarja e shërbimit të qendrave shëndetësore


- KUFIRI I RAJONIT
- KUFIRI I LAGJES
- I PAMJAFTUESHEM
- I MJAFTUESHEM

 BASHKIA FIER <small>Tel: +355 34 229 43</small>	POVERTY MAPPING - FIER MUNICIPALITY			
	MAP TITLE	NUMBER OF HEALTH CARE CENTRES		
	CODE	PT-07	DATE	01.06.2005
	AUTHOR	FIER MUNICIPALITY		
	ASSISTED	<small>Geo-PLAN, INSTITUTE FOR HABITAT DEVELOPMENT</small>		
GIS		<small>GEO-CONSULTING</small>		

i rëndësishëm në Fier. Në fondin e saj ka mbi 26,000 tituj dhe mbi 140,000 libra, duke tërhequr në vitin 2004 mbi 5,000 lexues të regjistruar. Biblioteka, e vendosur në vitin 1999 në një godinë të re 4-katëshe, ka organizuar mesatarisht 60-70 aktivitete të ndryshme artistike, shkencore, sociale etj, ku janë përfshirë dega e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, shoqata, shkolla si dhe individë të ndryshëm. Gjatë vitit të kaluar janë zhvilluar në bibliotekë 42 promovime të librave të rinj, diskutime krijuese dhe ekspozita të librit.

Sportet. Tradita sportive në qytet e ka zanafillën e

Figura 29: Problematika shëndetësore vlerësuar nga banorët



Burimi: Vrojtimi Social-ekonomik 2004

saj në vitet '30. Klubi i sportit "Apollonia" e ka përfaqësuar këtë traditë në aktivitete kombëtare e ndërkom-bëtare. Duke nisur që nga riorganizimi i tij në vitin 1946 e në vazhdim, sporti më popullor dhe më masiv në Fier është futbollit. Sporte të tjerë të suksesshëm kanë qenë edhe basketbolli, peshëngritja, qitja dhe atletika të cilat kanë shënuar gjithashtu suksese të rëndësishme.

Në funksion të zhvillimeve sportive, më 1961 u ndër-tua këndi sportiv i lojërave me dorë me kapacitet 3,200 vende dhe më 1962 u ndërtua stadiumi i futbollit "Loni Papuçiu", me kapacitet 8200 vende, në të cilin organi-zohen ndeshjet e ekipit të futbollit "Apollonia". Këndi sportiv i lojërave me dorë aktualisht është i papërdor-shëm për arsye se është i pambuluar.

Aktualisht, stadiumi i futbollit dhe ai i lojërave me dorë janë të izoluar nga ndërtimet apo nga funksio-net e tjera që i rrethojnë duke shkaktuar vështirësi në funksionimin e tyre. Për gjallërimin e mëtejshëm të ak-tiviteteve sportive, Bashkia e qytetit ka ndërmarrë disa reforma nxitëse dhe ka përkrahur gjithashtu të gjitha nismat private që shfaqen me prioritete efektive në përputhje me këto reforma.

2.4 Problematika e zhvillimit urban dhe social

Sikurse u përshkrua në këtë seksion, qyteti i Fierit ka pë-suar transformime të rëndësishme në harkun kohor të 15 viteve të fundit. Ritmet e theksuara të rritjes së popullsisë dhe urbanizimit informal gjatë kësaj periudhe janë një ndër faktorët më unikalë në rritjen e qytetit të Fierit dhe një ndër konsideratat kryesore të zhvillimit.

Këto zhvillime tërheqin vëmendjen në plotësimin e nevojave të komunitetit për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe mirëqenies së tij. Numri i lartë i të pas-trehëve evidenton qartë nevojën për një strehim më

social që t'i shërbejë zgjidhjes së problemit të numrit të lartë të familjeve të pastreha. Papunësia, sidomos në radhët e femrave dhe moshës më aktive për punë, dëshmon nevojën për një përpjekje më të madhe për nxitjen e forcave aktive për punë. Gjithashtu, për një arsimim më të mirë dhe cilësor si dhe për ngritjen e nivelit të shëndetit publik të popullsisë, është i nevo-jshëm zhvillimi i një infrastrukture më të mirë arsimore dhe shëndetësore, krahas përmirësimit të shërbimit.

Zhvillimi aktual i qytetit të Fierit dëshmon gjithash-tu nevojën për vendosjen e një ekuilibri më të ku-jdesshëm ndërmjet individit privat dhe sferës publike, me qëllim një funksionim më të mirë të qytetit nga pikëpamja urbane. Veç kësaj dëshmon edhe nevojën për një zhvillim më të integruar në të gjitha pjesët e qytetit, çka lidhet me plotësimin e infrastrukturave ekzistuese dhe zhvillimin e atyre të reja dhe me zhvil-limin e tendencave ekzistuese të rrjetit rrugor kryesor dhe shtrirjen sidomos në zonat periferike për një integ-rim më të mirë funksional të hapësirave të hapura dhe të ndërtuara në strukturën ekzistuese të qytetit.


Seksioni 3

Fieri: Qytet i Mundësive të Zhvillimit

Zhvillimi i Qëndrueshëm i Fierit

Nisur nga konsiderata se qytetet janë motorë të zhvillimit ekonomik, ky seksion vijon me analizimin e disa prej karakteristikave kryesore të ekonomisë në Fier. Në vështrim të orientimit të ri drejt ekonomisë së tregut privat gjatë periudhës së tranzicionit, ekonomia në Fier ka pësuar ndryshime strukturore të rëndësishme dhe një zhvillim të konsiderueshëm. Potenciale të rëndësishme për zgjerimin e ekonomisë dhe zhvillimin e sektorëve të rinj shfaqen, bazuar në një shfrytëzim më të mirë të burimeve natyrore, historike dhe kulturore të Fierit. Fuqizimi i mëtejshëm ekonomik, megjithatë, është i lidhur ngushtë me garantimin e një mjedisi të qëndrueshëm i cili është ende larg të qenit i tillë.

Figura 30: Ecuria e çeljes së bizneseve të reja (1990-2004)



Burimi: Vrojtimi i Biznesit 2004

3.1 Vizioni

“Fieri, qytet me prosperitet ekonomik i cili projektton të ardhmen mbi bazën e vlerave territoriale dhe shfrytëzimit të mençur të potencialeve ekonomike të agrobiznesit, tregtisë, tokës, turizmit bregdetar dhe kulturor, mjedisit të pastër dhe burimeve të çmuara natyrore. Kështu, Fieri ka krijuar një klimë të favorshme për fuqizimin e biznesit dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, gjë që ka rritur mundësitë për punësim dhe tërheqjen e investimeve nga brenda dhe jashtë vendit.”

3.2 Mendimi qytetar

Mendimi qytetar për sektorët ekonomikë potencialë që duhen zhvilluar në Fier:

- Industria e lehtë dhe ushqimore
- Ndërtimi
- Biznesi i vogël dhe i mesëm
- Tregtia dhe shërbimet
- Agrobiznesi
- Turizmi arkeologjik dhe bregdetar
- Sektori i transportit
- Vënia në efikasitet dhe prodhimin të uresë

3.3 Profili i Qytetit: Ekonomia, burimet dhe mundësitë

3.3.1 Fieri: Qytet i zhvillimit ekonomik

Gjatë periudhës së regjimit socialist deri në fillim të viteve 1990, industria ishte një sektor kryesor i cili zinte 73,3 % të gjithë prodhimit të rrethit të Fierit.


Në këtë rajon ishin përqendruar degë të rëndësishme të ekonomisë të cilat jepnin rreth 12% të prodhimit të përgjithshëm në shkallë kombëtare si industria e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës (Fabrika e Përpunimit të Thellë të Naftës), industria kimike (Uzina e Prodhimit të Nitrat Amonit dhe Uresë), industria e energjitikës (TEC-i), si dhe sektori i bujqësisë.

Një pjesë e madhe e ndërmarrjeve publike dhe sektorëve të veçantë të mësipërm pësuan rënie apo u mbyllën si pasojë e reformave strukturuese dhe privatizimit që nisën pas ndryshimit të sistemit politik-ekonomik në fillim të viteve '90. Orientimi i ri drejt ekonomisë së tregut krijoi mundësinë e pjesëmarrjes së gjithmonë e më shumë aktorëve dhe individëve privatë në ekonominë në formim të Fierit, duke kontribuar në lindjen dhe zhvillimin e sektorit privat. Rritja graduale e numrit të bizneseve të reja të çelura çdo vit ndihmoi në rimëkëmbjen e shpejtë të ekonomisë. Periudhat 1993-1996 dhe 1999-2002 mund të konsiderohen si dy periudhat më të mira të rritjes ekonomike për sa i përket krijimit të firmave të reja në qytetin e Fierit¹ (Figura 30).

Faktorë të rëndësishëm kanë ndikuar në ecurinë e ekonomisë në tranzicion të Fierit, si për shembull, kriza që shkaktoi rënia e skemave financiare piramidale në vitin 1997. Pas kësaj periudhe, aktiviteti ekonomik filloi të rimëkëmbej me ritme të shpejta. Megjithatë, në 2-3 vitet e fundit është vërejtur një përgjysmim

¹ Dallimi ndërmjet vitit të hapjes së biznesit dhe vitit të regjistrimit të aktivitetit nuk luan rol në vlerat e paraqitura në Figurën 30.

Figura 31: Vlerësimi i ecurisë së zhvillimit të ekonomisë nga biznesi (2002-2004)



Burimi: Vrojtimi i Biznesit 2004

i numrit të firmave të reja të krijuara, duke nenkuptuar një ngadalësim të rritjes ekonomike. Kjo tendencë ngadalësimi e rritjes ekonomike gjen pasqyrim gjithashtu në perceptimin e përgjithshëm të komunitetit të biznesit për ecurinë e ekonomisë, e cila ka prekur në mënyrë më të ndjeshme biznesin e vogël dhe biznesin e paliçensuar (Figura 31).

Sipas të dhënave zyrtare pasqyruar në Tabelën 11, situata në sektorët kryesorë të ekonomisë në vitin 2003 ishte më e favorshme për shërbimet, nisur nga numri i madh i firmave të reja të krijuara në këtë sektor gjatë këtij viti. Në vitin 2004 vërehet një rënie e përgjithshme e numrit të subjekteve të reja ekonomike të hapura. Këto të dhëna tregojnë gjithashtu se, në ngjashmëri me ekonominë kombëtare, edhe në Fier është zhvilluar më shumë një ekonomi shërbimesh.

Tabela 11: Subjektet e reja sipas sektorëve (2002-2004)

Sektori/Viti	2002	2003	2004
Tregti	11	10	6
Prodhim	2	5	3
Shërbime	70	265	34
Ambulant	3	2	2


Burimi: Tatim-Taksa, Bashkia Fier

Sektor tjetër i rëndësishëm është tregtia, nisur edhe nga avantazhi i rajonit të Fierit si pikë kyçe për realizimin e shkëmbimeve tregtare që ndodhin për të gjithë rajonin e Jugut. Tregtia zë aktualisht 16% të ekonomisë së Fierit, ndërsa industria e prodhimit të konfeksioneve për import dhe industria e lehtë ushqimore 16%, dhe industria e ndërtimit 12% (Figura 32). Gjithashtu, po shfaqen qartë tendencat e zhvillimit të dy sektorëve të rëndësishëm që janë agrobiznesi dhe turizmi.

Gjatë periudhës së tranzicionit ekonomia në Fier është rritur me ritme të shpejta, por megjithatë pesha kryesore e saj mbetet e përqëndruar në ndërmarrjet e vogla. Sipas të dhënave zyrtare, janë 1,500 subjekte të biznesit të vogël dhe rreth 450 subjekte të biznesit të madh në qytetin e Fierit. Në fushën prodhuese janë rreth 70 subjekte. Ndërmarrjet ekonomike të vogla, duke përfshirë edhe bizneset e paliçensuara, përbëjnë rreth 75% të ekonomisë vendore (Figura 33).


Pavarësisht nga numri i tyre, biznesi i vogël dhe biznesi i paliçensuar janë në realitet mikrondërmarrje të tipit familjar dhe/ose individual, të cilat kanë zakonisht një njësi ushtrimi të veprimtarisë dhe një numër të punësuarish mesatarisht 2-3 vetë, sikurse tregohet në Figurat 34-35. Ndërsa biznesi i madh ka arritur një zhvillim më të rëndësishëm në krijimin e ndërmarrjeve me ortakëri ose grup ortakësh; aktualisht rreth 25% e bizneseve të anketuara janë të tilla. Një pjesë prej 16% e kompanive të mëdha kanë një shtrirje të veprimtarisë dhe investimeve edhe në degë/njësi të tjera rajonale ose kombëtare dhe një pjesë tjetër 5% përfaqësojnë degë të kompanive të tjera të mëdha që kanë investuar në Fier.

Figura 32: Sektorët kryesorë të ekonomisë së Fierit



Burimi: Vrojtimi i Biznesit 2004

Figura 33: Shpërndarja e numrit të firmave sipas madhësisë




Burimi: Vrojtimi i Biznesit 2004

Zhvillimi ekonomik i periudhës së tranzicionit është karakterizuar gjithashtu nga mungesa e një orientimi të mirëfilltë për sa i përket shtrirjes gjeografike të investimeve të sektorit privat. Për këtë arsye, njohja më e mirë e faktorëve që ndikojnë në vendimet e bizneseve për zgjedhjen e vendndodhjes së tyre përbën një aspekt të rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të qytetit të Fierit. Në mjaft raste firmat e reja janë hapur duke mos marrë parasysh përqendrimin e firmave ekzistuese, tregun dhe kritere të tjera udhëzuese dhe përcaktuese për vendosjen e bizneseve në një lokalitet të caktuar. Hapja e bizneseve të reja i ka shërbyer më mirë plotësimin të nevojave të komunitetit; megjithatë, në mjaft raste, nëpër qytet vërehet një përqendrim i dendur i aktiviteteve të të njëjtit lloj në hapësira të vogla.

Nisur nga shpërndarja e numrit aktual të bizneseve të regjistruara sipas rajoneve në qytetin e Fierit, paraqitur në Tabelën 12, pjesa veriore e qytetit, që përfshin Rajonin 2 dhe Rajonin 3, paraqitet më pak e zhvilluar ekonomikisht se sa pjesa jugore, sidomos për nga numri i bizneseve të vogla.

Situata e zhvillimit ekonomik të qytetit dëshmohet më tej në Figurën 36, që tregon shpërndarjen aktuale në terren të zonave ekonomike dhe njësive kryesore të prodhimit. Drejtimi jugor i qytetit, që përfshin Rajonin 4 dhe Rajonin 1, ka marrë një zhvillim ekonomik më të

Figura 34: Tipi i pronësisë së biznesit



Burimi: Vrojtimi i Biznesit 2004

Tabela 12: Shpërndarja e numrit të bizneseve sipas rajoneve (2005)

Bashkia Fier	Madhësia e biznesit	
	i madh	i vogël
Rajoni 1	60	374
Rajoni 2	80	240
Rajoni 3	90	230
Rajoni 4	125	620
Gjithsej	355	1464

Burimi: Zyra Tatim-Taksa, Bashkia Fier

madh, ku janë përqëndruar aktivitete të rëndësishme ekonomike dhe prodhuese. Në këtë drejtim (jashtë territorit të Bashkisë) ndodhet zona industriale, me fabrikat e TEC-it dhe Azotikut. Megjithatë, nga figura vërehet gjithashtu prania e zonave të konsiderueshme ekonomike të dala jashtë funksionit.


3.3.2 Fieri, Qytet i Agrobiznesit

Bujqësia, deri para viteve '90, ishte një nga sektorët kryesorë të prodhimit kombëtar në të cilin Fieri zinte një vend të rëndësishëm si një nga rajonet me prodhimtari më të lartë bujqësore. Pas kësaj periudhe, në vazhdim, sektori bujqësor pësoi një rënie për një sërë faktorësh si ndryshimi i strukturës ekonomike të prodhimit, shpërbërja e kooperativave bujqësore si forma kryesore e organizimit në sektorin e bujqësisë, rënia e interesit për t'u marrë me bujqësi e ndikuar edhe nga braktisja e fshatrave gjatë procesit të shpërnguljes masive të popullsisë rurale në drejtim të qytetit, humbja e tokës bujqësore nga konvertimi i saj për ndërtim shpeshherë në mënyrë të paligjshme e të tjerë.

Në vështrim të traditës dhe përvojës së komunitetit si dhe kushteve natyrore të favorshme, agrobiznesi shfaqet si një nga sektorët më potencialë të zhvillimit për qytetin e Fierit. Toka e pasur, relievi fushor kodrinor, klima dhe pozicioni i favorshëm gjeografik bashkohen me kapitalin human si dhe kapitalin financiar për të investuar në këtë sektor.

Bashkia Fier ka në administrim rreth 1,599 ha tokë

Figura 35: Shtrirja e aktivitetit të biznesit



Burimi: Vrojtimi i Biznesit 2004




Figura 36: Shpërndarja e zonave ekonomike dhe të prodhimit

bujqësore, nëpërmjet tokës që u është dhënë në përdorim dhe në pronësi ish-punonjësve të ndërmarrjeve bujqësore që banojnë në qytetin e Fierit si dhe sipërfaqeve të tjera të pazëna me troje brenda planit rregullues. Si rreth, Fieri zë mbi 122 mijë hektarë ose 17,5% të tokës bujqësore në vend. Kultivimi i bimëve të shumëllojshme të arave jep mbi 20% të prodhimit të drithërave dhe të perimeve (përveç patateve) në shkallë vendi.

Në nivel qarku, prodhimi bujqësor është një burim

ZONAT EKONOMIKE	SIP (ha)
MAGAZINIM DEPO	19.44
MAGAZINIM DEPO JASHTE FUNKSIONIT	11.19
PARQE AUTOMJETESH	6.80
SERA	8.11
SERA JASHTE FUNKSIONIT	7.96
SERVIS AUTOMJETESH	7.88
TREGJE	4.85
ZONA INDUSTRIALE EKONOMIKE	68.12
ZONA INDUSTRIALE EKONOMIKE JASHTE FUNKSIONIT	15.00
ZONE E TRANSPORTIT TE JASHTEM	4.74

PLAN I PËRZËNDRIMIT TË ZONAVE EKONOMIKE DHE TË PRODHIMIT	
TITULLI	PLAN I PËRZËNDRIMIT TË ZONAVE EKONOMIKE DHE TË PRODHIMIT
HAZIRUESI	ZEMER CONSULTING
DATA	01.06.2025
NUMRI	UR-09
QARKU	DASHKËJA FIER
QASIMI	ZEMER CONSULTING
QIS	QIS



Apollonia

i rëndësishëm jetese që siguron 50% të të gjithë të ardhurave vetjake. Pemëtaria dhe ullinjtë në këtë zonë përmbajnë një numër prej 362,000 pemësh frutore në prodhim, të cilat përbëjnë 8% në shkallë kombëtare. Në prodhimin e ullirit Fieri renditet i dyti pas Beratit.

Megjithatë, duke vijuar nga viti 1997, prodhimet prej këtyre burimeve kanë pësuar një rënie. Pakësimi i sipërfaqes së mbjellë me drithëra me rreth 25% ka çuar në uljen e prodhimit me 11,8%; kjo si pasojë e konkurrencës që vjen nga importimi i miellit. Gjithashtu, edhe numri i drurëve të ullirit është pakësuar duke ndikuar në luhatjen e sasisë së prodhimit.

3.3.3 Fieri, Qytet i Turizmit

Vlerat dhe pasuritë natyrore si dhe ato historike e kulturore që bashkohen në rajonin e Fierit përfaqësojnë potenciale të rëndësishme për zhvillimin e sektorit të turizmit. Ky sektor me potencial të madh është ende i pashfrytëzuar.

Pasuritë natyrore. Fieri është shumë pranë bregdetit

Adriatik dhe plazheve me rërë të pastër përgjatë bregdetit të qarkut siç janë Divjaka, Semani, Hidrovori, Pish-Poroja etj. Grykëderdhjet e lumenjve Vjosë, Shkumbin dhe Seman ofrojnë gjithashtu potenciale për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe gjahut.

Pylli mesdhetar halor i Divjakës, me sipërfaqe prej rreth 1,200 ha, me shumëllojshmëri bimësh, pemësh dhe kafshësh e zogjsh të egër, është unikal për qëllime turistike. Një nga çështjet më të rëndësishme është mungesa e infrastrukturës së përshtatshme për gjithë vijën bregdetare të rrethit të Fierit. Ngritja e kësaj infrastrukture është nevoja më e madhe për zhvillimin e zonës turistike bregdetare, pasi nëpërmjet saj do të arrihet rritja e aktivitetit të bizneseve të turizmit.

Trashëgimia historike dhe kulturore. Trashëgimia historike në Fier është gjithashtu mjaft e pasur dhe e veçantë. Vendet me trashëgimi historike përfshijnë gjurmë të qytetërimit të lashtë në Apolloni dhe Bylis, një varg manastirësh të mesjetës, veçanërisht atë të Ardenicës, muzetë historikë në qytetet kryesore si dhe muzeun arkeologjik në Apolloni etj. Traditat, zakonet,




Figura 37: Problematika kryesore mjedisore

mënyra e jetesës në fshatrat e qarkut e sidomos festat, ceremonitë, kostumet, këngët, vallet, krijojnë një ofertë të pasur për turizmin kulturor.

Në drejtim të zhvillimit të turizmit historik dhe kulturor një rëndësi të veçantë merr edhe Muzeu Historik i vendosur në Bashkinë Fier, i cili mbulon të gjithë Rrethin e Fierit. Në këtë muze pasqyrohen momente të rëndësishme të trashëgimisë dhe historisë shekullore krahinore të Fierit si veprimtaritë patriotike, kryengritjet fshatare, luftërat për liri e pavarësi kombëtare



Pamje nga kompleksi industrial i Fierit

etj, duke përfshirë edhe kulturën materiale popullore, kulturën etnografike, kulturën e krishterë, etj. Muzeu ndodhet në një godinë dykatëshe larg qendrës, me probleme të funksionimit optimal të mjediseve të brendshme të ekspozimit dhe, mbi të gjitha, të mos-funksionimit publik.


Për këtë arsye, është e nevojshme që vlerat historike dhe etnokulturore të shpalosen më mirë sipas konceptit të një "parku kulturor", me qëllim që të ndiqen ritmet e zhvillimit modern të qytetit. Kultura historike dhe etnokultura duhet të gjejnë hapësirat e tyre të ekspozimit edhe në sheshet dhe parqet e qytetit. Krahas ngritjes së monumenteve dhe busteve të personaliteteve historike dhe kulturore, duhet të pasqyrohet edhe tradita e trashëgimisë së vlerave krahinore, nëpërmjet krijimit të "oborrit artistik myzeqar" në një nga parqet qendrore. Kjo do krijonte një atmosferë të këndshme dhe mjedise çlodhëse të kulturuar.

3.3.4 Fieri, Qytet me Zhvillim të Qëndrueshëm Mjedisor

Qyteti i Fierit mbart një sensibilitet të lartë mjedisor për shkak të një problematike të theksuar të mjedisit në të gjithë këtë rajon. Gjendja e mjedisit paraqitet e përkeqësuar nga ndotja e theksuar nga shumë burime serioze. Këtu përfshihen niveli i ndotësve në ujërat e Gjanicës dhe në ujërat dhe brigjet e Semanit prej industrisë së naftës dhe asaj kimike dhe termoelektrike; ndotja e ajrit nga trafiku i dendur dhe i padisiplinuar; si dhe ndotja nga mbetjet urbane të grumbulluara dhe trajtuara anakronikisht. Zhvillimi ekonomiko-industrial i deritanishëm në rajonin e Fierit nuk është udhëhequr nga një filozofi "respektuese" ndaj mjedisit dhe ruajtjes së ekuilibrit ekologjik. Problematika kryesore e ndotjes dhe faktorëve të lidhur me të në territorin e qytetit dhe përreth pasqyrohet në Figurën 37.

Shkarkimet e ekstrateve të naftës dhe të industrisë së rafinerive, duke pasur parasysh se në këtë rajon prodhohet rreth 60% e naftës në vend, janë faktorët bazë që shkaktojnë ndotjen e rezervave ujore sipërfaqësore e nëntokësore. Ndotja nga shkarkimet e papërpunuara të industrisë së naftës në pellgun ujëmbledhës të Lumit Gjanica arrin në 12.58–18.91 m³/muaj ujëra me

Figura 38: Shkalla e njohurisë së biznesit për ndikimin në mjedis



Burimi: Vrojtimi i Biznesit 2004

përmbajtje nafte që luhatet nga 0.2-6 mg/l. Si pasojë, Lumi Gjanica është shndërruar në ujërrjedhësin dhe ndotjeprurësin më të madh në Fier dhe në lumin më të ndotur në vend. Kjo ndotje ka prekur jo vetëm qytetin por dhe brigjet e Adriatikut, duke i shkaktuar një dëm të konsiderueshëm turizmit të synuar në këtë zonë. Shkarkimet e kanalizimeve të ujërave të zeza dhe të bardha nga lagjet dhe ndërtime të reja buzë bregut të lumit Gjanica janë një tjetër burim ndotjeje, pasi derdhen në det duke e rritur kështu shkallën e ndotjes.

Cilësia e ajrit është gjithashtu e rrezikuar nga ndotja e ajrit nga uzina termike TEC, ku proceset e djegies së lëndës bazë me përmbajtje 3.5-6% sqfur çlirojnë gaz sulfuror. Duke u bashkuar me ujin, ky gaz kthehet në acid sulfurik i cili ngrihet lart në saje të presionit të ajrit dhe rritet me presionin e ajrit duke shtuar shkallën e ndotjes. Ndotja shtohet edhe nga prania e elementëve si Co, Nox dhe SO₂ të cilat shkaktohen nga shkarkimet e mbetjeve të lëndës djegëse. Prania mbi normat e lejuara e hidrokarbureve, toluenit dhe benzeneve në ujërat e Gjanicës apo e H₂S, CO, NOx në ajër konsiderohen një kërcënim serioz për kushtet e jetesës së qytetarëve.

Niveli i lartë i ndotjes së ajrit në qytet ndikon dhe dëmton drejtpërdrejtë jetesën e mbi 90% të banorëve të anketuar. Gjithashtu, niveli i lartë i zhurmave në qytet përbën një problem shqetësues për 70% të tyre. Megjithatë, ndërgjegjësimi i bizneseve mbi ndikimin në mjedis nuk qëndron në të njëjtat nivele. Njohuria e bizneseve të anketuara mbi ndikimin në mjedis nga

ushtrimi i aktivitetit të tyre mbetet e kufizuar vetëm në një përqindje shumë të vogël, por edhe në këto raste informacioni i tyre paraqitet tejet i kufizuar (Figura 38).

Vetëm 5% e biznesit të madh rezulton se ka kryer një vlerësim të ndikimit mjedisor; ndërsa 3.4% dhe 11.5% përkatësisht për biznesin e vogël dhe biznesin e madh janë të pajisur me liçensë mjedisore. Ndikimi negativ i aktiviteteve ekonomike në mjedis është i qartë në kushtet kur pjesa më e madhe e tyre përdor ende teknologji të vjetëruar të viteve '70. Adoptimi i teknologjive të reja nga bizneset prodhuese është i ngadaltë dhe vetëm një pjesë prej 25% dhe 32% përkatësisht e biznesit të vogël dhe e biznesit të madh synon të blejë teknologji të tilla bashkëkohore.

Ndotja e ajrit është rritur gjithashtu edhe si pasojë e shtimit të trafikut nga qarkullimi në Fier i më shumë se 13,000 automjeteve, 80% e të cilave janë autovetura. Emetimi i SO₂ në ajër nga djegia e gazoil të autoveturave, kryesisht me naftë, rezulton të jetë 228 kg/ditë ose 79,800 litra/ditë. Ndotja theksohet në qendër të qytetit ku qarkullimi i mjeteve është më i madh dhe shpejtësia më e ulët; theksimi i saj ndodh gjithashtu edhe për shkak të përdorimit të mjeteve me gazoil të prodhuara para viteve '90. Vlerat e monitorimit më të fundit në tri pika periferike të qytetit, të paraqitura në Tabelën 13, evidentuan se CO është më lart se normativa e lejueshme 25-30 ppm.

Një konflikt të hapur me mjedisin ka shkaktuar gjithashtu depozitimi dhe trajtimi i mbeturinave urbane, i cili ende bëhet në kushte krejtësisht të papërshtatshme në fushën e grumbullimit të mbeturinave. Në kushtet aktuale, kjo fushë mbulon një sipërfaqe prej 6 ha dhe ndodhet në një distancë të afërt prej 3 km nga zona e banuar. Fusha nuk ka drenazhim dhe rrethim dhe as infrastrukturën e duhur për mjetet teknologjike. Përpjekjet e fundit janë për zhvendosjen e depozitimit të mbeturinave në një sipërfaqe më të madhe, prej 30 ha, dhe ndërtimin e një vendgroposeje pranë fshatit Vërri. Për përpunimin e tyre është propozuar si zgjidhje ndërtimi i një impianti përpunimi teknologjik me djegie, i cili do të mbulojë edhe bashkitë e tjera në këtë rajon si Berat, Lushnjë, Vlorë e Ballsh.

Administrimi dhe mbrojtja e mjedisit është një

Tabela 13: Vlerësimi i ndotjes së mjeteve të transportit

Pikat e monitorimit	Fluksi i qarkullimit	CO
1 Hyrje nga Tirana	767 mjet/orë	36.2 ppm
2 Fier- Ballsh	1412 mjet/orë	37.7 ppm
3 Fier- Vlorë	1046 mjet/orë	34.1 ppm

Burimi: Bashkia Fier 2004

përgjegjësi e përbashkët e autoriteteve vendore dhe atyre qendrore. Një ndër nevojat kryesore që ka evidentuar Bashkia Fier për të ulur sa më shumë ndikimin e ndotjes së mjedisit në qytetin e Fierit është fillimisht ngritja e strukturave të monitorimit të mjedisit. Parametrat që duhet të monitorohen janë ajri, uji, toka dhe ekologjia në rreth, parametra këto që duhet të jenë bazë me qëllim që të shmanget degradimi i mëtejshëm mjedisor i qytetit dhe rreziku mjedisor i territorit.

3.4 Problematika e zhvillimit të qëndrueshëm

Ekonomia e Fierit ka bërë hapa të rëndësishëm përpara në zhvillimin në kushtet e ekonomisë së tregut gjatë periudhës së tranzicionit. Sektori privat i biznesit, i cili mbizotërohet nga ndërmarrjet e vogla, ka luajtur rolin kryesor në zhvillimin ekonomik. Ky fakt tërheq vëmendjen për zhvillimin e politikave dhe instrumentave nxitës për fuqizimin e këtij biznesi, aq më tepër që kuadri ligjor për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në vend si dhe infrastruktura mbështetëse ekzistojnë. Çështje të rëndësishme janë mungesa e njohurive dhe kapaciteteve të biznesit privat në menaxhimin e ndërmarrjeve dhe aftësinë për sipërmarrje si dhe mungesa e financimeve për fuqizimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme.

Ekonomia e Fierit është e orientuar kryesisht nga shërbimet, por ndërkohë tregtia, ndërtimi dhe industria e lehtë dhe ushqimore kanë pasur një zhvillim të konsiderueshëm. Dy sektorë të tjerë perspektivë janë agrobiznesi dhe turizmi. Zhvillimi i tyre do të bazohet në shfrytëzimin më të mirë të potencialeve që burojnë nga klima e favorshme, ekzistenca e zonave turistike potenciale në Qarkun e Fierit (Divjakë, Ardenicë, Bylis

etj.), afërsia e qytetit me vende të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve argëtuese dhe zhvillimin e turizmit detar, historik, kulturor dhe natyror, etj. Për këtë arsye, është evidentuar si e nevojshme shpallja e pjesës turistike të Semanit si zonë e mbrojtur nga shteti. Zhvillimi i agrobiznesit fiton përparësi edhe nga prania e industrisë së lehtë përpunuese dhe ushqimore dhe nga potencialet për eksport të prodhimeve të kësaj industrie.

Në zhvillimin e sektorëve të agrobiznesit dhe turizmit evidentohen çështje si mungesa e rrjetit të organizuar të sektorit privat për zhvillimin e turizmit dhe agrobiznesit; mungesa e investimeve të konsiderueshme në bujqësi e blegtori; mungesa e kapaciteteve dhe njohurive në ofrimin e shërbimeve në sektorin e turizmit; si dhe një turizëm rajonal jo i integruar.

Në kuadër të zhvillimit harmonik të ekonomisë, është e rëndësishme gjithashtu që edhe zhvillimi i aktivitetit ekonomik të jetë më i planifikuar, gjë që lidhet me dimensionimin më të mirë territorial të veprimtarisë prodhuese dhe ekonomike në qytet dhe shpërndarjen më të mirë të tyre. Një nga nevojat kryesore të qytetit është orientimi i zhvillimit sipas hapësirave të nevojshme përgjatë "korridoreve prioritare të zhvillimit ekonomik", me synim krijimin e poleve të reja të zhvillimit.

Së fundi, mjedisi mbetet një nga çështjet më të mprehta në Fier pasi problematika e tij është theksuar mjaft nga niveli i lartë i ndotjes. Për këtë arsye, nevojitet një ndërhyrje e koordinuar në disa nivele për të frenuar ndotjen e industrisë dhe për të rritur ndërgjegjësimin e pjesës tjetër të biznesit mbi ndikimin në mjedis.

Seksioni 4 Fieri: Qytet me Qeverisje të Mirë Vendore

Zhvillimi i qytetit është rezultante e procesit të vendimmarrjes si dhe e procesit nëpërmjet të cilit vendimet zbatohen ndërmjet aktorëve të ndryshëm të njohura si qeverisje, ku themelore është ekzistenca e “institucioneve të mira” që garantojnë funksionimin si duhet të këtij procesi. Ky seksion përshkruan kontekstin aktual të qeverisjes vendore në qytetin e Fierit; në qendër të analizës janë proceset që realizon institucioni i Bashkisë në përputhje me zhvillimin e një klime të shëndoshë për biznesin. Informacioni i paraqitur në këtë seksion përmban vlerësime lidhur me nivelin e taksave, shërbimin ndaj biznesit dhe procedurat administrative, garantimin e konkurrencës etj, si dhe aspekte të qeverisjes me pjesëmarrjen e komunitetit.



Procese punënë bashki me komunitetin (lart) dhe aktorët e tjerë të zhvillimit (poshtë)

4.1 Vizioni

“Fieri, qytet me burime njerëzore të kualifikuara në administratën publike dhe në sektorin privat dhe joqeveritar, të cilët bashkëpunojnë ngushtësisht me njëri-tjetrin dhe me qeverinë qendrore dhe e masin performancën e tyre bazuar në strategjinë dhe objektivat të cilat bashkëndahen nga të gjithë qytetarët dhe në plotësimin e kërkesave të “qytetarëve-klientë”.

4.2 Mendimi qytetar

Mendimi qytetar mbi mënyrën e qeverisjes:

- *marrja e mendimit të komunitetit dhe grumbullimi sistematik i informacionit nga komuniteti i biznesit*
- *krijimi i lehtësirave në shërbimet administrative (eliminimi i burokracive)*
- *krijimi i lehtësirave në kreditim (afatgjatë dhe me interesa të ulëta)*
- *përkrahja e bizneseve të vogla nëpërmjet një pakete politikash dhe e bizneseve të sapoçelura gjithashtu (favorizimi me taksë në fillim)*
- *taksat: të ulen taksat vendore për biznesin si taksë e liçensimit; taksat të kategorizohen sipas llojit të biznesit dhe të vendosen në bazë të vendndodhjes së biznesit; të ketë struktura më të zhvilluara dhe efikase për kontrollin dhe menaxhimin e taksave dhe tatimeve;*
- *rritja e transparencës në administratë (p.sh. kryerja e tenderave në mënyrë të hapur)*
- *menaxhim më i mirë dhe aftësi më e madhe në thithjen e fondeve*

- *Bashkia të luajë rolin e rregullatorit dhe të eliminohet biznesi i palicensuar*
- *biznesi të konsiderohet si partner*
- *të përcaktohet gjetja e mënyrave të prezantimit dhe bashkëpunimit mes bizneseve*
- *të përcaktohen zonat që mund të përdoren për zhvillim aktiviteti dhe të hartohen planet për biznesin*


4.3 Profili i Qytetit: Qeverisja vendore

4.3.1 Organizimi Institucional i Bashkisë Fier

Riorganizimi politiko-ekonomik në fillim të viteve '90 i hapi rrugën krijimit të institucionit të pushtetit vendor dhe rikthimit të autonomisë vendore, si dhe fillimit të funksionimit të një marrëdhënieje të re ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes. Në stadin aktual, është e kuptueshme se përvoja e institucionit të Bashkisë Fier është relativisht e re. Procesi i decentralizimit, si një nga zhvillimet më të rëndësishme në vend që po zbatohet në bazë të reformës së decentralizimit dhe Ligjit 8652 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjeve Vendore” (2000), synon zhvillimin institucional dhe rritjen e rolit të institucionit të Bashkisë në qeverisje nëpërmjet pajisjes me funksione dhe kompetenca ligjore dhe financiare më të mëdha. Megjithatë, pajisja me kompetenca dhe përgjegjësi të qarta brenda funksioneve të deleguara ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes mbetet një hallkë ende e dobët.

Gjatë viteve të fundit, përpjekjet e Bashkisë Fier janë drejtuar në mënyrë të veçantë në përshtatjen e një mentaliteti të ri në administratë dhe në strukturat vendimmarrëse mbi mënyrën e qeverisjes, rolin dhe

Figura 39: Struktura organizative e Bashkisë Fier 2005



përgjegjësitë gjatë procesit të qeverisjes. Këto ndryshime në drejtim të zhvillimit institucional kanë gjetur një përshtatje të vazhdueshme edhe në strukturën organizative të institucionit të Bashkisë, e cila paraqitet në Figurën 39.


4.3.2 Mjedisi i Biznesit

Zhvillimi ekonomik vendor dhe nxitja e biznesit janë tashmë funksione ekskluzive të Bashkisë Fier. Marrja e më shumë përgjegjësi në këtë drejtim ka rritur nivelin e ndërgjegjësimit në qeverisjen vendore mbi rëndësinë dhe rolin e sektorit privat të biznesit në zhvillimin ekonomik.

Zhvillimi i sektorit privat është mbështetur pozitivisht nga krijimi i një sërë strukturash dhe organizmash të ndryshëm, nga agjensitë e posaçme qeveritare në nivel qendror për nxitjen e bizneseve apo investimeve të huaja, në ato vendore dhe rajonale si për shembull agjensitë rajonale të zhvillimit apo dhomat e tregtisë dhe industrisë. Sidoqoftë, në nivel vendor, roli dhe niveli i koordinimit ndërmjet tyre është ende në zhvillim për arsye që kanë të bëjnë me kapacitetet teknike, financimin, kompetencat ligjore, etj.

Vlerësimet e komunitetit të biznesit të anketuar paraqitur në Figurën 40 nxjerrin në pah se institucionet vendore ende s’janë të përfshira aq aktivisht sa duhet në mbështetjen e biznesit. Dhoma e Tregtisë, si një ndër institucionet kryesore në këtë drejtim, ka një influencë ende të kufizuar nga qeveria dhe roli i saj më shumë është në krijimin e disa lehtësirave për biznesin. Marrëdhënia aktuale ndërmjet Dhomës dhe bizneseve zhvillohet më shumë mbi bazën e detyrimit ligjor të biznesit për t’u anëtarësuar dhe mbetet vetëm në kuadrin e regjistrimit dhe pagesës së kuotës vjetore. Niveli i anëtarësimeve në Dhomë është mbi 80% për

Figura 40: Niveli i mbështetjes së institucioneve vendore për biznesin



Burimi: Vrojtimi i Biznesit
* ARZH Agjensia Rajonale e Zhvillimit


biznesin e madh dhe nën 2% për biznesin e vogël, gjë

Tabela 14: Ecuria e numrit të bizneseve dhe të ardhurave (2000-2006)

Viti	Numri i bizneseve	Të ardhurat nga biznesi (në 000/lekë)
2000	1,300	82,921
2001	1,520	72,735
2002	1,621	89,234
2003	1,850	225,000
2004	1,950	280,000
2005	2,050	320,000
2006*	2,150	360,000

Burimi: Bashkia Fier, 2004

Figura 41: Vlerësimi i biznesit për nivelin e taksave




Burimi: Vrojtimi i Biznesit 2004

e cila tregon se bashkëpunimi ndërmjet Dhomës së Tregtisë dhe biznesit të vogël aktualisht nuk ekziston. Në këtë drejtim ndikon gjithashtu edhe një mungesë interesimi për t'u anëtarësuar nga 70% e bizneseve të vogla. Kjo bën që roli i Dhomës së Tregtisë të vlerësohet si pozitiv vetëm nga 25% e bizneseve lokale të anketuara.

Bashkia luan një rol kyç rregullator lidhur me nxitjen e biznesit të vogël dhe të mesëm nëpërmjet përcaktimit të nivelit të taksave, sigurimit të shërbimeve administrative të shpejta dhe cilësore, garantimit të konkurrencës, sigurimit të infrastrukturave fizike, etj. Duke i shërbyer nxitjes së zhvillimit të biznesit, rritja e numrit të bizneseve ka sjellë rritjen e qarkullimit të parasë si dhe rritjen e bazës së tatimpaguesve. Fieri jep,

Figura 42: Vlerësimi i biznesit për taksën e sigurimeve shoqërore



Burimi: Vrojtimi i Biznesit 2004


vetëm nga sektori privat, rreth 3 miliardë lekë për buxhetin e shtetit nga sistemi fiskal dhe doganor, pa llogaritur këtu derdhjet e sigurimeve shoqërore dhe detyrime të tjera ligjore. Tendanca e rritjes së të ardhurave vendore të siguruara prej bizneseve, që vërehet që nga viti 2000, parashikohet të vazhdojë edhe në vitin 2006 (Tabela 14).

*parashikim

Përmirësimi i të ardhurave vendore nga biznesi lidhet ngushtë me shëndoshjen e biznesit vendas. Në këtë drejtim, taksat janë një faktor kyç në ndërtimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet bashkisë dhe biznesit vendas, pavarësisht kompetencave për vendosjen e taksave. Një vlerësim për nivelin e taksave i paraqitur në Figurën 41 tregon se taksat janë të papërballueshme nga më shumë se 75% e biznesit të anketuar. Rritja e taksave është një ndër faktorët kryesorë për rritjen e shpenzimeve të biznesit në 2004 krahasuar me 2003.


Në veçanti, një ndër taksat e larta për biznesin është taksa për sigurimet shoqërore. Kjo taksë, e përcaktuar në nivel qendror, është e papërballueshme nga shumica e biznesit, sikurse paraqitet në Figurën 42. Në mungesë edhe të shtrëngesave ligjore të duhura, vlera e lartë e kësaj takse ka ndikuar në shfaqjen e problemeve të shmangies së biznesit nga deklarimi i vërtetë i numrit të të punësuarve.

Figura 43: Justifikimi i taksave me shërbimet



Burimi: Vrojtimi i Biznesit 2004

Figura 44: Koha e shpenzuar nga biznesi për procedurat administrative



Burimi: Vrojtimi i Biznesit 2004

Një prioritet i rëndësishëm i Bashkisë është sigurimi i shërbimeve sa më efektive për biznesin, në përputhje me standardet dhe kërkesat e tij, të cilat lehtësojnë dhe shpejtojnë zhvillimin e ekonomisë. Në shërbimin aktual që ofrohet ndaj biznesit, sidomos për sa i përket liçensimit të bizneseve dhe shlyerjes së detyrimeve fiskale (nga taksat), vërehet një boshllëk ndërmjet nivelit të taksave të paguara nga biznesi dhe nivelit të shërbimeve të ofruara, i vërejtur nga më shumë se gjysma e biznesit të anketuar. Boshllëku thellohet edhe më shumë sidomos në rastin e biznesit të vogël, në përputhje me ndjeshmërinë e kësaj kategorie për nivelin e lartë të taksave (Figura 43).

Kohëzgjatja e veprimeve administrative paraqitur në Figurën 44 tregon se, pavarësisht nga madhësia, biznesi shpenzon mesatarisht 25 ditë gjithsej për kryerjen e procedurave me autoritetet vendore. Konkretisht, nxjerrja e liçensës së ushtrimit të biznesit është një procedurë që kërkon mesatarisht 18 ditë dhe, pas fillimit të aktivitetit, shpenzohen mesatarisht 5 ditë të tjera për rinovimin e saj. Ndërkaq, për pagesën e taksave dhe tatimeve, biznesi shpenzon relativisht më shumë se 1 ditë, pavarësisht në Bashki apo në zyrat e tjera të pushtetit qendror.


Avantazhet e shërbimit bankar më të shpejtë, efikas dhe të sigurt, si dhe me garanci më të mëdha dokumentacioni, ndërmjet të tjerash, kanë çuar në rritjen e shkallës së ndërveprimit dhe përdorimit të sistemit bankar nga biznesi. Më shumë se gjysma e biznesit në tërësi (të madh e të vogël) ndërveprojnë rregullisht me sistemin bankar, ndërsa më shumë se gjysma e biznesit të madh i paguajnë taksat nëpërmjet sistemit bankar. Shtimi gjatë viteve të fundit i pranisë dhe aktivitetit bankar në Fier, nëpërmjet çeljes së më shumë degëve të institucioneve huadhënëse, po i jep sistemit bankar një rol gjithnjë e më shumë nxitës përsa i përket zhvillimit të biznesit dhe ekonomisë në tërësi. Sigurimi i një mbështetjeje financiare sa më të favorshme për biznesin, duke përfshirë kreditimin më të madh të tij, është

një domosdoshmëri për të vënë në lëvizje një ekonomi më të zhdërvjellët. Aktualisht, rezultojnë se janë rreth gjysma e biznesit të madh të anketuar që kanë marrë një kredi bankare (Figura 45). Megjithatë, kredimarrja nga biznesi i vogël qëndron në shifra ende të ulta duke patur parasysh se ato përbëjnë shumicën e bizneseve (75%).

Për të rritur tërheqjen e bizneseve në sistemin bankar dhe zgjerimin e financimit të tyre është e nevojshme aplikimi i interesave më të favorshme për kreditë, gjë që do të çonte në një rritje të kërkesave për kredi nga biznesi. Interesat e larta aktuale të huave ndikojnë në përballimin me vështirësi të kredive nga shumica e bizneseve huamarrëse të anketuara. Interesat e larta kanë çuar gjithashtu në humbjen e interesimit për kreditë dhe mospërfshirjen në sistemin bankar të një pjesë të konsiderueshme të biznesit (Figura 46).


Përdorimi në rritje i sistemit bankar nga biznesi nënvizon gjithashtu nevojën për përmirësimin dhe krijimin e lehtësirave të mëtejshme procedurale bankare për biznesin. Në mënyrë të veçantë, ulja e ndikimit nega-

Figura 45: Biznese që kanë marrë kredi




Burimi: Vrojtimi i Biznesit 2004

Figura 46: Vlerësimi i biznesit për kreditë



Burimi: Vrojtimi i Biznesit 2004

Figura 47: Vlerësimi i ndikimit të sistemit bankar në zhvillimin e biznesit



Burimi: Vrojtimi i Biznesit 2004

tiv qe sjellin interesat e larta ne zhvillimin e biznesit, sikurse vlerësohet aktualisht në Figurën 47, është parësore në drejtim të konsolidimit të biznesit të vogël dhe nxitjen e bizneseve të reja nëpërmjet kreditimit.

Ndërtimi dhe funksionimi i një ekonomie tregu në përputhje me zbatimin e rregullave për një konkurrencë të lirë dhe të drejtë është një sfidë e rëndësishme e periudhës së tranzicionit. Vlerësimi i biznesit për konkurrencën, paraqitur në Figurën 48, lidhet me mangësitë që duhen kapercyer në fushën e vendosjes dhe respektimit të konkurrencës së ndershme. Çështjet aktuale janë respektimi i dokumentacionit ligjor të biznesit, pajisja me licensë, prania e bizneseve të palicensuara¹, ushtrimi i aktivitetit në përputhje me zonën e veprimit të licensës, shlyerja e rregullt e taksave, zbatimi rigoroz i procedurave dhe standardeve, etj.

Nga sa më sipër, një nga nevojat kryesore, që evidentohehet nga biznesi pothuajse në mënyrë unanime, është ngritja e një strukture/njësie për mbrojtjen e konkurrencës si dhe e një strukture të specializuar për mbrojtjen e konsumatorit. Në mbi 80% të bizneseve, ngritja e këtyre strukturave identifikohet me rolin e Bashkisë, Dhomës së Tregtisë apo autoriteteve të tjera vendore apo qendrore.

Së fundi, sigurimi i një infrastrukture fizike të përshtatshme mbetet një nga faktorët kyçë për zhvillimin e sektorit privat. Zhvillimi i elementëve të ndryshëm të infrastrukurës ka ushtruar ndikime të konsiderueshme në ecurinë e biznesit, sikurse tregohet në Figurën 48. Mungesat në kanalizimet e ujërave të zeza (KUZ), në furnizimin me ujë, në pastrimin e mbeturinave etj, kanë ushtruar ndikime negative në më shumë se gjysmën e bizneseve, pavarësisht nga sektori apo madhësia e ak-

1 Këtu përfshihet edhe aktiviteti i fshatarëve në tregjet lokale.

tivitetit të tyre. Gjithashtu, mungesa e energjisë elektrike ka shkaktuar një ndikim të konsiderueshëm në ecurinë e biznesit, sigurimi normal i së cilës është një prioritet për më shumë se 80% të bizneseve të anketuara.


Nga ana tjetër, krahu i punës në Fier përbën një potencial që vlerësohet pozitivisht nga shumica e biznesit. Gjithashtu, rrugët, si pasojë e aksesit që krijon pozicioni gjeografik i favorshëm i Fierit, kanë një ndikim të rëndësishëm pozitiv për zhvillimin e biznesit. Si rrjedhim, nxitja e këtyre faktorëve pozitivë, nëpërmjet aktivizimit më të madh të krahut të punës dhe krijimit të korridoreve të reja rrugore, krahas plotësimit të elementeve të mësipërm të infrastrukturës bazë, përbën një nga konsideratat kryesore për një zhvillim domethënës të ekonomisë në Fier.

4.3.3 Qeverisja me pjesëmarrje për të gjithë

Bashkia Fier ka ndërmarrë përpjekje konkrete në drejtim të përfshirjes gjithnjë e më të madhe të qytetarëve si pjesë aktive në proceset e vendimmarrjes dhe në përcaktimin e prioriteteve të tyre. Proceset e informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes së komunitetit kanë njohur një zhvillim të vazhdueshëm lidhur me elemente kryesore si buxheti bashkiak, tenderat publikë, vendimet e rëndësishme strategjike etj.


Modeli më i fundit i kësaj përpjekjeje është përfshirja e gjerë aktive e komunitetit në hartimin e strategjisë aktuale, nëpërmjet organizimit të takimeve për thithjen e mendimit të komunitetit dhe konsultimit me grupet e interesuara për përcaktimin e prioriteteve afatgjata të zhvillimit të qytetit. Gjithashtu, vlen të përmendet pjesëmarrja aktive në bashkëpunimin me Qarkun e Fierit për hartimin e Strategjisë Rajonale të Zhvillimit të Qarkut të Fierit. Shembuj të tjerë të rëndësishëm janë gjithashtu botimi i përmuajshëm i Buletinit të Bashkisë, i cili informon rregullisht mbi veprimtarinë e Bashkisë në realizimin e të ardhurave nga tatim-taksat, nivelin e

Figura 48: Vlerësimi për konkurrencën



Burimi: Vrojtimi i Biznesit 2004

Figura 49: Ndikimi i infrastrukturës në zhvillimin e biznesit



Burimi: Vrojtimi i Biznesit 2004

shpenzimeve, prioritetet dhe investimet e realizuara e të planifikuara etj.


Rritja e shkallës së ndërveprimit me komunitetin, me qëllim për t’u përgjigjur sa më mirë nevojave të tij, është një prioritet i punës së Bashkisë. Megjithatë, përkundrejt fondeve në dispozicion të institucionit të Bashkisë, plotësimi në tërësi i nevojave të komunitetit mbetet ende një sfidë. Vlerësimi i banorëve për sa i përket përgjigjes së Bashkisë ndaj nevojave të tyre, në Figurën 50, nënvizon nevojën për rritjen e vëmendjes dhe aftësisë së Bashkisë ndaj plotësimit të nevojave të banorëve në të ardhmen.

4.4 Problematika e zhvillimit të qeverisjes

Orientimi ndaj biznesit si dhe konsiderimi i “qytetarit-klient” janë procese që gjithnjë e më shumë kanë gjetur zbatim në Bashkinë Fier, me qëllim krijimin e mundësive për përfaqësim të barabartë në të gjitha nivelet e procesit publik të vendimmarrjes dhe bashkëpunimit.

Në funksion të arritjes së një klime sa më të favor-

Figura 50: Shkalla e plotësimit të nevojave të komunitetit nga Bashkia



shme për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit privat të biznesit, ku bashkia ka një rol kryesor, është i nevojshëm krijimi i lehtësirave për taksa më të përballueshme, sidomos mbi biznesin e vogël; procedura më të shpejta administrative që rrisin cilësinë e shërbimit ndaj biznesit; garantimin e konkurrencës së ndershme si dhe sigurimin e infrastrukturës fizike më të përshtatshme për biznesin.

Në stadin aktual, njohuritë, përvoja dhe kapacitetet e pushtetit vendor dhe sektorit privat në operimin në tregun e lirë gjatë periudhës së tranzicionit janë relativisht të reja dhe të kufizuara. Marrëdhëniet e mirëfillta mungojnë jo vetëm në nivelin biznes-bashki por edhe ndërmjet vetë bizneseve. Gjithashtu, mungesa vërehen edhe në rrjedhjen e informacionit ndërmjet institucioneve publike dhe në marrjen e informacionit nga sektori privat.

Ndërkohë që prania e institucioneve publike, trajnuese dhe kërkimore si dhe e atyre financiare në mbështetje të zhvillimit të biznesit është rritur, në Fier dhe më gjerë. Një nevojë qendrore është koordinimi më i mirë ndërmjet tyre dhe një rol më i madh, për shembull, në kreditimin afatgjatë të biznesit me interesa të favorshme dhe në krijimin e mundësive më të mëdha për biznesin për sa i përket lëvizjes jashtë kufijve të vendit, ku vërehet sidomos roli i Dhomës së Tregtisë.

Niveli i dobët i koordinimit ekziston edhe ndërmjet institucioneve publike qendrore dhe atyre vendore në zbatimin e strategjive aktuale, si Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Social Ekonomik, si dhe atyre rajonale dhe lokale të zhvillimit. Për pasojë, programet e zhvillimit në shkallë rajonale janë shpesh të paintegruara dhe shfaqet mungesë qartësie në vendosjen e prioritetëve.

Së fundi, faktor vendimtar është procesi i decentralizimit, vonesat në zbatimin e të cilit kanë ndikuar me një konfuzion në ushtrimin e kompetencave nga pushteti vendor. Gjithashtu, transfertat financiare të dërguara nga qeveria qendrore janë të pamjaftueshme për sfidat me të cilat ndeshet pushteti vendor në përballimin e nevojave të komunitetit dhe të zhvillimit në tërësi.

KAPITULLI II FORMULIMI I STRATEGJISË


Krimimi i Mundësive

Strategjia e Zhvillimit të Qytetit të Fierit ngrihet mbi katër shtylla kryesore, të cilat mishërojnë nevojat më prioritare të qytetarëve për një jetë më të pasur materiale, kulturore dhe shpirtërore, në një mjedis më të mirë jetësor. Nëpërmjet “kanalizimit” të procesit të pjesëmarrjes qytetare bazuar në këto shtylla, strategjia ka fituar legjitimitetin e nevojshëm dhe përbën dokumentin statutor më të rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm të qytetit të Fierit. Katër shtyllat e strategjisë janë:

1. Zhvillimi Ekonomik
2. Zhvillimi Urban
3. Mjedis
4. Arsimit dhe Kultura

Strategjia e zhvillimit të qytetit të Fierit ndërton të ardhmen mbi faktorët pozitivë, duke ndërtuar në të njëjtën kohë mekanizma për shmangien e ndikimeve negative mbi qytetin. Këta faktorë pozitivë dhe negativë që ndikojnë qytetin, të cilët vijnë nga mjedisi i brendshëm dhe i jashtëm i qytetit, u identifikuan dhe analizuan për secilën nga fushat e mësipërme përgjatë procesit të konsultimit dhe bashkëpunimit të ngushtë me grupet dhe palët e interesuara të qytetit të Fierit. Identifikimi i faktorëve ndikues dhe tendencave në zhvillim janë çelësi për formulimin e strategjisë që vijon. Fuqitë, dobësitë, shanset dhe kërcënimet (SWOT) paraqiten në mënyrë të plotë në Aneksin 1 të këtij dokumenti.

Vizioni i zhvillimit të qytetit të Fierit është ngritur duke vlerësuar perspektivën e zhvillimit, bazuar mbi katër shtyllat e mësipërme dhe mbi elementet potencialë dhe mangësitë që shfaqen në to, i mishëruar me vullnetin për zhvillim të qytetarëve që e kanë miratuar atë. Ky vështrim vizionar është konkretizuar në një “hartë zbatimi” që çel rrugën e ndryshimit në qytet, nëpërmjet qëllimeve strategjike, objektivave dhe programeve të veçanta si dhe projekteve të mundshme për zbatim.



Seksioni 1 Vizioni dhe Qëllimet Strategjike të Zhvillimit të Qytetit të Fierit

Skeleti i vizionit për Fierin formohet nga nevoja urgjente për të rizbuluar dhe shfrytëzuar në mënyrë të qëndrueshme potenciale të tilla si: agrobiznesi, turizmi dhe trashëgimia historike dhe kulturore e rajonit, pozicioni i favorshëm gjeografik dhe potenciali për të qenë qendër e rajonit të Myzeqesë, të qenët qendër arsimore e rëndësishme si dhe burimet njerëzore me kapacitet të lartë dhe arsimdashës.

Vizioni ndërtohet edhe mbi nevojën për të shmangur problematikat më të rëndësishme të qytetit si mjedisin e ndotur dhe mungesën e infrastrukturave, shërbimeve dhe argëtimit në qytet. Ky vizion i përbashkët i qytetarëve të Fierit ngjiz në mënyrë konsensuale potencialet me problematikat më prioritare, duke “materializuar” atë energji potenciale që do të shkaktojë “momentin lëvizës” drejt Fierit të dëshiruar. Qartësimi i këtij vizioni nga ana e Bashkisë siguron zgjedhje të sakta, konsensus në vendimmarrje dhe zbatim të shpejtë.

1.1 Vizioni

Fieri, një e rëndësishme rajonale në sistemin poli-centrik të qyteteve përgjatë Korridorit Veri-Jug, qendër e rëndësishme shkëmbimesh dhe transporti prej dhe drejt tij në zemrën e zonës agroindustriale më të rëndësishme të Shqipërisë. Qendër e rëndësishme progresi, arsimit dhe kulture, që frymëzon dhe orienton zhvillimin rajonal nëpërmjet pajisjes së vazhdueshme me funksione të reja në harmoni me qendrat e tjera të rajonit.

Fieri, qytet i cili ka rindezur shpirtin e qytetarisë dhe është “qytet i banorëve” të tij, ku e ardhmja e qytetit kalon përmes fjalës së qytetarëve dhe është produkt edhe i vendimmarrjes së tyre, është fryt i integritetit social dhe i zgjidhjeve për nevojat e qytetarëve; Fieri, qendër urbane që pasurohet vazhdimisht me funksione të reja, hapësira publike dhe të gjelbra, kënde lojërash e ambiente argëtimi, jetë kulturore aktive; Fieri, qytet që u ka kthyer banorëve elementet më të rëndësishëm qytetformues dhe simbolet që përbëjnë thelbin e ekzistencës dhe identifikimit të tyre në vite, si Lumi Gjanica, lidhjet me Apolloninë, zona industriale, muzeu historik dhe biblioteka, ‘rrapenjtë’, kisha dhe xhamia, teatri Bylis, bar Rinia dhe qendra e qytetit; Fieri, qytet me infrastruktura dhe pa zona informale, ku të gjithë qytetarët, si në qendër edhe në periferi, kanë

akses të barabartë në shërbimet publike dhe sociale; Fieri, qytet ku transporti publik ka “revolucionarizuar” konceptimin hapësinor të qytetit dhe perceptimin e banorëve për të, cilësinë e ajrit nga ulja e ndotjeve të makinave dhe nivelin e zhurmave në qytet.

Fieri, qytet me prosperitet ekonomik i cili projektton të ardhmen mbi bazën e vlerave territoriale dhe shfrytëzimit të mençur të potencialeve ekonomike të agrobiznesit, tregtisë, tokës, turizmit bregdetar dhe kulturor, mjedisit të pastër dhe burimeve të çmuara natyrore. Kështu, Fieri ka krijuar një klimë të favorshme për fuqizimin e biznesit dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, gjë që ka rritur mundësitë për punësim dhe tërheqjen e investimeve nga brenda dhe jashtë vendit.

Fieri, qytet me burime njerëzore të kualifikuara në administratën publike dhe në sektorin privat dhe jo-qeveritar, të cilët bashkëpunojnë ngushtësisht me njëri-tjetrin dhe me qeverinë qendrore; qytet me një administratë që e mat suksesin e punës bazuar në strategjinë dhe objektivat të cilat bashkëndahen nga të gjithë qytetarët dhe në plotësimin e kërkesave të “qytetarëve-klientë”.

1.2 Qëllimet dhe Objektivat Strategjike

Bazuar në punën e grupeve tematike për secilën nga fushat e lartpërmendura, strategjia parashtron qëllimet strategjike të cilat më tej janë zbërthyer në objektiva dhe programe përkatëse dhe konkretizuar në projekte. Qëllimet dhe objektivat përkatëse janë renditur më poshtë, megjithatë kjo renditje nuk përfaqëson rëndësinë e tyre prioritare.

1. Fuqizimi i Sektorit Privat në Fier me Fokus Kryesor Agrobiznesin dhe Turizmin

1.1 Të mbështetet zhvillimi i prodhimeve agrobujqësore dhe zhvillimi i agrobiznesit

1.2 Të promovohen mundësitë për agroturizëm, turizëm historik dhe turizëm bregdetar për ta përfshirë Fierin në itinerarët e turizmit kombëtar dhe rajonal

1.3 Të forcohet bashkëpunimi midis institucioneve publike dhe sektorit privat në Fier

1.4 Të forcohet zbatimi i ligjit nga institucionet përgjegjëse publike në qytetin e Fierit dhe të promovohet thithja e investimeve të huaja dhe vendase

1.5 Të promovohet rritja e numrit të NVM-ve në Fier

2. Krijimi i kushteve social-ekonomike sa më të favorshme për zhvillimin e mëtejshëm të qytetit të Fierit

1.1 Të kryhet zhvillimi i koordinuar i shtrirjes hapësinore dhe numrit të popullsisë së qytetit me zgjerimin e rrjeteve të infrastrukturave inxhinierike dhe sociale

1.2 Të shtohen mjediset dhe aktivitetet për një jetë social-kulturore më të pasur në qytetin e Fierit

1.3 Të rivlerësohen vlerat e turizmit kulturor dhe historik të qytetit të Fierit

1.4 Të integrohen në qytet komunitetet me të ardhura të ulëta dhe komunitetet që jetojnë në zonat informale

3. Fuqizimi i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet, duke përfshirë këtu edhe themelimin e një bërthame universitare si elementi më i domosdoshëm për aftësimin e komunitetit dhe ngritjen e qëndrueshme ekonomike dhe sociale.

1.1 Të rritet cilësia e infrastrukturës fizike të sistemit të arsimit në të gjitha nivelet

1.2 Të përmirësohen metodologjitë e mësimdhënies në të gjitha nivelet dhe profilet e shkollave bazuar në arritjen e rezultateve: "të mësuarit për jetën"

1.3 Të rritet frekuentimi i institucioneve parashkollore

1.4 Të investohet në infrastrukturën fizike të Universitetit të ri të qytetit të Fierit me qëllim krijimin e një tradite në këtë fushë

4. Rikonceptimi i mënyrës së menaxhimit të territorit në Bashkinë Fier bazuar në pjesëmarrjen demokratike dhe transparente të të gjithë aktorëve të fushës së zhvillimit me qëllim kryesor zhvillimin ekonomik të qytetit.

4.1 Të rritet gama e përdorimeve në qytet bazuar në parashikimet e planit rregullues në favor të krijimit të një mjedisi më të jetueshëm dhe më funksional për banorët

4.2 Të bëhet manaxhimi i rikonstruksionit dhe rritjes së qytetit bazuar në "njësitë strukturore" të përcaktuara nga plani rregullues

4.3 Të nxitet transformimi i qytetit mbi bazën e përcaktimit të "ndërrhyrjeve strategjike katalitike" të afta të shtrijnë influencën në zona më të gjera të qytetit

4.4 Të fillojë procesi i legalizimit dhe urbanizimi i zonave informale bazuar në strategjinë kombëtare dhe në "teorinë e elementeve qendrorë" për të rritur shkallën e integritetit hapësinor dhe social të qytetit

4.5 Të formulohet një zgjidhje për çështjet e pronësisë

4.6 Të rehabilitohen dhe rigjenerohen zonat ekonomike industriale, duke përmirësuar infrastrukturën fizike dhe aksesibilitetin, si kusht për tërheqjen e bizneseve dhe krijimin e lehtësirave ndaj tyre

4.7 Të garantohet shfrytëzimi eficient i territoreve brenda vijës kufizuese ekzistuese bazuar në përcaktimet e planit rregullues me qëllim kompaktësimin e qytetit ekzistues

4.8 Të përmirësohet infrastruktura fizike (rrugë, telekomunikacion etj.) për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, nxitjen e biznesit dhe atë të një transporti publik sa më lehtësues për qytetarët

5. Përmirësimi i cilësisë së banimit nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së mjedisit brenda dhe

jashtë qytetit të Fierit

5.1 Të garantohet një nivel i ndotësve të mjedisit urban brenda standardeve të përcaktuar

5.2 Të rritet sipërfaqja e gjelbër e qytetit nëpërmjet ritrajtimit të hapësirave aktualisht të lira ose të pashfrytëzuara dhe krijimit të zonave të gjelbra përreth qytetit

5.3 Të punohet për të rritur ndjeshmërinë e banorëve ndaj problemeve të mjedisit

6. Rikonceptimi i punës së administratës së Bashkisë duke vënë në themel të shërbimeve konsiderimin e “qytetarit-klient”

6.1 Të fuqizohen në mënyrë strategjike kapacitetet e burimeve njerëzore në Bashki në mënyrë që t'i përgjigjen realizimit të këtij vizioni për të ardhmen e qytetit

6.2 Të nxitet sigurimi i shërbimit cilësor ndaj qytetarëve dhe biznesit dhe të ulet ndikimi i bizneseve informale në ekonominë lokale.

Seksioni 2 Fieri në rrugëtimin e Zhvillimit të së Ardhmes

Nisur nga vizioni dhe qëllimet e përgjithshme të strategjisë paraqitur më lart, ky seksion vijon me shtjellimin e rrugës përmes së cilës do të arrihet në realizimin konkret të vizionit. Ky seksion ndahet në katër nënseksione me tituj analogë me ata të Kapitullit të Parë. Nisur nga vizioni i përcaktuar, shtjellimi i strategjisë në çdo seksion vijon në mënyrë të përmbledhur me grupimin e atyre qëllimeve, objektivave dhe hapave konkretë që i përgjigjen realizimit të vizionit. Projektet e mundshme për zbatim janë shtjelluar në formën e portofolit të projekteve në Kapitullin 3. Ndërsa pasqyra e plotë e qëllimeve, objektivave dhe hapave konkretë paraqitet në Aneksin 2 të këtij dokumenti.

2.1 Zhvillimi i Fierit si Nyjë Rajonale

Vizioni:

“Fieri, nyjë e rëndësishme rajonale në sistemin policentrik të qyteteve përgjatë Korridorit Veri-Jug, qendër e rëndësishme shkëmbimesh dhe transporti prej dhe drejt tij në zemrën e zonës agroindustriale më të rëndësishme të Shqipërisë. Qendër e rëndësishme progresi, arsimit dhe kulture, që frymëzon dhe orienton zhvillimin rajonal nëpërmjet pajisjes së vazhdueshme me funksione të reja në harmoni me qendrat e tjera të rajonit.”

Në zhvillimin e qytetit të Fierit si nyjë e rëndësishme rajonale ndërthuren objektiva në fushën ekonomike, arsimore, territoriale, të cilat shkojnë në favor të forcimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të rolit të qytetit të Fierit si qendra më e madhe në rajon.

Në sferën ekonomike; Zhvillimi i dy sektorëve të agrobiznesit dhe turizmit si dhe tërheqja e investimeve të huaja dhe vendase janë faktorët (objektivat) kryesorë që do të ndikojnë në fuqizimin e mëtejshëm ekonomik të Fierit në rajon. Strategjia i jep përparësi zhvillimit të këtyre dy sektorëve, agrobiznesit dhe turizmit, bazuar në burimet dhe vlerat potenciale të bollshme natyrore, historike e kulturore që qyteti i Fierit ndan me rajonin përreth. Specializimi i mëtejshëm i ekonomisë së Fierit në këto dy drejtime do të theksojë ndërvarësinë ekonomike me burimet që furnizon rajoni përreth dhe natyrshëm do të ndikojë në rritjen e bashkëpunimit ekonomik dhe integritimit me rajonin.

Gjithashtu, në kuadër të nxitjes së investimeve të huaja dhe vendase, ndërmjet të tjerash, parashtrohen hapa konkretë për nxitjen e avantazheve konkurruese dhe krahasuese të qytetit të Fierit në raport me lokalitetet, duke ndërmarrë një studim për këtë qëllim, mbi bazën e të cilit do të dalin më në pah mundësitë për nxitjen e një bashkëpunimi ekonomik me këto lokalitete.

Në sferën arsimore; një faktor i rëndësishëm progresist në rajon do të jetë themelimi i një bërthame universitare në qytetin e Fierit, në kuadër të qëllimit për të fuqizuar sistemin e arsimit në të gjitha nivelet në Fier. Objektivi për hapjen e një universiteti dhe ngritjen e një kampusi universitar do të krijojë një avantazh të ri, duke u shërbyer më mirë nevojave të ekonomisë me një forcë pune më të kualifikuar dhe duke mbajtur në Fier studentët e shumtë që aktualisht studjojnë jashtë

Fierit.

Nga ana tjetër, thithja e studentëve edhe nga zonat përreth apo nga qytete të tjera do të forcojë pozitën e Fierit në rajon dhe më gjerë, duke e përfshirë Fierin në listën e qyteteve universitare. Në mënyrë të ngjashme, edhe Liceu Artistik “Jakov Xoxa” do të luajë një rol në rritje, nëpërmjet synimit për ta ngritur në një nivel prestigjioz që do të shërbejë për të tërhequr studentë jo vetëm nga i gjithë jugu por edhe nga i gjithë vendi.

Infrastruktura. Zhvillimi i infrastrukturave do të mbështesë rritjen e mëtejshme të qytetit të Fierit, sipas qëllimit të strategjisë për rikonceptimin e mënyrës së menaxhimit të territorit në Bashkinë Fier. Zhvillimi i disa infrastrukturave të rëndësishme rajonale, në mënyrë të veçantë pajisja me infrastrukturë e zonave strategjike të zhvillimit ekonomik pranë autostradës së ardhshme Fier-Vlorë si dhe përgjatë akseve kryesore të zhvillimit sipas përcaktimeve të planit rregullues, do të përshpejtojë investimet strategjike me influencë në ekonominë e qytetit. Ndërkohë, përmirësimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm i infrastrukturës fizike bazë si rrugë, telekomunikacion etj. gjithashtu do të krijojnë një lidhshmëri më të mirë të qytetit me të gjithë sistemin rajonal dhe kombëtar.

Zhvillimi hapësinor. Një ndër objektivat e zhvillimit hapësinor për qytetin e Fierit është edhe shfrytëzimi eficient i territorëve brenda vijës kufizuese ekzistuese të ndërtimit, me qëllim kompaktësimin e qytetit ekzistues. Në këtë drejtim, përcaktimi i drejtimeve dhe zonave të mundshme të shtrirjes së qytetit, e balancuar me përcaktimin e zonave për densifikim brenda vijës ekzistuese kufizuese të qytetit, janë një hap i rëndësishëm drejt një zhvillimi më të koordinuar dhe më të integruar të Fierit.

2.2 Zhvillimi i Fierit si Qytet i Banorëve të tij

Vizioni:

Fieri, qytet i cili ka rindezur shpirtin e qytetarisë dhe është qytet i banorëve të tij, ku e ardhmja e qytetit kalon përmes fjalës së qytetarëve dhe është produkt edhe i vendimmarrjes së tyre, është fryt i integritimit social dhe i zgjidhjeve për nevojat e qytetarëve; Fieri, qendër urbane që pasurohet vazhdimisht me funksione të reja, hapësira publike dhe të gjelbra, kënde lojërash/ambjente argëtimi, jetë kulturore aktive; Fieri, qytet që u ka kthyer banorëve elementet më të rëndësishëm qytetformues dhe simbolet që përbëjnë thelbin e ekzistencës dhe identifikimit të tyre në vite, si Lumi Gjanica, lidhjet me Apolloninë, zona industriale, muzeu historik dhe biblioteka, rrapenjtë, kisha dhe xhamia, teatri Bylis, bar Rinia dhe qendra e qytetit; Fieri, qytet me infrastruktura dhe pa zona informale, ku të gjithë qytetarët, si ata të qendrës edhe ata të periferisë, kanë akses të barabartë në shërbimet publike dhe sociale; Fieri, qytet ku transporti publik ka revolucionarizuar konceptimin hapësinor të qytetit dhe perceptimin e banorëve për të, cilësinë e ajrit nga ulja e ndotjeve të makinave dhe nivelin e zhurmave në qytet.

Popullsia është një nga konsideratat kryesore të përgjithshme të ndërtimit të kësaj strategjie, aq më tepër duke pasur parasysh rritjen e ndjeshme të popullsisë gjatë periudhës së tranzicionit. Qyteti i Fierit do të jetë në shërbim dhe funksion të banorëve të tij duke garantuar infrastruktura më të mira fizike, sociale, arsimore dhe një jetë social-kulturore më të pasur, të cilat do të ofrojnë një cilësi më të lartë jetese dhe

një vendbanim bashkëkohor ku të gjithë banorët e të gjithë grupmoshave, duke përfshirë banorët e ardhur, të ndajnë një shtëpi të përbashkët.

Zhvillimi i Infrastrukturave. Plotësimi i nevojave aktuale dhe zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturave fizike në qytetin e Fierit gjen një zbatim të gjerë në këtë strategji, në funksion të krijimit të kushteve social-ekonomike sa më të favorshme si dhe rikonceptimit të mënyrës së menaxhimit të territorit të qytetit.

Objektivat kryesore në këtë drejtim synojnë që rrjetet e infrastrukturave inxhinierike dhe sociale të arrijnë tek qytetarët në përputhje me shtrirjen hapësinore dhe numrin e popullsisë. Në favor të krijimit të një mjedisit më të jetueshëm dhe më funksional për banorët, gama e përdorimeve në qytet do të rritet. Menaxhimi më i mirë i rikonstruksionit dhe rritjes së qytetit mbi bazën e “njësive strukturore”, do të sigurojë në vazhdim një zhvillim të rregullt konform standardeve urbanistike të njësive ose blloqeve në qytet.

Strategjia përcakton një sërë programesh dhe ndërhyrjesh konkrete për zbatim, të cilat kanë si kornizë të përgjithshme dy plane: Plani i Ri i Përgjithshëm Rregullues për zhvillimin hapësinor të qytetit dhe Plani i Investimeve Kapitale. Bazuar në hartimin e këtyre planeve, një ndër hapat parësore është përcaktimi i radhës strategjike për ndërhyrjet përmirësuese apo ndërhyrjet e reja në linjat e infrastrukturave (rrugë, ujësjellës, kanalizime, elektrik, telefoni), krahas përgatitjes së studimeve pjesore për të gjitha njësitë strukturore dhe pasurimi i funksioneve brenda tyre.

Disa nga hapat dhe ndërhyrjet më të rëndësishme për sa i përket infrastrukturave janë:

Ndërhyrja në brendësi të blloqeve të banimit dhe në qytet. Me qëllim për të përmirësuar dhe rregulluar situatën aktuale në brendësi të blloqeve të banimit më të



populluara, parashtrahet për zbatim një projekt rivitalizimi në një bllok pilot në të gjitha fazat e tij. Ndërhyrje të tjera janë gjithashtu rikonstruksioni i të gjitha fasadave të qytetit (ndërhyrje në arkitekturën e fasadave); zbatimi i projekteve për ndriçimin publik të zonave / blloqeve të banimit; krijimin e zonave sportive në qytet dhe të argëtimit dhe lojërave për fëmijë.

Lëvizja këmbësore. Duke marrë parasysh trafikun e rënduar dhe të çrregullt nëpër qytet, strategjia synon në garantimin e një qyteti më miqësor ndaj këmbësorëve dhe biçiklistëve, nëpërmjet përdorimit më masiv të biçikletave dhe rritjes së frekuentimit këmbësor. Për këtë qëllim janë përcaktuar për t'u zbatuar investime për rregullimin në skemën e lëvizjes në qytet dhe plotësimin e sinjalistikës; si dhe përcaktimin e zonës së këmbësorëve të mbështetur nga rrjeti i parkimeve publike.

Transporti publik. Projekti për përmirësimin e transportit urban publik, si të linjave ashtu edhe të mjeteve të ndryshme sipas flukseve të nevojshme, si dhe shtrirja tij në brendësi të zonave informale nëpërmjet krijimit të stacioneve nëpër këto zona, do të jetë ndërhyrja kryesore. Ndërhyrje tjetër e rëndësishme është përfundimi i unazës së qytetit në pjesën veriore, e cila do të përmirësojë qarkullimin e përgjithshëm në qytet.

Gjelbërimi. Ndërhyrjet për përmirësimin dhe shitim të gjelbërimit shtrihen: në blloqet e banimit apo lagjen nëpërmjet rikonstruksionit të lulishteve ekzistuese dhe ndërtimit të lulishteve të reja në qytet; në pajisjen e të gjithë rrugëve ekzistuese të qytetit me gjelbërim rrugor dhe vendosjen e gjelbërimit rrugor përgjatë unazës veriore. Në veçanti, një ndërhyrje e rëndësishme do të jetë investimi për ngritjen e një parku për qytetin, e cila do të ndikojë ndjeshëm në kthimin e gjelbërimit në qytet.

Qytet për të gjithë. Synimi i strategjisë është që të sigurojë një zhvillim të njëllojtë të popullsisë, sidomos për sa i përket infrastrukturave të ndryshme. Programe të ndryshme në këtë drejtim kthejnë vëmendjen për komunitetet më të ardhura të ulëta dhe komunitetet në zonat informale, për vete specifiken dhe problematikën e tyre në qytetin e Fierit. Një hap tjetër do të jetë identifikimi i shtresave në nevojë dhe atyre me aftësi të kufizuara, kur bashkia synon të miratojë mekanizma për integrimin e tyre në jetën sociale dhe ekonomike të qytetit.

Zonat me ndërtimet informale. Ndërhyrja në zonat informale përfaqëson një ndërhyrje tërësore dhe shumëplanëshe. Objektivi i strategjisë është fillimi i

procesit të legalizimit dhe urbanizimit të zonave informale bazuar në strategjinë kombëtare. Hapat konkrete në aspektin ligjor përfshijnë formulimin e zgjidhjeve të çështjeve të pronësisë bazuar në zbatimin e Platformës së Legalizimit. Procesi i planifikimit të këtyre zonave është gjithashtu një hap i rëndësishëm, për të cilin do të ndërmerret përgatitja e planeve pjesore dhe komunitare në këto zona për ndërtimin e infrastrukturave fizike sekondare-terciare, dhe integrimi i këtyre planeve në Planin e ri Rregullues.

Këto hapa do t'i hapin rrugë investimeve konkrete që përcaktohen në strategji: në infrastrukturë fizike, për ndërtimin e akseve/linjave kryesore (primare) të infrastrukturave inxhinierike për lidhje të drejtpërdrejta të zonave informale me "qendrën"; për pajisjen e këtyre zonave me elementet qendrore (shërbime, stacione të transportit publik etj.), të cilat do të rrisin shkallën e integritimit hapësinor dhe social të qytetit.

Banesat sociale. Krijimi i mundësive për një strehim social në qytetin e Fierit përcaktohet në strategji në mënyrë të rëndësishme nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të një projekti ose programi për ndërtimin e banesave sociale të reja. Krahas ndikimit në situatën e strehimit dhe në pakësimin e numrit të lartë të të pas-trehëve në qytetin e Fierit, do të shërbejë gjithashtu për të lëvizur drejt një roli më aktiv të autoriteteve vendore për sa i përket menaxhimit të situatës së strehimit.

Punësimi. Në kuadër të zbatimit të programit për një punësim aktiv, një hap i rëndësishëm është ndërmarrja e projekteve pilot për punësimin e popullsisë me të ardhura të ulëta. Gjithashtu, një hap tjetër është kryerja e monitorimit të rregullt të papunësisë dhe gjendjes së varfërisë mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në qytetin e Fierit.

Arsimi. Aftësimi i komunitetit dhe ngritja e qëndrueshme ekonomike dhe sociale do të jenë gjithashtu rezultat i drejtpërdrejtë i qëllimit kryesor të strategjisë për fuqizimin e komponentit arsimor në të gjitha nivelet e tij, duke përfshirë themelimin e një bërthame universitare. Në përputhje me nevojat e zhvillimit në këtë fushë, objektivat e strategjisë janë për përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës shkollore dhe procesit të mësimdhënies në të gjitha nivelet, si dhe rritjes së frekuentimit të institucioneve parashkollore.

Përmirësimi i infrastrukturës shkollore. Kryerja e investimeve për përmirësimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës ekzistuese të objekteve arsimore do të bazohet në një studim të hollësishëm dhe teknik për mbulimin me shërbim (çerdhe, kopshte, shkolla të ar-

simit të detyruar, të mesëm të përgjithshëm dhe profesional), që do kryhet nga Bashkia në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Rajonale (DAR). Një vëmendje të veçantë në investimet për zhvillimin dhe ndërtimin e objekteve arsimore të reja do të kenë zonat informale, ku nevojat janë më të mëdha për ndërtimin e strukturave arsimore.

Hapat konkrete për përmirësimin e strukturave arsimore ekzistuese përfshijnë pajisjen e mjediseve të brendshme shkollore me mjete si laboratore, kabinete etj. dhe, nga ana tjetër, mjediset e jashtme me lulishte, kënde lojërash, terrene sportive etj. Më tej, qëllimi është ngritja e një biblioteke pranë çdo shkolle nëntëvjeçare e të mesme dhe futja e sistemit të informacionit për të kërkuar informacion "on line". Ndërsa, në arsimin e mesëm profesional, përmirësimi i kushteve të shkollave do të përqendrohet në ngritjen e një baze të plotë prodhuese pranë këtyre shkollave dhe përmirësimin e konvikteve të shkollave profesionale.

Ngritja e cilësisë së procesit mësimor ka si objektivi kryesor forcimin e proceseve mësimore bazuar në metodologji më praktike dhe më rezultative sipas konceptit: "të mësuarit për jetën". Në këtë drejtim, hapat e përcaktuar përfshijnë përmirësimin e teksteve shkollore dhe kurrikulave, duke përfshirë përdorimin e teksteve alternative. Për të monitoruar dhe vlerësuar në mënyrë sistematike tekstet e përdorur, është përcaktuar për t'u ngritur një komision shumëpalësh mësues-prindërzrtarë.

Në sistemin arsimor është e domosdoshme ngritja e një sistemi për menaxhimin e performancës dhe për këtë qëllim strategjia përcakton hartimin e standardeve të performancës si dhe mekanizmave nxitës për performancë të lartë. Forma që propozohen janë për shembull shpërndarja e stimujve materialë për mësuesit me përvojë; e çmimeve të përvitshme për shkollën me rezultate më të larta; bursa të përvitshme për nxënësit më të dalluar.

Arsimi i mesëm profesional. Nxitja dhe fuqizimi i arsimit profesional është parë në këndvështrimin për t'i dhënë një orientim të ri, më kuptimplotë në praktikë këtij lloji arsimit. Për vetë specifikën që ka ky lloji arsimit, përcakton si një ndër hapat e domosdoshëm krijimin dhe forcimin e lidhjeve të ngushta të shkollave të mesme profesionale, nga njëra anë me arsimin e lartë profesional dhe nga ana tjetër, me biznesin lokal, me qëllim për të mundësuar realizimin e praktikave mësimore të nxënësve pranë tyre.

Gjithashtu, për ta bërë arsimin profesional sa më tërheqës duke mundësuar thithjen e studentëve nga

qytete të tjera dhe zonat përreth, strategjia përcakton, krahas hartimit të mekanizmave nxitës dhe promovues, kryerjen e një studimi mbi mundësitë dhe potencialet konkrete që ofron tregu i punës për hapjen e degëve të reja profesionale. Këto nisma do të shoqërohen me përmirësimin e kushteve fizike të shkollave profesionale.

Rritja e frekuentimit të institucioneve parashkollore. Mënyra e propozuar për rritjen e frekuentimit të institucioneve parashkollore është nëpërmjet nxitjes së prindërve për t'i dërguar fëmijet në çerdhe e kopshte. Strategjia përcakton krijimin e lehtësirave dhe përfitimeve konkrete shëndetësore për fëmijët të cilët frekuentojnë çerdhet dhe kopshtet. Kjo nismë do të shoqërohet me fushatë mediatike për propagandimin e infrastrukturave të reja dhe të përmirësuara të objekteve parashkollore, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit të prindërve mbi rëndësinë e arsimit parashkollor.

Arsimi universitar. Investimi në infrastrukturën fizike të Universitetit të ri të qytetit të Fierit, me qëllim krijimin e një tradite në këtë fushë, është një nga objektivat më të rëndësishëm të strategjisë. Programi për ngritjen e një kampusi universitar përmban studimin e kapacitetit të nevojshëm të universitetit të Fierit dhe perspektivën e zhvillimit të tij, si dhe planin e hollësishëm për ngritjen e kampusit universitar bazuar në përcaktimet e planit rregullues. Hapi tjetër kryesor do të jenë investimet në infrastrukturën e re universitare, duke përfshirë ngritjen e bibliotekave, laboratorëve dhe mjediseve për jetën sociale të studentëve.

Jeta social-kulturore dhe sportive. Në fushën e kulturës dhe sporteve, objektivi kryesor i strategjisë lidhet me shtimin e mjediseve dhe aktiviteteve në funksion të një jete më të pasur dhe aktive social-kulturore në qytet. Programet në këto fusha trajtojnë gjerësisht përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese social-kulturore dhe sportive dhe zhvillimin e mëtejshëm të tyre, bazuar në Planin Rregullues të Përgjithshëm si dhe Planin e Qendrës së Fierit. Strategjia parashtron gjithashtu përmirësimin e mekanizmave institucionalë të sferës social-kulturore në Fier dhe propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e bazës ligjore.

Infrastrukturat kulturore. Ndërhurjet kryesore të përcaktuara për përmirësimin e infrastrukturës në fushën e kulturës përqendrohen në investimet për përmirësimin dhe rikonstruksionin e objekteve të veçanta ekzistuese si: Kinoteatri "Bylis" dhe Liceu Artistik "Jakov Xoxa". Lidhur me këtë të fundit, nëpërmjet investimeve, synohet arritja e një niveli prestigjioz jo vetëm për gjithë jugun por edhe për të tërhequr studentë në nivel kombëtar.

Në listën e objekteve të reja të rëndësishme social-kulturale në qytet përfshihen: ngritja e një godine të re me funksionin e një Qendre Rinore Kulturore; Galeri Artesh, në bashkëpunim me liceun artistik, me riprodhime të veprave të njohura të artit; Muze Etnografik për kostumografinë e pasur të treves së Fierit.

Për sa i përket sportit, objektet e reja të parashikuara janë: kryerja e një studimi mbi mundësinë e ndërtimit të një kompleksi sportiv ku të vendosen sportet e suksesshme të Fierit dhe identifikimi i sporteve përfituese; si dhe hartimi i projekteve të impianteve sportive në zonat e përcaktuara në Planin e Ri Rregullues.

Në nivel institucional. Si në fushën e kulturës dhe të sporteve, një nga nevojat e evidentuara është përmirësimi i marrëdhënieve institucionale. Për këtë qëllim, duke bërë më parë propozime për rishikimin për ndryshime në ligjin për sponsorizimet, përcaktohet si hap i rëndësishëm hartimi i mekanizmave nxitës dhe krijimi i lehtësirave fiskale, si dhe heqja e pengesave burokratike për investime nga biznesmenët. Në veçanti, krahas përmirësimit të marrëdhënieve institucionale, në fushën e sporteve synohet edhe rritja e të ardhurave për dhe nga sportet dhe rritja e buxhetit publik në dispozicion të sporteve.

Një vëmendje të vazhdueshme do të ketë shtimi i aktiviteteve kulturore nëpërmjet organizimit të koncerteve, festave etj. në sheshe publike, dhe shtrirja e këtyre aktiviteteve edhe në zonat e tjera të qytetit, duke detajuar një program aktiviteteve sociale/kulturore për banorët, dhe kryesisht të rinjtë, e komuniteteve me të ardhura të ulëta.

2.3 Zhvillimi i Fierit si Qytet i Mundësive

Vizioni:

Fieri, qytet me prosperitet ekonomik i cili projektton të ardhmen mbi bazën e vlerave territoriale dhe shfrytëzimit të mençur të potencialeve ekonomike të agrobiznesit, tregtisë, tokës, turizmit bregdetar dhe kulturor, mjedisit të pastër dhe burimeve të çmuara natyrore. Kështu, Fieri ka krijuar një klimë të favorshme për fuqizimin e biznesit dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, gjë që ka rritur mundësitë për punësim dhe tërheqjen e investimeve nga brenda dhe jashtë vendit.

Ndërmjet zhvillimit ekonomik aktual të qytetit të Fierit dhe vizionit për zhvillimin e qëndrueshëm në të ardhmen, ndërthuret bashkëveprimi i një sërë faktorëve ekonomikë, territorialë, gjeografikë, arsimorë dhe mjedisorë, të cilët parashtrihen në qëllimet e veçanta të

strategjisë.

Ekonomia. Zhvillimi i ekonomisë së qytetit të Fierit nëpërmjet fuqizimit të sektorit privat me fokus kryesor agrobiznesin dhe turizmin është një ndër qëllimet kyçe të strategjisë, e cila mbështetet nga një sërë objektive.

Zhvillimi i sektorit të agrobiznesit. Sektori i agrobiznesit shfaqet si një nga prioritetet kryesore për ekonominë e qytetit të Fierit, bazuar në traditën, burimet, dhe mundësitë ekzistuese në këtë fushë. Nisur nga këto premisa, objektivi i strategjisë është të mbështesë zhvillimin e prodhimeve agrobujqësore dhe zhvillimin e agrobiznesit në tërësi. Hapat për zhvillimin e agrobiznesit marrin parasysh dhe synojnë organizimin e sektorit të agrobiznesit në të gjithë zinxhirin nga fermeri prodhues tek marketingu i prodhimeve bujqësore dhe agroindustriale.

Në stadin aktual, në sektorin e agrobiznesit nevojitet një shtytje e përgjithshme. Një ndër hapat parësore për të përcaktuar të ardhmen e këtij sektori është vlerësimi i potencialeve në tregun lokal, rajonal dhe kombëtar për prodhimet e agrobiznesit, që do të kryhet nëpërmjet një studimi. Ky vlerësim do të rakordohet gjithashtu edhe me një orientim të përgjithshëm në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë lidhur me kultivimin dhe prodhimet bujqësore në Fier.

Për nxitjen e prodhimit bujqësor dhe agroindustrial, nga njëra anë do të synohet për të gjetur angazhimin e institucioneve mbështetëse në fushën e kërkimit dhe zhvillimit të agrobiznesit, njëherazi dhe vetë fermerëve. Këtu përfshihet trajnimi i fermerëve për përdorimin e mjeteve dhe metodave të avancuara në sektorin e agrobiznesit dhe për çështje sipas nevojave të tyre. Nga ana tjetër, do të stimulohet nxitja e kontratave ligjore me prodhuesit fermerë për sigurimin e lëndës së parë, si dhe për stimulimin e vetë fermerëve në organizimin e prodhimit nëpërmjet krijimit të "forumeve" të fermerëve, përpunuesve dhe shitësve të prodhimeve bujqësore.

Disa nga propozimet kryesore për përmirësimin e kushteve dhe kapaciteteve prodhuese janë: ngritja e fermave bujqësore; krijimi i zonave model të vizitueshme; krijimi i zonave të lira për dhënie me qira duke tërhequr investitorë në fushën e agrobiznesit, ngritja e tregut rural, duke përfshirë magazinim dhe përpunim të prodhimeve bujqësore si qendër shpërndarëse për rajonin dhe gjithë vendin dhe pranë këtij tregu, krijimin e zonave me profil agro-përpunues, si dhe në zona të tjera që kanë lidhje të mira me qytetin dhe rrethin e jashtëm të tij.



Shkëmbimi i informacionit dhe i përvojave në fushën e agrobiznesit do të jetë një përpjekje e vazhdueshme, për të cilën propozohet botimi i një buletini mujor mbi të dhënat lidhur me sektorin e agrobiznesit në rang kombëtar dhe rajonal, krahas vendosjes së një specialisti të agrobiznesit pranë Bashkisë. Gjithashtu parashtrohet njohja me mënyrën e grupimeve në fushën e agrobiznesit nga vende të tjera të rajonit.

Zhvillimi i turizmit. Sektori i turizmit është gjithashtu një prioritet për ekonominë e Fierit dhe interesi për zhvillimin e turizmit në Fier është në rritje. Bazuar në vlerat e evidentuara natyrore, historike dhe kulturore të shumta për turizëm në Fier dhe përreth tij, objektivi i strategjisë është të promovojë mundësitë për agroturizëm, turizëm historik dhe bregdetar. Në vija të përgjithshme, nëpërmjet dy programeve për zhvillimin e turizmit, strategjia synon në rikthimin dhe aftësimin e vlerave turistike dhe zhvillimin e infrastrukturës turistike dhe, nga ana tjetër, organizimin dhe ndërmarrjen e një marketingu për turizmin në Fier, që Fieri të përfshihet në itineraret e turizmit kombëtar dhe rajonal.

Në kuadër të rivitalizimit fizik të zonave historike përreth qytetit, ndërhyrjet përfshijnë zonat ekzistuese më të njohura turistike si Apolloninë, Ardenicën etj. Zona të reja turistike propozohen, si për shembull, ngritja e komplekseve turistike të reja në zonën e Vadhizës; apo rehabilitimi i disa zonave të vjetra të banimit (referencë plani rregullues) për kthimin e tyre në zona me interes turistik. Këto ndërhyrje në terren do të shoqërohen me krijimin e rrjetës historike të rajonit, për t'i bërë këto zona lehtësisht të aksesueshme dhe të vizitueshme.

Ndërhyrja më e madhe do të jetë për zhvillimin e infrastrukturës fizike që do të lidhë qytetin me zonat historike dhe natyrore, nëpërmjet lobimeve për projekte dhe investime, sidomos përmirësimi i infrastrukturës drejt Apollonisë. Një projekt i veçantë është krijimi i pavionit historik brenda teatrit të qytetit.

Promovimi i turizmit do të mbështetet në ngritjen dhe organizimin e strukturave të reja për turizmin. Këtu përfshihen krijimi i qendrës së informacionit për turizmin dhe marketingun në Bashki, si dhe bashkëpunimi apo koordinimi nëpërmjet organizimit të forumeve me institucionet publike qendrore, donatore dhe përfaqësues të sektorit të turizmit në dobi të thithjes së turistëve vendas dhe të huaj.

Propagandimi sistematik i produktit turistik përfshin hartimin dhe përgatitjen e një pakete materialesh promocionale turistike. Këto përfshijnë: prodhimin e një dokumentari dhe CD promocionale; krijimin e faqes së internetit; broshura për vendet turistike të vizitueshme dhe për hotelet; harta dhe guida turistike, publikimi i një guide për Apolloninë etj. Ndërsa aktivitetet turistike që propozohen përfshijnë organizimin e panairove rajonale dhe kombëtare, shpërndarjen e çmimeve lokale në turizëm; fushatë ndërgjegjësimit në median elektronike; cikle televizive mbi itinerarët dhe rrugët historike, etj.

Një vëmendje të veçantë ka zona e Apollonisë nëpërmjet hartimit të studimeve urbane në bashkëpunim me Komunën Ndërmenas, si dhe krijimit të mjediseve rekreative dhe përkrahja e zhvillimit të bizneseve turistike në këtë zonë.

Zhvillimi i sektorit privat. Sektori privat është forca kryesore e ekonomisë së Fierit. Strategjia mbështet zhvillimin e mëtejshëm të tij nëpërmjet një sërë hapash që i përgjigjen nevojave të zhvillimit të këtij sektori për sa i përket forcimit të mëtejshëm të klimës së bashkëpunimit, fuqizimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, nxitjes dhe tërheqjes të më shumë investimeve të huaja dhe vendase, krijimit të lehtësirave të ndryshme etj.

- Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Zhvillimi i sektorit të biznesit të vogël është i rëndësishëm për vetë peshën që zë në ekonomi numri i këtyre ndërmarrjeve, të cilat sigurojnë gjithashtu punësim për një pjesë të konsiderueshme të popullsisë. Strategjia mbështet zhvillimin e këtyre ndërmarrjeve nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të tyre dhe krijimit të më shumë hapësirave financiare për zhvillim. Kjo do të

ndihmojë në hapjen e më shumë bizneseve të tilla dhe rritjen e numrit të tyre.

Në nivelin e biznesit, për bizneset ekzistuese, synohet rritja e kapaciteteve njerëzore si dhe përmirësimi dhe standardizimi i produkteve të bizneseve të vogla, kryesisht nëpërmjet komponentit të trajnimeve dhe asistencës. Ndërsa në nivel sektori, fokusi është në përhapjen e një informacioni më të madh biznesi të garantuar nëpërmjet krijimit të mekanizmave dhe organizmave mbështetës, përgatitjes së broshurave informuese mbi shërbimet bankare të ofruara për biznesin privat etj.

- Hapja e bizneseve të reja. Përpjekja për çeljen e bizneseve të reja do të mbështetet nëpërmjet programeve konkrete për hapjen e bizneseve nga të rinjtë me aftësi për sipeërmarrje, si dhe nga krijimi i lehtësirave konkrete në financim. Strategjia përcakton ngritjen e disa mekanizmave dhe strukturave si: fondi i financimit për krijimin e NVM-ve; unioni i kreditit; mekanizmat për kreditim me interesa të ulëta nga bankat për sektorin prioritar të agrobiznesit; institucionalizimin e forumeve periodike midis institucioneve financiare, komunitetit të biznesit dhe Bashkisë për përmirësimin e shërbimeve etj.

Investimeve të Huaja dhe Vendase. për të mundësuar tërheqjen e investimeve të rëndësishme në Fier, strategjia përcakton kryerjen e një studimi mbi avantazhet konkurruese dhe krahasuese të qytetit të Fierit në raport me lokalitetet fqinje dhe nga ana tjetër nxitjen e bashkëpunimit ekonomik midis Fierit dhe këtyre lokaliteteve. Elemente të tjerë do të jenë përgatitja e profilit të sektorit të biznesit që operon në Fier dhe marketingu i lehtësirave që ofron për bizneset zona industriale ekzistuese.

Informacioni mbi paraqitjen e mundësive të investimit në Fier do të shpërndahet nëpërmjet materialeve si broshura "Ku mund të investoj në Fier" dhe guida "Si të investoj në Fier". Përcjellja e informacionit do të bëhet edhe nëpërmjet formave si forume të hapura televizive mbi mundësitë e investimit, me agjensitë publike në varësi të ministrive të linjës si edhe sektorit privat. Strategjia përcakton gjithashtu që nëpërmjet Këshillit Bashkiak të aprovohen mekanizma nxitës për thithjen e investimeve të huaja dhe vendase.

Zhvillimi territorial dhe hapësinor. Një faktor kyç në zhvillimin ekonomik perspektiv të qytetit të Fierit është gjithashtu zhvillimi territorial dhe hapësiror i qytetit. Rikonceptimi i mënyrës së menaxhimit të territorit në Bashkinë Fier pritet t'i japë një impuls të ri zhvillimit ekonomik të qytetit. Objektivat këtu i përgjigjen zh-

villimit të infrastrukturave për biznesin, plotësimin të infrastrukturave bazë dhe krijimit të infrastrukturave strategjike, të cilat do të nxisin ndjeshëm ekonominë. Disa nga ndërhyrjet më të rëndësishme ndërthuren në:

- (Ri)zhvillimi i zonave ekonomike industriale. Këto zona përfaqesojnë hapësira të tëra ish-industriale të braktisura në qytetin e Fierit dhe strategjia përcakton rehabilitimin dhe rigjenerimin e tyre duke përmirësuar infrastrukturën fizike dhe aksesibilitetin, si kusht për tërheqjen e bizneseve dhe krijimin e lehtësirave ndaj tyre.

Programi mbi shpërndarjen dhe përforsimin e funksioneve ekonomike në përputhje me prioritetet e zhvillimit ekonomik përcakton, mbi bazën e studimeve, kryerjen e investimeve për rigjenerimin e ish-zonave industriale të braktisura dhe ngritjen e zonës industriale, duke siguruar lidhje të sigurt të tyre me infrastrukturën primare.

Krijimi i inkubatorëve të biznesit. Zbatimi i konceptit të inkubatorëve të biznesit përfaqëson një model të ri të zhvillimit ekonomik në qytetin e Fierit dhe në vend. Hapja e inkubatoreve synon në ofrimin e mundësive për çeljen e bizneseve të reja të vogla nëpërmjet krijimit të kushteve të favorshme për mjedise pune dhe lehtësira të tjera fiskale. Strategjia parashtrohet për gatitjen dhe zbatimin e projekteve lidhur me krijimin e inkubatorëve të biznesit, duke shfrytëzuar hapësira aktualisht jashtë funksionit të ndërmarrjeve të dikurshme shtetërore ose të ish-zonave industriale.

Ndërhyrjet strategjike katalitike. Sot në Qytetin e Fierit evidentohet nevoja për të demonstruar ndërhyrje të tilla që shërbejnë si katalizatore për zhvillimin dhe transformimin e qytetit, të afta të shtrijnë influencën në zona më të gjera të qytetit. Programi "infrastruktura për zhvillim" parashtrohet zbatimin e këtyre ndërhyrjeve në një nyjë ose aks strategjik në zonën tradicionale të qytetit dhe shtrirjen e tyre në periferi ose jashtë zonës tradicionale të qytetit. Këto ndërhyrje do të bëhen në bazë të planeve pjesore në përputhje me përcaktimet e planit rregullues, shoqëruar me ngritjen e një sistemi për monitorimin e zhvillimeve në këto investime si dhe krijimin e mekanizmave lehtësues për investime në zonat e përcaktuara më sipër.

Zhvillimi i infrastrukturave fizike bazë për biznesin. Duke marrë parasysh rëndësinë e infrastrukturave në zhvillimin e biznesit, strategjia synon në përmirësimin e infrastrukturave fizike si rrugë, telekomunikacione etj., të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike dhe nxitjen e biznesit.

Në programin e përmirësimeve në infrastrukturë përfshihen ndërhyrje në zonat ekonomike dhe të biznesit si: studime dhe investime për infrastrukturën në pikat hyrëse dhe dalje të qytetit; investime fizike për përmirësimin e infrastrukturës së telekomunikacionit dhe përhapjen e gjerë të internetit në territorin e bashkisë; hapja e rrugëve dhe tregjeve të reja për ndërtim për integrimin e të ashtuquajturave zona joubane. Studime të tjera përfshijnë gjithashtu infrastrukturën e konsideruar strategjike për zhvillimin e ekonomisë dhe vënien në efikasitet të sistemit të transportit rrugor dhe hekurudhor.

Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm. Garantimi i një mjedisi të qëndrueshëm është hapi drejt synimit për një zhvillim të qëndrueshëm në Fier. Qëllimi kryesor i strategjisë është përmirësimi i cilësisë së mjedisit brenda dhe jashtë qytetit të Fierit lidhur me ndotjen, sipërfaqet e gjelbra të qytetit si dhe ndjeshmërinë e banorëve ndaj problemeve të mjedisit.

Toka, ajri dhe uji. Objektivi i strategjisë për të tre këta elemente bazë të mjedisit është për të recuperuar dhe frenuar ndotjen e tokës, ajrit, dhe ujit nga industria e naftës. Në programin për parandalimin e ndotjeve të tokës dhe ajrit parashtrohen një sërë ndërhyrjesh, duke nisur nga kryerja e një studimi mbi efektin e ndotësve industrialë në mjedis dhe shëndetin e banorëve.

Një ndër hapat kryesorë për pakësimin e ndotjes së ajrit do të jetë pajisja e të gjitha industrive ndotëse me sisteme të pluhur-kapjes dhe pastrimit të gazrave ndotës. Një hap tjetër do të jetë disiplinimi i trafikut dhe krijimi i zonave me trafik të kufizuar. Për sa u përket mbetjeve dhe pastrimit në përgjithësi, hapat konkrete do të jenë eliminimi i mbetjeve në ish-zonat industriale, pastrimi i tokës bujqësore rreth qytetit nga ndotësit e trashëguar, ngritja e qendrës për përpunimin e mbeturinave urbane, si dhe aplikimi i teknologjive të reja për pastrimin e rrugëve të qytetit.

Dsiplinimi i ndotjes së shkaktuar nga ujërat e zeza është gjithashtu një domosdoshmëri. Ndërhyrjet në këtë drejtim do të shtrihen nga ndërtimi i kolektorit për zonën lindore (Sheq i Madh, Lagjja 1 Maj) në rikonstrukcionin e rrjetit të kanalizimeve dhe shtimin e kapaciteteve. Një nismë e rëndësishme është ndërtimi i impiantit të trajtimit final të ujërave të zeza, duke realizuar më parë një studim për përcaktimin e llojit të vlefshëm të tij.

Lumi Gjanica. Për vetë problematikën mjaft të theksuar të ndotjes që mbart prej kohësh, Lumi Gjanica, i

cili përshkon qytetin në afërsi të qendrës, përbën një nga pikat më të nxehta të mjedisit në Fier. Përprojekjet për frenimin e ndotjes së Gjanicës në burim do të konkretizohen nëpërmjet vënies në funksionim të plotë të separatorëve në grupet e pompimit, stacione të dekantimit dhe në rafineritë për ndalimin e derdhjeve të hidrokarbureve në Gjanicë; sistemimit të linjave të transportit të naftës që kalojnë përgjatë ose tërthor lumit për të eliminuar derdhjet e naftës në të; dhe riinjektimit të ujërave shoqërues të naftës në shtresë nëpërmjet puseve të braktisur;

Lumi Gjanica do të synohet të shndërrohet në një element pozitiv në qytet. Ndërhyrjet në këtë drejtim do të jenë veshja e brigjeve të Gjanicës me gjelbërim dhe mure mbajtës dhe më tej sistemimi i zonave përgjatë Gjanicës nëpërmjet një studimi urbanistik dhe krijimi i zonave rekreative dhe sportive përgjatë shtratit të lumit.

Këto ndërhyrje i shërbejnë njëherazi edhe qëllimit për rritjen e sipërfaqes së gjelber në qytet, nëpërmjet ritrajtimit të hapësirave aktualisht të lira ose të pashfrytëzuara. Gjithashtu, një ndërhyrje tjetër është edhe zbatimi i studimit dhe investimeve për rigjenerimin e fushës ekzistuese të mbeturinave në brigjet e Lumit Seman, për ta integruar atë në fashën e gjelbër të Semanit.

Ndërgjegjësimi mjedisor. Rritja e ndjeshmërisë së banorëve ndaj problemeve të mjedisit do të gjejë zbatim nëpërmjet programit për zbatimin e Konventës së Arhusit dhe një projekti nëpërmjet të cilëve banorët të njihen dhe bëhen zbatues të kësaj konvente. Nismë tjetër për ndërgjegjësimin e banorëve është ndarja dhe riciklimi i mbeturinave të ngurta urbane.

2.4 Zhvillimi i Fierit si Qytet me Qeverisje të Mirë

Vizioni:

“Fieri, qytet me burime njerëzore të kualifikuara në administratën publike, sektorin privat dhe joqeveritar, të cilët bashkëpunojnë ngushtësisht me njëri-tjetrin dhe me qeverinë qendrore, që masin performancën e tyre bazuar në objektivat dhe strategjinë të cilat ndahen nga të gjithë qytetarët dhe plotësimin e kërkesave ndaj “qytetarëve-klient.”



Krijimi i një klime pozitive bashkëpunimi është një nga pikat kyçe për zhvillimin e qytetit në përputhje me vizionin e përcaktuar. Qëllimi i strategjisë është rikonceptimi i punës së administratës së bashkisë, duke vënë në themel të shërbimeve konsiderimin e “qytetarit-klient”. Objektivat i përgjigjen nga njëra anë nevojës për ngritjen në mënyrë strategjike të kapaciteteve njerëzore në bashki për realizimin e këtij vizioni. Nga ana tjetër, ato përqendrohen në sigurimin e shërbimeve cilësore ndaj qytetarëve dhe biznesit, si dhe forcimin e ligjit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike dhe private.

Sigurimi i shërbimeve cilësore administrative. Strategjia parashtron një sërë hapash për përmirësimin e



shërbimeve administrative ndaj biznesit. Taksat përbëjnë një fushë për përmirësim të ndërsjellë si në funksion të detyrimeve për biznesin dhe të përmirësimit të sistemit financiar të Bashkisë. Për këtë arsye, propozohet kryerja e studimeve lidhur me uljen e nivelit të burokracisë me qëllim uljen e kohës së derdhjes së detyrimeve që biznesi paguan ndaj shtetit; vlerësimin e efekteve të uljes së taksave dhe tarifave; si dhe vlerësimin e pranisë së biznesit informal në territorin e Bashkisë. Këto studime do të vijnë krahas rifreskimit të vazhdueshëm të bazës së të dhënave mbi bizneset që operojnë në Fier. Në kuadër të planifikimit të investimeve, Bashkia do të ndërmarrë gjithashtu hartimin e Planit të Investimeve Kapitale (PIK).

Një moment tjetër i rëndësishëm lidhet me licencimin e biznesit. Në këtë kuadër parashikohet thjeshtimi i rregullave dhe procedurave për të kryer biznes, miratuar nëpërmjet Këshillit Bashkiak. Në plotësim të këtyre masave, informimi do të jetë i vazhdueshëm nëpërmjet organizimit të emisioneve televizive mbi ligjet, rregullat dhe procedurat e ushtrimit të aktivitetit për biznes.

Ofrimi i shërbimeve cilësore bashkëkohore do të realizohet edhe on-line nëpërmjet faqes së internetit të Bashkisë që do të krijohet; ndërtimit të sistemit të informacionit në bashki; si dhe instalimi i zyrës me një ndalesë në bashki. Gjithashtu, lidhur me shërbimet do të synohet thellimi i bashkëpunimit midis administratës së bashkisë me shoqërinë civile dhe sektorin privat mbi legjislacionin për prokurimin e shërbimeve.

Komponenti i trajnimeve është përcaktuar si kyç për zhvillimin në mënyrë strategjike të kapaciteteve të bashkisë, në fusha si zhvillimi ekonomik, shkrimi i projekt-propozimeve, investimet, menaxhimi i informacionit, trajnimi i stafit të zyrës me një ndalesë për biznesin e vogël, mbi të drejtën e informimit dhe mënyrat e komunikimit etj.

Përmirësimi i klimës së biznesit dhe i bashkëpunimit publik-privat. Në stadin aktual, strategjia konsideron parësor forcimin e zbatimit të ligjit nga institucionet përgjegjëse publike dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike dhe sektorit privat në Fier.

Strategjia përcakton si të domosdoshëm përcaktimin e një serie masash për forcimin e zbatimit të ligjit, gjë për të cilën parashtron lobimin nëpërmjet Shoqatës së Bashkive, grupit të deputetëve të Fierit dhe institucioneve të tjera qendrore. Në mbështetje të inisiativave për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve, si dhe për veprimet institucionale që duhen ndërmarrë, do

të jetë krijimi i një komisioni teknik ekspertësh ligjorë pranë institucionit të bashkisë.

Mekanizmat dhe format që propozohen për përmirësimin e bashkëpunimit përfshijnë: institucionalizimi i forumeve për të krijuar sinergjinë e duhur ndërmjet sektorëve të ndryshëm publikë e privatë dhe për të lobuar për fonde nga të gjitha burimet e mundshme; krijimi i rrjetit të sektorit privat në Fier, përmes ngritjes së forumit online dhe bazës së të dhënave; shpërndarja e çmimeve për biznesmenin më të suksesshëm të vitit dhe për ndërmarrjen më të mirë të sektorit, duke përfshirë në gjykim kriterin për nivelin e respektimit të mjedisit dhe të "biznesit social".

Në mënyrë të veçantë, krijimi nga ana e bashkisë i organizmave monitorues dhe vlerësues për zbatimin e strategjisë do të jetë një nga hapat më të rëndësishëm që do të sigurojë mbështetjen kryesore për kryerjen e hapave të mësipërm.

KAPITULLI III

PORTOFOLI I PROJEKTEVE

Katalizatorët e zbatimit të strategjisë

Në këtë kapitull janë paraqitur 33 projekte të përpunuara, të cilat i paraprijnë zbatimit të strategjisë së zhvillimit të Fierit në afatin e shkurtër dhe të mesëm. Këto projekte formojnë Portofolin e Projekteve. Këto projekte kanë përparësi për zbatim dhe janë përzgjedhur nga lista e plotë e përgjithshme e ndërhyrjeve/hapave konkrete të strategjisë paraqitur në Aneksin 2, bazuar në kohën që nevojitet për zbatimin e tyre në raport me prioritetet e Bashkisë dhe të qytetit. Në këtë mënyrë, portofoli i projekteve përfaqëson një përmbledhje të prioriteteve të Bashkisë për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, si dhe tregon drejtimet e punës së saj për një periudhë të paktën 5-vjeçare.

Çdo projekt i paraqitur këtu është përpunuar sipas formatit të Fletës Informative të Projektit. Për çdo projekt ka një përshkrim të shkurtër që shtjellon kontekstin e ndërhyrjes, qëllimin korrespondues, mënyrën e zbatimit, kohën e zbatimit, buxhetin, si dhe aktorët, përfituesit dhe kontribuesit e mundshëm të tij. Portofoli i projekteve është rezultat i analizës së informacionit të kryer gjatë takimeve të punës me qytetarët në përputhje me prioritetet dhe vizionin për zhvillimin e Fierit.

Lista e projekteve të përpunuara

1. Krijimi i zonave të lira për t'iu dhënë me qira investitorëve të agrobiznesit
2. Vendosja e një specialisti të agrobiznesit në zyrën e informacionit pranë Bashkisë
3. Projekt për sinjalistikën e rrugëve, ku të vendosen tabela orientuese për Apolloninë, Ardenicën dhe zona të tjera turistike
4. Ngritja e një qendre informacioni për turizmin dhe marketingun në Bashki / Krijimi i faqes së internetit / Përgatitja e broshurave mbi vende turistike për t'u vizituar si dhe broshura për hotele / Përgatitja e hartave dhe guidave turistike
5. Asistencë pranë një agjensie turistike lokale për përgatitjen e paketave turistike lokale (kombinim i buri-meve historike/kulturore/natyrore)
6. Hapja e një Agjensie Zhvillimi Ekonomik Rajonal
7. Vendosja e linjës telefonike dedikuar ankesave të bizneseve
8. Përgatitja e broshurave "Ku mund të investoj në Fier"
9. Përgatitja e broshurave "Procedurat për të kryer biznes në Fier"
10. Hartimi i programit dhe zbatimi i trajnimeve mbi përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe njohja me standardet ISO
11. Përgatitja e një broshure informuese mbi shërbimet bankare të ofruara për biznesin privat
12. Institucionalizimi i forumeve periodike midis institucioneve financiare, komunitetit të biznesit dhe Bashkisë për të përmirësuar shërbimet për biznesin
13. Projekte lidhur me themelimin e inkubatorëve të biznesit duke përdorur hapësira aktualisht jashtë funksionit të ndërmarrjeve të dikurshme shtetërore ose ish zonave industriale
14. Investime në skemën e lëvizjes në qytet dhe në sinjalistikë në mënyrë që të mundësojë përdorimin e biçikletave dhe frekuentimin e lartë këmbësor / Investime për përcaktimin e zonës së këmbësorëve të mbështetur nga rrjeti i parkimeve publike / Projekt për përmirësimin e transportit urban publik si në drejtim të linjave ashtu edhe të mjeteve të ndryshme sipas flukseve të nevojshme
15. Zbatimi i projekteve për ndriçimin publik të zonave/blloqeve të banimit
16. Pajisja e objekteve të arsimit me mjedise me funksion rekreativ (lulishte, kënde lojërash, terrene sportive etj.)
17. Pajisja e strukturave arsimore ekzistuese me ambientet funksionale të mësimi (laboratore, kabinete etj.)
18. Të ngrihet një bibliotekë pranë çdo shkolle nëntëvjeçare e të mesme
19. Krijimi i lidhjeve mes biznesit lokal dhe shkollave profesionale duke mundësuar që nxënësit e këtyre shkollave të kryejnë praktikën pranë bizneseve vendase (Murialdo, Qendra e re e Aftësimi Profesional – nga Zyra e Punës)
20. Studim mbi kapacitetin e nevojshëm të universitetit të Fierit dhe perspektivën e zhvillimit të tij / Studim i detajuar për ngritjen e kampusit universitar bazuar në përcaktimet e planit rregullues
21. Investime fizike për përmirësimin e infrastrukturës së telekomunikacionit dhe përhapjen e gjerë të internetit në territorin e Bashkisë
22. Sigurimi i ngritjes dhe funksionimit të qendrës monitoruese të ndotësve të ajrit, ujit dhe tokës
23. Ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza urbane për lagjet "11 Janari", "1 Maj" që aktualisht derdhen në lumin Gjanica
24. Lobing pranë qeverisë për t'u imponuar kompanive Albpetrol, Armo dhe TEC respektimin e normave ligjore mbi mbrojtjen e mjedisit
25. Pastrimi i ujërave nga shkarkimet industriale
26. Pastrimi i Lumit Gjanica nga mbetjet inerte dhe sistemimi i shpateve
27. Veshja e brigjeve të Gjanicës me gjelbërim / Krijimi i zonave rekreative dhe sportive përgjatë shtratit të lumit
28. Ndërtimi i një parku të madh urban

29. Vlerësim i nevojave për trajnim
30. Kryerja e trajnimeve të stafit bashkiak mbi konceptet e aplikuara të ZHEL / Trajnim i stafit bashkiak në shkrimin e projekt propozimeve / Kryerja e trajnimeve për stafin bashkiak dhe sektorin privat mbi Partneritetet Publike Private / Trajnim i stafit bashkiak në menaxhim projektesh dhe afësi menaxheriale
31. Instalimi i zyrës me një ndalesë në bashki për biznesin “One-Stop Shop”
32. Ngritja e Zyrës për shërbimin e qytetarëve
33. Trajnime të stafit bashkiak në menaxhimin financiar dhe planifikimin e investimeve

QËLLIMI 1. Fuqizimi i sektorit privat në Fier me fokus kryesor agrobiznesin dhe turizmin	
OBJEKTIVI 1.1 Të mbështetet zhvillimi i prodhimeve agrobuqësore dhe zhvillimi i agrobiznesit	
PROGRAMI 1.1.1 Programi për zhvillimin e agrobiznesit	Emri i projektit 1.1.1.14 Krijimi i zonave të lira për t'iu dhënë me qira investitorëve të agrobiznesit
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Agrobiznesi në Fier është një nga fushat e identifikuara si më prioritare për fuqizimin e ekonomisë lokale dhe zhvillimin e qytetit në tërësi. Duke qenë se relievi dhe kushtet natyrore të Fierit janë të përshtatshme për zhvillimin e kulturave agrobuqësore, maksimizimi i shfrytëzimit të këtyre potencialeve do të krijojë një fuqi për Fierin dhe në të njëjtën kohë do të maksimizojë shanset. Ky projekt konsiston në krijimin e zonave të lira për t'iu dhënë me qira investitorëve të agrobiznesit. Për këtë specialistët përkatës do të bëjnë një studim të zonave ku është e mundur kjo gjë. Pasi të identifikohen këto zona do të bëhet një organizim apo ekzaminim i zonave dhe identifikimi i cilësive të tyre. Pasi është bërë një përcaktim në këtë drejtim, këto zona do t'i vihen në shërbim investitorëve të interesuar kundrejt një qiraje. Kjo qira do të variojë në saje të tokës, sipërfaqes dhe faktorëve të tjerë. Për zhvillimin e këtij biznesi mund të ndiqen dhe politika të ndryshme stimuluese, p.sh. toka mund t'i lihet një investitori për një qëllim të caktuar pa paguar qira për një kohë të caktuar si fillim. Ky projekt ndihmon në shfrytëzimin e potencialeve ekzistuese dhe ndihmon në dhënien e vlerave si një zone të caktuar ashtu edhe biznesit duke e shndërruar atë në frytdhënës. Hapat nëpër të cilat është parashikuar të kalojë ky projekt janë listuar më poshtë: - Identifikimi i zonave ku është e mundur zhvillimi i agrobiznesit - Studimi i zonave në dispozicion për zhvillimin e agrobiznesit - Organizimi i zonave dhe specifikimi i tyre sipas karakteristikave - Hartimi i politikave stimuluese për arritjen e objektivave të vendosura në kuadrin e zhvillimit të agrobiznesit - Specifikimi i qirasë për këto zona në varësi edhe të karakteristikave të tyre	
OBJEKTIVAT - Shfrytëzimi në mënyrën e duhur i potencialeve ekzistuese - Kthimi i zonave të caktuara në zona të zhvilluara agrobiznesi - Lokalizimi i agrobiznesit në zonat e duhura dhe të përcaktuara - Mbështetja e zhvillimit të prodhimeve agrobuqësore dhe zhvillimi i agrobiznesit	GRUPET E SYNUARA - Komuniteti i biznesit - Fermerë të ndryshëm - Investitorë, të interesuar për të investuar në agrobiznes - Konsumatorët e prodhimeve agrobuqësore
AKTORE TË PËRFSHIRË DIREKT - Bashkia Fier - Specialistë në fushën e agrobiznesit - Investitorë të interesuar për zhvillimin e agrobiznesit - Fermerë të shumë fermave të vogla, të cilët duan të rrisin aktivitetin e tyre - Biznese ekzistuese të cilët janë të interesuar ta kultivojnë vetë lëndën e parë - Institucionet financiare në kreditimin e bizneseve që dëshirojnë të ngrenë një agrobiznes	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - Pushteti qendror - Specialistë të bashkisë - Asistencë financiare nga komuniteti i biznesit - Asistencë teknike nga ekspertë lokalë dhe të huaj
BUXHETI I PLANIFIKUAR 5,000 euro (deri tek studimi)	KOHA E ZBATIMIT Janar-Maj 2006

QËLLIMI 1. Fuqizimi i sektorit privat në Fier me fokus kryesor agrobiznesin dhe turizmin	
OBJEKTIVI 1.1 Të mbështetet zhvillimi i prodhimeve agrobujqësore zhvillimi i agrobiznesit	
PROGRAMI 1.1.1 Programi për zhvillimin e agrobiznesit	Emri i projektit 1.1.1.15 Vendosja e një specialisti të agrobiznesit në zyrën e informacionit pranë Bashkisë
PËRSHKRIM I PROJEKTIT <p>Agrobiznesi është përcaktuar si një nga sektorët kryesorë ku do të bazohet zhvillimi ekonomik i Fierit. Në këtë kuadër, informacioni lehtësisht i sigurueshëm mbi politika apo vendime që prekin fushën e agrobiznesit përbën një hap elementar por mjaft të dobishëm për zhvillimin e këtij sektori. Për këtë qëllim, është menduar për vendosjen e një specialisti të agrobiznesit pranë zyrës së informacionit në bashki. Ky person do të shërbejë si pikë kontakti dhe do të koordinojë punën me institucione publike përgjegjëse për botimin e artikujve, broshurave apo edhe njoftimeve të ndryshme në këtë fushë. Gjithashtu informacioni i siguruar do të mund të sigurohet edhe në formë elektronike, në faqen e internetit të bashkisë.</p> <p>Hapat nëpër të cilat do të kalojë ky projekt janë listuar më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vendosja e një personi të përgatitur nga ana profesionale dhe njohuri në disa fusha të tjera pranë zyrës së informacionit - Informimi i të gjithë të interesuarve lidhur me çështje që prekin sektorin e agrobiznesit - Mbajtja e lidhjeve dhe komunikimi periodik me të gjithë këta biznesmenë - Marrja e mendimeve, ideve dhe eksperiencave të këtij grupi për të mbledhur një informacion të vlefshëm për bashkinë - Publikimi i broshurave, informacioneve periodike, artikujve etj. nga zyra e informacionit - Hedhja e informacionit në faqen në internet të bashkisë Fier 	
OBJEKTIVAT <ul style="list-style-type: none"> - Marrja e vendimeve efektive dhe frytdhënëse për zhvillimin e agrobiznesit - Rritja e bashkëpunimit dhe e komunikimit midis palëve - Zhvillimi i agrobiznesit 	GRUPET E SYNUARA <ul style="list-style-type: none"> - Komuniteti i biznesit - Fermerë të ndryshëm - Investitorë, të interesuar për të investuar në agrobiznes - Konsumatorët e prodhimeve agrobujqësore - Institucione publike lokale dhe qendrore që operojnë në Fier
AKTORE TË PËRFSHIRË DIREKT <ul style="list-style-type: none"> - Bashkia Fier - Drejtoria e Bujqësisë - Shoqata të Biznesit 	KONTRIBUTE TË MUNDSHME <ul style="list-style-type: none"> - Qeverisja lokale - Specialistë të bashkisë - Asistencë teknike nga ekspertë lokale dhe organizata të zhvillimit që operojnë në Fier - Investitorë të interesuar për zhvillimin e agrobiznesit - Fermerë të shumë fermave të vogla, të cilët duan të rrisin aktivitetin e tyre
BUXHETI I PLANIFIKUAR 25,700 Lekë/muaj	KOHA E ZBATIMIT Shkurt 2006

QËLLIMI 1. Fuqizimi i sektorit privat në Fier me fokus kryesor agrobiznesin dhe turizmin	
OBJEKTIVI 1.2 Të promovohen oportunitetet për agroturizëm, turizëm historik dhe bregdetar për ta përfshirë Fierin në itineraret e turizmit kombëtar dhe rajonal.	
PROGRAMI 1.2.1 Programi për rivitalizimin fizik të zonave historike përreth qytetit dhe për krijimin e infrastrukturave lidhëse me burimet turistike/natyrore të rajonit	Emri i projektit 1.2.1.2 Projekt për sinjalistikën e rrugëve, ku të vendosen tabela orientuese për Apolloninë, Ardenicën dhe zona të tjera turistike
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Turizmi është përcaktuar si një nga sektorët kryesorë ku do të bazohet zhvillimi ekonomik i Fierit. Rivitalizimi fizik i zonave historike përreth qytetit dhe krijimi i infrastrukturave lidhëse me burimet turistike/natyrore të qytetit do të mundësonte një akses më të lehtë të turistëve në këto zona si dhe të investimeve dhe krijimin e bizneseve të ndryshme. Ky projekt ka për qëllim pikërisht pajisjen e rrugëve me një sinjalistikë e cila të orientojë turistët apo individët nga një pozicion i përshtatshëm deri në arritjen e zonave turistike. Në këtë projekt do të projektohen tabelat orientuese dhe do të caktohen vendet ku do të vendosen këto tabela. Kjo do të ndihmojë në promovimin e oportuniteteve për turizëm historik dhe bregdetar dhe do të shërbejë për përfshirjen e Fierit në itineraret e turizmit kombëtar dhe rajonal. Këto tabela do të përmbajnë të gjithë elementet e nevojshëm dhe një pamje të vogël të zonës turistike. Ato do të tërheqin turistët dhe, në të njëjtën kohë do të ndihmojnë në orientimin dhe lehtësimin e shkuarjes në këto zona. Gjithashtu thithja e më shumë turistëve do të ndihmojë në zhvillimin e bizneseve ekzistuese dhe, në të njëjtën kohë në hapjen e bizneseve të rinj. Hapat nëpër të cilat parshikohet të kalojë ky projekt janë listuar më poshtë: - Përgatitja e projektit teknik në bashki - Projektimi i tabelave dhe i vendeve ku do të vendosen këto tabela dhe përcaktimi i kostove të projektit - Bashkëpunimi me një studio, dhe paraqitja në mënyrë sa më atraktive e zonës turistike	
OBJEKTIVAT - Promovimi i zonave turistike historike dhe bregdetare - Thithja e turistëve dhe orientimi në zonat turistike - Zhvillimi i bizneseve ekzistuese - Ngritja e bizneseve të rinj - Përfshirja e Fierit në itineraret e turizmit rajonal dhe kombëtar - Rivitalizimi fizik i zonave turistike dhe krijimi i infrastrukturave lidhëse me këto burime	GRUPET E SYNUARA - Turistët vendas dhe të huaj - Qytetarët e Fierit dhe zonave përreth - Sektori privat i biznesit që operon në fushën e turizmit dhe shërbimeve të lidhura me të
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT - Bashkia Fier – zyra e hartimit të projekteve - Studio - Bizneset e zhvilluara në këto zona	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - Asistencë teknike nga ekspertë lokalë dhe të huaj - Specialistë të bashkisë - Asistencë financiare nga komuniteti i biznesit
BUXHETI I PLANIFIKUAR 10,000 Euro	KOHA E ZBATIMIT Shkurt – Maj 2006

QËLLIMI 1. Fuqizimi i sektorit privat në Fier me fokus kryesor agrobiznesin dhe turizmin	
OBJEKTIVI 1.1 Të promovohen oportunitetet për agroturizëm, turizëm historik dhe bregdetar për ta përfshirë Fierin në itineraret e turizmit kombëtar dhe rajonal	
PROGRAMI 1.2.2 Programi i promovimit të turizmit në Fier.	Emri i projektit 1.2.2.2 Ngritja e një Qendre Informacioni për Turizmin dhe Marketingun në Bashki 1.2.2.6 Krijimi i faqes së internetit 1.2.2.7 Përgatitja e broshurave mbi vende turistike për t'u vizituar si dhe broshura për hotele 1.2.2.8 Përgatitja e hartave dhe guidave turistike
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Turizmi është identifikuar në Strategjinë e Zhvillimit të Fierit si një nga sektorët prioritarë ku do të bazohet zhvillimi ekonomik i qytetit. Puna do të përqendrohet në promovimin e shanseve për turizëm që kanë rrethi dhe qyteti i Fierit dhe, për këtë qëllim, sigurimi me lehtësi i informacionit përmes ngritjes së zyrës së informacionit në Bashki. Informacioni do të shpërndahet në rrugë elektronike, përmes krijimit dhe operacionalizimit të faqes së internetit, ku do të publikohen vlerat arkeologjike, historike, kulturore dhe turistike të qytetit të Fierit. Kjo faqe do të përmbajë edhe reklamimin e hoteleve apo restoranteve të ndryshëm apo biznese të tjera. Ngritja e zyrës do të shërbejë si pikë kontakti ku të gjithë njerëzit e interesuar mund të drejtohen dhe të marrin informacion të dobishëm në pak kohë. Zyra do të përgatisë gjithashtu harta, guida turistike, broshura, fletushka, video promovionale, etj. Hapat përmes të cilave është parashikuar të kalojë ky projekt janë listuar më poshtë: - Identifikimi i hapësirës së lirë në mjediset e Bashkisë ku mund të ngrihet zyra e informacionit - Përgatitja e projektit për ngritjen e zyrës dhe e buxhetit të nevojshëm për aktivitetin e zyrës - Lobim dhe kontakte me organizata zhvillimi për financimin e pjeshëm/të plotë të zyrës - Ngritja e zyrës në mjediset e Bashkisë me të gjitha kushtet dhe pajisjet e nevojshme - Hartimi i strategjisë për promovimin e turizmit në Fier dhe marketingun në qytet - Hartimi i plan-veprimit për promovimin e turizmit në Fier - Përgatitja e broshurave, fletushkave etj. që lehtësojnë promovimin e turizmit në Fier - Krijimi dhe operacionalizimi i faqes në internet	
OBJEKTIVAT - Promovimi i turizmit në qytetin e Fierit - Rritja e bashkëpunimit midis institucionit të Bashkisë dhe operatorëve turistikë që operojnë në Fier, në nivel rajonal dhe kombëtar - Sigurimi i lehtë i informacionit për turizmin tek palët e interesuara - Ngritja e një zyre në ambientet e bashkisë - Përfshirja aktive e Fierit në itineraret e turizmit rajonal dhe kombëtar	GRUPET E SYNUARA - Bizneset që operojnë në Fier dhe jashtë tij në fushën e turizmit - Turistët vendas dhe të huaj - Komuniteti
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT - Dhoma e Tregtisë - Komuniteti i biznesit dhe shoqata biznesi - Bashkia - Përfaqësues të turizmit - Agjensi publicitare - Zyra projektimi	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - Qeverisja lokale - Specialistë të bashkisë - Asistencë financiare nga komuniteti i biznesit - Asistencë teknike dhe financiare nga organizata zhvillimi që operojnë në Fier dhe në rang kombëtar
BUXHETI I PLANIFIKUAR 3,000 Euro	KOHA E ZBATIMIT Prill – Dhjetor 2006

QËLLIMI 1. Fuqizimi i sektorit privat në Fier me fokus kryesor agrobiznesin dhe turizmin	
OBJEKTIVI 1.2 Të promovohen oportunitetet për agroturizëm, turizëm historik dhe bregdetar për ta përfshirë Fierin në itineraret e turizmit kombëtar dhe rajonal.	
PROGRAMI 1.2.2 Programi i promovimit të turizmit në Fier	Emri i projektit 1.2.2.14 Asistencë pranë një agjencie turistike lokale për përgatitjen e paketave turistike lokale (kombinim i burimeve historike/kulturore/natyrore)
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Të gjitha vlerat historike, natyrore dhe burimore që gjenden në territorin e qytetit të Fierit dhe rrethinave përreth kanë nevojë të promovohen fuqishëm për t'i dhënë shtysë zhvillimit të turizmit dhe për ta përfshirë Fierin në itineraret e turizmit kombëtar dhe rajonal. Ky projekt ka për qëllim realizimin e një produkti në formën e një pakete turistike në të cilën të kombinohen dhe të paraqiten burimet historike, kulturore dhe natyrore. Për këtë projekt do të bashkohen specialistë të këtyre fushave dhe do të përcaktojnë burimet që mbartin vlera historike, kulturore dhe natyrore. Pasi është bërë mbledhja dhe përcaktimi i burimeve që do të paraqiten në këtë paketë, do të bëhet një organizim i informacionit, i fotografive dhe një përmbledhje e tyre. Kjo sintezë do të jetë bërë në mënyrën më të mirë të mundshme dhe do të fokusohet në paraqitjen dhe dhënien e një imazhi të duhur për këto zona. Në të njëjtën kohë materiali do të përqendrohet në pikat e forta dhe do të nxjerrë në pah vlerat e vërteta që këto burime kanë. Më pas këta persona bashkë me materialet e grumbulluara do të bashkëpunojnë me një agjensi turistike lokale. Këta persona do të asistojnë gjatë gjithë procesit të përgatitjes së paketës turistike. Ata do të monitorojnë ecurinë dhe, në të njëjtën kohë do të rregullojnë pjesët ku paketa ka nevojë për përmirësime. Hapat nëpër të cilat parashikohet të kalojë ky projekt janë listuar më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> - Ngritja e një grupi specialistësh në fushat e historisë, kulturës dhe burimeve natyrore - Mbledhja, përpunimi dhe organizimi i gjithë informacionit mbi këto burime - Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i ideve me një agjensi turistike lokale për përgatitjen e paketave turistike lokale - Asistencë e vazhdueshme në këtë zyrë për monitorim dhe rregullim të ecurisë së përgatitjes së paketës - Botimi i paketës turistike dhe shpërndarja e saj tek palët e interesuara 	
OBJEKTIVAT <ul style="list-style-type: none"> - Promovim i vlerave historike, kulturore dhe natyrore - Përfshirja e Fierit në itineraret e turizmit kombëtar dhe rajonal - Bashkëpunim publik-privat 	GRUPET E SYNUARA <ul style="list-style-type: none"> - Turistët - Qytetarët e Fierit dhe zonave përreth për kalimin e festave të ndryshme në këto zona - Bizneset që operojnë në fushën e turizmit
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT <ul style="list-style-type: none"> - Specialistë të kulturës - Specialistë të historisë - Specialistë të burimeve natyrore - Agjensi turistike lokale - Bashkia Fier 	KONTRIBUTE TË MUNDSHME <ul style="list-style-type: none"> - Specialistë të bashkisë në kulturë, histori dhe burime natyrore - Asistencë financiare nga komuniteti i biznesit - Asistencë teknike dhe financiare nga organizatat e zhvillimit që operojnë në Fier
BUXHETI I PLANIFIKUAR 3,000 Euro	KOHA E ZBATIMIT Janar – Prill 2006

QËLLIMI 1. Fuqizimi i sektorit privat në Fier me fokus kryesor agrobiznesin dhe turizmin	
OBJEKTIVI 1.3 Forcohet bashkëpunimi midis institucioneve publike dhe sektorit privat në Fier	
PROGRAMI 1.3.1 Programi i bashkëpunimit publik-privat	Emri i projektit 1.3.1.5 Hapja e një Agjensie Zhvillimi Ekonomik Rajonal
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Aktualisht, rajoni i Fierit nuk ka një qendër zhvillimi ekonomik rajonal e cila të mbikqyrë dhe drejtojë nismat më të mëdha në një mënyrë të organizuar dhe të sinkronizuar. Zona ka shumë resurse për zhvillim të cilat duhet të konsiderohen të nivelit rajonal (në nivel qarku). Qendra do të ofrojë shërbime të tilla si marketing rajonal; asistencë teknike për bizneset, veçanërisht për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme; rekrutim biznesi; komunikim me komunitetin e biznesit; koordinim të perpjekjeve për turizëm rajonal; lobing dhe rritje fondesh nëpërmjet qeverisë qendrore dhe komunitetit të donatorëve. Bashkia po kërkon fonde të mbulojë kostot operuese të qendrës për 2 vjet.	
OBJEKTIVAT - Kryerja e planit të zhvillimit ekonomik lokal dhe e drejtimit të zhvillimit ekonomik në një nivel rajonal në lidhje me iniciativat e zhvillimit ekonomik kombëtar - Ndërtimi apo ngritja e një mekanizmi monitorues dhe vlerësues i cili vazhdimisht do të kontrollojë dhe drejtojë zbatimin e zhvillimit strategjik të qytetit dhe të rajonit - Shitja e rajonit të Fierit bizneseve të reja - Sigurimi i asistencës teknike për bizneset rajonale	GRUPET E SYNUARA - Bizneset ekzistuese të cilat operojnë në nivel rajonal - Investitorë potencialë kombëtarë dhe të huaj - Komuniteti i Fierit si qyteti dhe rajoni (qarku) - Struktura të qeverisjes lokale dhe qendrore që operojnë në zhvillimin ekonomik lokal dhe rajonal
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT - Bashkia Fier/Zyra e politikave të zhvillimit - Bashki të tjera pjesë të Qarkut Fier - Institucione qeverisëse rajonale - Dhoma e Tregtisë dhe e Industrisë - Prefektura - Komuniteti i biznesit	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - Qytetet dhe komunat në Qarkun e Fierit - Komuniteti i biznesit - OJQ vendore - Asistencë teknike e siguruar nga ekspertë lokalë dhe të emigruar - Organizata Donatorësh Ndërkombëtare/Institucione Financiare
BUXHETI I PLANIFIKUAR 45,000 EURO	KOHA E ZBATIMIT 3 vjet, 2006-2008

QËLLIMI 1. Fuqizimi i sektorit privat në Fier me fokus kryesor agrobiznesin dhe turizmin	
OBJEKTIVI 1.4 Të forcohet zbatimi i ligjit nga institucionet përgjegjëse publike në qytetin e Fierit dhe të promovohet thithja e investimeve të huaja dhe vendase.	
PROGRAMI 1.4.1 Programi për përmirësimin e klimës së biznesit	Emri i projektit 1.4.1.3 Vendosja e linjës telefonike dedikuar ankesave të bizneseve
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Përmirësimi i klimës për biznes është përcaktuar si një shtyllë kryesore ku do të bazohet fuqizimi i sektorit privat. Në këtë kuadër, forcimi i zbatimit të ligjit nga institucionet publike përgjegjëse, rritja e transparencës dhe bashkëpunimi publik-privat janë në qendër të zbatimit të strategjisë së zhvillimit të qytetit. Më konkretisht, vendosja e një linje telefonike brenda bashkisë Fier për të marrë informacion dhe ankesa nga qytetarë dhe përfaqësues të sektorit privat është menduar si një projekt konkret që shkon në linjë me objektivat e sipërpërmendura. Informacioni i marrë do t'i shërbejë sidomos drejtorive brenda bashkisë për të vlerësuar punën e tyre kundrejt shërbimeve të siguruara për biznesin si dhe për të kryer rregullimet dhe përmirësimet e nevojshme. Kjo linjë do të jetë gjithashtu e hapur dhe për ankesa ndaj bizneseve të caktuara të cilat përmes aktiviteteve të tyre ndërhyjnë negativisht në jetën e përditshme të qytetarëve. Në këtë mënyrë edhe bizneset do të bëhen më të përgjegjshme ndaj qytetarëve në respektimin e të drejtave të tyre. Hapat nëpër të cilat parashikohet të kalojë projekti janë listuar më poshtë: - Vënia e një linje dedikuar qytetarëve - Vendosja e një punonjësi efektiv për të mirëpritur ankesat e qytetarëve - Identifikimi i abuzimeve të mundshme dhe faktike - Marrja e masave ndëshkuese të shkallëve të ndryshme në varësi të abuzimit të identifikuar	
OBJEKTIVAT - Informim dhe vlerësim mbi mënyrën e performimit të punonjësve në vendin e tyre të punës - Vërtetimi i ankesave dhe analiza e situatës me dëmet përkatëse - Ulja e korrupsionit në organet përgjegjëse - Rritja e shkallës së kënaqjes dhe motivimit të qytetarëve për përmbushjen e detyrimeve përkatëse qytetarëve - Rritje e komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet palëve	GRUPET E SYNUARA - Bashkia Fier - Komuniteti i biznesit - Komuniteti i Fierit
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT - Bashkia - Biznese të ndryshme - Qytetarët e Fierit - Punonjës publikë	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - Asistencë teknike nga ekspertë lokale - Suport i OJF, me projekte të ndryshme në këtë drejtim
BUXHETI I PLANIFIKUAR 200 Euro	KOHA E ZBATIMIT Janar 2006

QËLLIMI 1. Fuqizimi i sektorit privat në Fier me fokus kryesor agrobiznesin dhe turizmin	
OBJEKTIVI 1.4 Të forcohet zbatimi i ligjit nga institucionet përgjegjëse publike në qytetin e Fierit dhe të promovohet thithja e investimeve të huaja dhe vendase.	
PROGRAMI 1.4.2 Programi për promovimin e investimeve të drejtpërdrejta vendase dhe të huaja.	Emri i projektit 1.4.2.2 Përgatitja e broshurave “Ku mund të investoj në Fier”
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Një nga fokuset kryesore të strategjisë së zhvillimit të Fierit është plani i ri rregullues i qytetit. Në këtë plan parashikohen dhe hapësirat e lira në funksion të zhvillimit të biznesit dhe korridoret e reja që parashikohen të zhvillohen për këtë qëllim. Në vijim, këto hapësira të reja do të shoqërohen dhe me studime mbi mundësinë e shfrytëzimit për zhvillimin ekonomik. Në këtë kuadër është menduar dhe hartimi i një broshure orientuese mbi mundësitë e thithjes së investimeve në qytetin e Fierit, qofshin ato vendase apo të huaja. Ky material do të shërbejë kryesisht për të kaluar informacion tek investitorët e interesuar si dhe tek agjensitë publike që mbulojnë zhvillimin ekonomik të cilat merren me ofrimin e mundësive që ofron Shqipëria dhe rajone të veçanta të saj për thithjen e investimeve të huaja direkte. Më konkretisht hapat nëpër të cilat duhet të kalojë projekti janë listuar më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> - Përfundimi dhe miratimi i planit të ri rregullues të Fierit - Identifikimi i hapësirave të lira për zhvillimin e biznesit - Kryerja e studimeve për llojin e aktiviteteve që do të zhvillohen brenda hapësirave të lira - Përgatitja e broshurës “Ku mund të investoj në Fier” dhe përcaktimi i përgjegjësisë - Shpërndarja e broshurës tek palët e interesuara - Kalimi i informacionit në faqen në internet të bashkisë Fier 	
OBJEKTIVAT <ul style="list-style-type: none"> - Thithja e investimeve nga investitorë vendas dhe investimeve të huaja - Promovimi i mundësive për investim tek palët e interesuara publike dhe private që operojnë në Shqipëri dhe jashtë saj 	GRUPET E SYNUARA <ul style="list-style-type: none"> - Komuniteti i Biznesit - Komuniteti i Fierit - Investitorë të huaj - Investitorë vendas
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT <ul style="list-style-type: none"> - Dhoma e Tregtisë - Shoqata të tjera biznesi - Bashkia - Komuniteti i biznesit - Agjensia për promovimin e investimeve të huaja - Agjensia për zhvillimin e SME-ve 	KONTRIBUTE TË MUNDSHME <ul style="list-style-type: none"> - Qeverisja qendrore - Specialistë të bashkisë - Asistencë financiare nga komuniteti i biznesit - Asistencë teknike
BUXHETI I PLANIFIKUAR 500 Euro	KOHA E ZBATIMIT Shtator 2006

QËLLIMI 1. Fuqizimi i sektorit privat në Fier me fokus kryesor agrobiznesin dhe turizmin	
OBJEKTIVI 1.4 Të forcohet zbatimi i ligjit nga institucionet përgjegjëse publike në qytetin e Fierit dhe të promovohet thithja e investimeve të huaja dhe vendase.	
PROGRAMI 1.4.2 Programi për promovimin e investimeve të drejtpërdrejta vendase dhe të huaja.	Emri i projektit 1.4.2.3 Përgatitja e broshurave “Procedurat për të kryer biznes në Fier”
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Shpesh herë një investitor mund të gjejë fushën apo llojin e biznesit ku do të fokusohet, por është shumë i painformuar për sa i përket procedurave të nevojshme për ngritjen e një biznesi. Ky nivel jo i plotë informacioni sjell vonesa në kohë në licensimin e bizneseve dhe mungesa në njohuri për qytetarët e interesuar. Për të shmangur këtë dukuri, është menduar përgatitja e broshurave “Procedurat për të kryer biznes në Fier”. Kjo broshurë do të përgatitet nga specialistë të fushave të ndryshme të cilët do të bashkëpunojnë në hartimin e kësaj broshure. Në këtë broshurë investitorëve do t’i bëhen të njohura të gjitha procedurat e nevojshme për të hapur një biznes apo për të investuar në Fier, institucionet përgjegjëse si dhe aspekte ligjore të lidhura me procesin. Gjithashtu koha e nevojshme dhe kostot për liçensim do të jenë elemente të tjerë të kësaj broshure. Më konkretisht hapat nëpër të cilat pritet të kalojë ky projekt janë listuar më poshtë: - Identifikimi i specialistëve sipas institucioneve dhe ngritja e grupit të punës nën udhëheqjen e bashkisë Fier - Analizimi i shpejtë i procedurave ekzistuese dhe identifikimi i institucioneve pjesëmarrëse në grupin e punës - Grumbullimi i informacionit dhe kryerja e një analize mbi procedurat e licensimit të biznesit nga grupi i punës në bashkëpunim dhe me përfaqësues të sektorit privat - Sinteza e të gjithë informacioneve e analizave dhe përgatitja e broshurës “Procedurat për të kryer biznes në Fier” - Shpërndarja e broshurës tek palët e interesuara	
OBJEKTIVAT - Ulje e kohës dhe kostove për hapjen e një biznesi dhe kryerjen e një investimi në Fier - Rritja sensibilizimit ndaj zbatimit të ligjshmërisë - Ulja e konflikteve ndërmjet palëve të ndryshme - Rritja e nivelit të transparencës për shërbimet e siguruara nga institucionet publike ndaj sektorit të biznesit - Rritja e bashkëpunimit publik-privat	GRUPET E SYNUARA - Komuniteti i Biznesit - Komuniteti i Fierit - Zyra e tatim-taksave në rreth dhe bashki - Bashkia Fier dhe institucione të tjera publike që merren me zhvillimin e biznesit - Institucione mbështetëse të biznesit
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT - Dhoma e Tregtisë - Shoqata të tjera biznesi - Bashkia - Komuniteti i biznesit	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - Pushteti qendror - Specialistë të bashkisë - Asistencë financiare nga komuniteti i biznesit - Asistencë teknike nga ekspertë lokalë dhe të huaj
BUXHETI I PLANIFIKUAR 1,000 Euro	KOHA E ZBATIMIT Mars 2006

QËLLIMI 1. Fuqizimi i sektorit privat në Fier me fokus kryesor agrobiznesin dhe turizmin	
OBJEKTIVI 1.5 Të promovohet rritja e numrit në NVM-ve në Fier	
PROGRAMI 1.5.1 Programi për rritjen e kapaciteteve të NVM-ve	Emri i projektit 1.5.1.2 Hartimi i programit dhe zbatimi i trajnimeve mbi përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe njohja me standardet ISO
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Cilësia është një ndër avantazhet më të forta konkurruese të një biznesi. "Të shpenzosh për cilësinë nuk është aspak kosto; përkundrazi, është një investim fitimprurës në terma afatgjatë për një firmë". Shpesh është vënë re se bizneset abuzojnë në aspektin e cilësisë për të përfituar sa më tepër dhe jo pak herë këtyre bizneseve u është dashur të përballen edhe me pasoja shkatërruese, deri në falimentim. Nga ana tjetër, cilësia dhe standardet e lidhura me të, në ditët e sotme, paraqiten si avantazhe që biznese të caktuara shfrytëzojnë për t'u futur në tregje të reja apo për të zgjeruar ato ekzistuese. Ky projekt synon të rrisë ndërgjegjësimin si të bizneseve për hapësirat e reja që mund t'u krijohen përmes futjes së procedurave ISO ashtu dhe të institucioneve publike përgjegjëse për kontrollin e cilësisë së produkteve bujqësore. Për këtë qëllim është menduar organizimi i trajnimeve mbi përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe njohjen me standardet ISO. Ky projekt është planifikuar të kalojë përmes hapave të mëposhtme: - Ngritja e grupit trajnues me persona që kanë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme në fushën e Manaxhimit të Cilësisë - Hartimi i një pyetëtori i cili të identifikojë sa më mirë tematikat delikate tek cilësia e produkteve - Informimi i përfaqësuesve të komunitetit të biznesit për temën e trajnimit - Organizimi i trajnimit <ul style="list-style-type: none"> o Ndërgjegjësimi për përfitimet dhe kostot e abuzimit mbi cilësinë e produktit o Njohja me standardet ISO o Rritja e investimit në drejtim të cilësisë së produkteve, produkte më cilësore dhe të sigurta në treg 	
OBJEKTIVAT - Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit tek bizneset mbi avantazhet që ofrojnë standardet ISO - Rritja e kontrollit të cilësisë së produkteve nga organet publike përgjegjëse - Sigurimi i informacionit mbi tregjet ku biznesi shqiptar mund të hyjë	GRUPET E SYNUARA - Komuniteti i Biznesit - Drejtoria e Bujqësisë në Fier - Prodhuesit e produkteve bujqësore - Fermerët në rrethin e Fierit - Konsumatorët
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT - Dhoma e Tregtisë - Drejtoria e Bujqësisë - Shoqata të tjera biznesi - Bashkia	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - Drejtoria e Koordinim-Zhvillimit në bashki - Asistencë financiare nga komuniteti i biznesit - Asistencë teknike dhe financiare nga organizata ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri
BUXHETI I PLANIFIKUAR 1,000 Euro	KOHA E ZBATIMIT Qershor 2006

QËLLIMI 1. Fuqizimi i sektorit privat në Fier me fokus kryesor agrobiznesin dhe turizmin	
OBJEKTIVI 1.5 Të promovohet rritja e numrit të NVM-ve në Fier	
PROGRAMI 1.5.2 Programi për punësim aktiv.	Emri i projektit 1.5.2.4 Projekte lidhur me themelimin e inkubatorëve të biznesit duke përdorur hapësira aktualisht jashtë funksionit të ndërmarrjeve të dikurshme shtetërore ose ish zonave industriale
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Qeverisja vendore e qytetit të Fierit ka trashëguar një hapësirë të mjaftueshme nga zonat industriale dhe ndërmarrjet shtetërore të mëparshme, të cilat aktualisht janë jashtë përdorimit. Qeverisja vendore po planifikon të vërë në përdorim këto zona duke zbatuar një projekt për krijimin e një inkubatori biznesi. Arsyet për krijimin e inkubatorit të biznesit janë: numri në rritje i ndërmarrjeve të reja, krijimi i vendeve të reja të punës, krijimi i kushteve për nisjen e bizneseve të reja, ulja e varfërisë etj. Shërbimet e ofruara nga inkubatori do të përfshijnë një qira nën normën apo çmimin e tregut; telefon, faks, internet dhe shërbim recepsioni; asistencë në berjen e planeve të biznesit, marketing dhe identifikim të investitorëve potencialë; dhe trajnime biznesi dhe menaxhimi. Bashkia do të sigurojë hapësirën për zyrat dhe mbledhjet pa kosto për periudhën e fillimit.	
OBJEKTIVAT - Promovimi i ngritjes së biznesit në sektorin e agrobiznesit dhe turizmit - Ngritja e kujdesit për një mjedis të favorshëm për biznesin - Ulja e normës së papunësisë - Rritja e të ardhurave nga grumbullimi i taksave	GRUPET E SYNUARA - Komuniteti i biznesit - Investitorët - Komuniteti
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT - Bashkia Fier - Organizata të mbështetjes së biznesit - Donatorë ndërkombëtarë	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - Asistencë financiare - Asistencë teknike - Organizma të qeverisë qendrore
BUXHETI I PLANIFIKUAR 120,000 EURO	KOHA E ZBATIMIT 2006-2008

QËLLIMI 1. Fuqizimi i sektorit privat në Fier me fokus kryesor agrobiznesin dhe turizmin	
OBJEKTIVI 1.5 Të promovohet rritja e numrit të NVM-ve në Fier	
PROGRAMI 1.5.3 Programi për krijimin e lehtësirave financiare (kreditimin) e biznesit lokal	Emri i projektit 1.5.3.1 Përgatitja e një broshure informuese mbi shërbimet bankare të ofruara për biznesin privat
PËRSHKRIM I PROJEKTIT <p>Bashkëpunimi publik-privat është një nga fokuset kryesore që orientojnë zbatimin e strategjisë së zhvillimit të qytetit. Në këtë kuadër, krijimi i lehtësirave financiare dhe sigurimi i informacionit mbi shërbimet financiare që ofrohen për biznesin që operon në Fier është një nga projektet konkrete të kësaj strategjie. Më konkretisht, projekti përfshin përgatitjen e një broshure e cila të shërbejë si një përmbledhje e shërbimeve bankare të ofruara për biznesin privat. Në këtë broshurë do të paraqiten të gjitha kushtet që duhet të plotësojë një biznes dhe në të njëjtën kohë edhe shërbimet që mund të sjellë banka në drejtim të biznesit. Një pjesë të madhe në këtë broshurë do ta zërë procesi i kreditimit, duke pasqyruar edhe normat e interesit dhe dukuri të tjera që shoqërojnë këtë proces.</p> <p>Ky projekt vjen në ndihmë të qytetarëve dhe bizneseve të interesuara për të siguruar financim, por edhe në ndihmesë të bankave dhe institucioneve të tjera kredituese, pasi shërbimet e tyre gjejnë hapësira më të mëdha për të arritur palët e interesuara. Hapat nëpër të cilat parashikohet të kalojë ky projekt janë listuar më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i grupit të punës nën udhëheqjen e bashkisë Fier - Mbledhja e informacionit të nevojshëm nga të gjitha institucionet financiare, kryesisht nga bankat - Organizimi i informacionit në mënyrën më të mirë - Botimi i broshurës që të përmbajë këtë informacion - Shpërndarja e broshurës tek biznesi apo personat e interesuar për të bërë biznes 	
OBJEKTIVAT <ul style="list-style-type: none"> - Informimi në mënyrën e duhur dhe dhënia e informacionit të dobishëm - Rritja e bashkëpunimit midis bankës dhe biznesit - Krijimi i lehtësirave për kreditimin e biznesit 	GRUPET E SYNUARA <ul style="list-style-type: none"> - Bizneset ekzistuese - Bizneset e rinj - Institucionet financiare - Bankat
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT <ul style="list-style-type: none"> - Bashkia Fier - Biznese të ndryshme - Bankat dhe institucione financiare kredituese që operojnë në territorin e bashkisë Fier 	KONTRIBUTE TË MUNDSHME <ul style="list-style-type: none"> - Asistencë financiare nga komuniteti i biznesit - Asistencë teknike nga ekspertë lokalë dhe të huaj
BUXHETI I PLANIFIKUAR 200 Euro	KOHA E ZBATIMIT Shkurt – Maj 2006

QËLLIMI 1. Fuqizimi i sektorit privat në Fier me fokus kryesor agrobiznesin dhe turizmin	
OBJEKTIVI 1.5 Të promovohet rritja e numrit në NVM-ve në Fier	
PROGRAMI 1.5.3 Programi për krijimin e lehtësirave financiare (kreditimin) e biznesit lokal.	Emri i projektit 1.5.3.5 Institucionalizimi i forumeve periodike midis institucioneve financiare, komunitetit të biznesit dhe Bashkisë për të përmirësuar shërbimet për biznesin
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Shqipëria është një ekonomi në tranzicion ku tregu i kapitaleve është akoma në embrionin e tij dhe aktivitetet e sipërmarrjes private akoma nuk janë aq tërheqëse sa të ngjallin interesin e investitorëve në financimin e tyre. Ka shumë faktorë të cilët ndikojnë në shkallën e kreditimit të biznesit. N.q.s do të bënim një krahasim për sa i përket shkallës së dhënies së kredive nga bankat, do të shohim se: kredia e dhënë sektorit privat në CEB (vendet e Evropës Qendrore dhe Balltike) është 32.9%; në SEE (Vendet e Evropës Juglindore) 19.8%; ndërsa në Shqipëri më pak se 10%. Duhet theksuar se kjo shkallë e ulët e financimeve nuk është rrjedhojë vetëm e politikave të institucioneve financiare, por edhe aktorëve të tjerë, si edhe e marrëdhënieve të ndërsjellta të tyre. Ky projekt ka për qëllim që të rrisë nivelin e bashkëpunimit midis aktorëve të interesuar përmes ngritjes së një forumi ku do të përfaqësohen institucionet financiare, komuniteti i biznesit dhe bashkia. Tavorinat e rrumbullakëta dhe forma të tjera të organizuara në mënyrë periodike do t'i shërbejnë palëve të interesuara të shprehin idetë, mendimet, eksperiencat dhe problemet që shqetësojnë secilën palë si dhe të ndër marrin inisiativa konkrete. Dialogu, ndërveprimi i ndërsjellë aktiv do të çojnë në marrjen e vendimeve në favor të krijimit të lehtësirave financiare dhe jofinanciare për komunitetin e biznesit dhe rritjen e numrit të NVM-ve në Fier.	
OBJEKTIVAT - Ngritja e forumit me përfaqësues të institucioneve financiare, komunitetit të biznesit dhe bashkisë - Identifikimi i shqetësimeve dhe problemeve të komunitetit të biznesit; - Identifikimi i vështirësive të bankave gjatë procesit të kreditimit; - Përmirësimi i klimës së biznesit në Fier; - Forcimi i bashkëpunimit midis institucioneve publike dhe sektorit privat të biznesit; - Rritja numrit të NVM në Fier	GRUPET E SYNUARA - Komuniteti i Biznesit - Institucionet Financiare që operojnë në territorin e Fierit - Bashkia Fier - Komuniteti i Fierit
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT - Dhoma e Tregtisë - Institucione mbështetëse të biznesit - Bashkia Fier - Drejtoria e Koordinim-Zhvillimit në bashki - Institucione financiare (banka) që operojnë në Fier - Institucione kredituese të tjera - Programe të Komunitetit European për zhvillimin e biznesit	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - Asistencë teknike dhe financiare nga ekspertë vendas dhe institucione kombëtare dhe ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri; - Mbështetje e organizatave të biznesit
BUXHETI I PLANIFIKUAR 1 takim = 150 Euro 1 Vit 500 Euro	KOHA E ZBATIMIT 3 herë në vit, takime 4 mujore Janar - 2006

QËLLIMI 2. Krijimi i kushteve social-ekonomike sa më të favorshme për zhvillimin e mëtejshëm të qytetit të Fierit	
OBJEKTIVI 2.1 Të bëhet zhvillimi i koordinuar i shtrirjes hapësinore dhe numrit të popullsisë së qytetit me zgjerimin e rrjeteve të infrastrukturave inxhinierike dhe sociale.	
PROGRAMI 2.1.1 Programi për ndërhyrje në infrastrukturën fizike bazuar në Planin e Ri të Përgjithshëm Rregullues dhe Planin e Investimeve Kapitale	Emri i projektit 2.1.1.3 Investime në skemën e lëvizjes në qytet dhe në sinjalistikë në mënyrë që të mundësojë përdorimin e biçikletave dhe frekuentimin e lartë këmbësor 2.1.1.4 Investime për përcaktimin e zonës së këmbësorëve të mbështetur nga rrjeti i parkimeve publike 2.1.1.5 Projekt për përmirësimin e transportit urban publik si në drejtim të linjave ashtu edhe të mjeteve të ndryshme sipas flukseve të nevojshme
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Me anë të këtij projekti, që lind si ndërthurje e tre projekteve për sinjalistikën e qytetit, organizimin e parkimeve në qytet dhe përmirësimin e transportit publik, propozohet një strategji afatgjatë, e cila do të integrohet me projektin për sinjalistikën e zonave turistike. Këto projekte janë hartuar duke marrë parasysh karakteristikat e zonës së studimit, të dhëna demografike, të dhëna për shkallën e motorizimit. Gjithashtu, është punuar duke u bazuar në studimet e mëparshme të fushës, rrjetin rrugor urban, skemat përkatëse të studimit, kartografia ekzistuese si dhe grafi i aplikuar për rrjetin rrugor të Fierit. Zgjidhjet e dhëna si pasojë e analizës së ofertave të transportit urban, lëvizjes së këmbësorëve, biçikletave, transportit publik e atij privat, analizat e kërkesës së trafikut aktual, vëzhgimet dhe matjet e realizuara, kërkesat për parkim, kanë vlerësuar ndikimin në mjedis të ndërhyrjeve përkatëse duke dhënë dhe rekomandime. Nëpërmjet realizimit të diagnozës për situatën aktuale dhe perspektivën në transportin urban, këto projekte kanë për qëllim të përpunojnë dhe të konkretizojnë me vizatime sinjalistikën vertikale dhe atë horizontale, kompletimin e hartave të rrjetit rrugor, krijimin e të dhënave bazë për vlerësimin dhe planifikimin e trafikut dhe parkimeve dhe, çfarë është më e rëndësishmja, përmirësimin e kushteve të qarkullimit, lëvizjes dhe qëndrimit në qytetin e Fierit.	
OBJEKTIVAT - Pakësimin e aksidenteve rrugore - Pakësimin e ndotjeve atmosferike - Respektimin e vlerave ambjettale dhe kulturore - Ekonomizimin dhe zvogëlimin e shpenzimeve publike - Shtimin e rrugëve të këmbësorëve dhe biçikletave, në bazë të propozimeve të Planit Rregullues - Zgjidhjen e problemeve të parkimit në qytet	GRUPET E SYNUARA - Komuniteti fierak - Biznesi lokal - Turistët që do të vizitojnë zonat turistike në rrethinat e qytetit - Udhëtarët që kalojnë në qytete të tjera nëpërmjet Fierit
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT - Instituti i studimeve të transportit - Pushteti vendor me sektorët përkatës.	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - Aktivizimi i specialistëve dhe bashkëpunëtorëve më të mirë dhe me përvojë në vend për vlerësimin e trafikut
BUXHETI I PLANIFIKUAR 3,650,000 (Lek)	KOHA E ZBATIMIT 2004-2009

QËLLIMI 2. Krijimi i kushteve social-ekonomike sa më të favorshme për zhvillimin e mëtejshëm të qytetit të Fierit	
OBJEKTIVI 2.1 Të bëhet zhvillimi i koordinuar i shtrirjes hapësinore dhe numrit të popullsisë së qytetit në zgjerimin e rrjeteve të infrastrukturave inxhinierike dhe sociale.	
PROGRAMI 2.1.1 Programi për ndërhyrje në infrastrukturën fizike bazuar në Planin e Ri të Përgjithshëm Rregullues dhe Planin e Investimeve Kapitale	Emri i projektit 2.1.1.7 Zbatimi i projekteve për ndriçimin publik të zonave/bloqeve të banimit
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Sipas studimeve të ndryshme, zonat e pandriçuara janë të prirura të bëhen vatër e dukurive negative të lidhura me kriminalitetin, si p.sh. droga, vjedhje etj. Në të njëjtën kohë këto zona shkaktojnë një gjendje frike e cila ndikon negativisht tek individët dhe tek gjendja psikologjike e tyre. Gjithashtu, ndriçimi ndikon në ecurinë e bizneseve të ndryshme në zona të ndryshme gjatë orëve të vona dhe është një faktor që ndikon në dislokimin e një biznesi. Ky projekt përfshin ndriçimin publik të zonave/bloqeve të banimit. Fillimisht do të bëhet një vëzhgim për identifikimin e zonave/bloqeve të banimit të cilat janë më problematike për sa i përket ndriçimit. Në bazë të këtyre nevojave të shfaqura në zona të ndryshme do të hartohet një plan për rregullimin e situatës. Më pas ky projekt do të vihet në zbatim nga persona përgjegjës të ndërmarrjes së elektrikut duke shtrirë linja në këto zona apo duke investuar në linjat ekzistuese. Në këtë projekt edhe komunitetet e zonave përkatëse mund të bëhen bashkëpunëtorë të projektit duke dhënë kontributin e tyre sado modest. Hapat nëpër të cilat parashikohet të kalojë projekti janë listuar më poshtë: - Identifikimi i zonave/bloqeve të banimit të cilat duhet të ndriçohen - Hartimi i projekteve teknike nga bashkia Fier - Bashkëpunimi i autorëve të projektit me Ndërmarrjen Elektrik, komunitetin dhe bizneset për të dhënë kontribute sado të vogla - Realizimi i projekteve të hartuara për ndriçimin e zonave/bloqeve të banimit që janë identifikuar	
OBJEKTIVAT - Ulja e dukurive negative të lidhura me kriminalitetin - Zhvillimi i bizneseve në këto zona dhe zhvendosja e bizneseve të ndryshme - Gjallërimi i jetës në orët e vona - Ulja e dukurive negative si droga, vjedhja etj.	GRUPET E SYNUARA - Zonat/bloqet e banimit në qytetin e Fierit - Komuniteti i këtyre zonave - Biznese të ndryshme
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT - Bashkia Fier - Biznese të ndryshme - Qytetarët e Fierit - Ndërmarrja Elektrik	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - Pushteti Qendror - Specialistë të bashkisë - Asistencë financiare nga komuniteti i biznesit - Asistencë teknike nga Ndërmarrja Elektrik
BUXHETI I PLANIFIKUAR 350,000 Euro	KOHA E ZBATIMIT Mars – vijim 2006

<p>QËLLIMI 3. Fuqizimi i sistemit të edukimit në të gjitha nivelet duke përfshirë këtu edhe themelimin e një bërthame universitare si elementi më i domosdoshëm për aftësimin e komunitetit dhe ngritjen e qëndrueshme ekonomike dhe sociale</p>	
<p>OBJEKTIVI 3.1 Të rritet cilësia e infrastrukturës fizike të sistemit të arsimit në të gjitha nivelet.</p>	
<p>PROGRAMI 3.1.1 Programe për ndërtimin dhe/ose përmirësimin e infrastrukturës së çerdheve, kopshteve, shkollave 9-vjeçare dhe shkollave të mesme.</p>	<p>Emri i projektit 3.1.1.1 Pajisja e objekteve të arsimit me mjedise me funksion rekreativ (lulishte, kënde lojërash, terrene sportive etj.)</p>
<p>PËRSHKRIM I PROJEKTIT Mjediset me funksion rekreativ janë shumë të rëndësishëm dhe me një ndikim të madh tek fëmijët, pasi i krijojnë atyre mundësinë të shprehin vetveten, të jenë rekreativë, të fitojnë ndjesinë e përkatësisë në një grup shoqëror etj. Të gjitha këto sjellin ndikim të madh si shoqëror ashtu dhe psikologjik dhe, për pasojë, sjellin një ndikim në krijimin e personalitetit të fëmijëve. Një mjedis rekreativ i përshtatshëm me të gjithë elementet e duhur ndihmon një zhvillimin të shëndetshëm si fizik edhe mendor për fëmijët. Ky projekt konsiston pikërisht në krijimin e këtyre kushteve për fëmijët, duke shërbyer për rindërtimin si edhe përmirësimin e infrastrukturës në lidhje me mjediset me funksion rekreativ.</p> <p>Çdo shkollë do të evidentojë kërkesat në lidhje me krijimin e këtyre mjedisëve apo edhe për përmirësimin e mjedisëve ekzistuese. Do të ngrihet një grup i posaçëm i cili do të shyrtojë nga afër gjendjen ekzistuese dhe do të bëjë një paralelizim të kushteve aktuale (sipërfaqja etj.) dhe mundësive për krijimin e mjedisit rekreativ në këto kushte. Për çdo shkollë do të hartohet një projekt i veçantë, lidhur me kushtet, mundësitë dhe shumë faktorë që ndikojnë në realizimin e tij. Për realizimin e projektit do të përfshihen aktorë të ndryshëm të mundshëm.</p>	
<p>OBJEKTIVAT</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studimi i mjedisëve rekreative ekzistuese për çdo objekt edukimi dhe identifikimi i kërkesave në lidhje me këto mjedise - Hartimi i planeve dhe projekteve specifike për çdo objekt edukimi në bashkëpunim me specialistët përkatës - Pajisja e objekteve të edukimit me mjediset me funksion rekreativ - Krijimi i kushteve të përshtatshme rekreative për plotësimin e dëshirave dhe nevojave të fëmijëve - Krijimi i kushteve për zhvillimin si fizik ashtu edhe mendor të fëmijëve 	<p>GRUPET E SYNUARA</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fëmijët e çerdheve e kopshteve - Nxënësit e shkollave 9-vjeçare dhe shkollave të mesme - Institucionet arsimore - Familjet e fëmijëve
<p>AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të gjitha objektet arsimore (çerdhe, kopshte, shkolla 9-vjeçare dhe shkolla të mesme) - Drejtoria Arsimore Rajonale (DAR) - Fëmijët dhe familjet e tyre - Bashkia 	<p>KONTRIBUTE TË MUNDSHME</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ministria e arsimit - Asistencë financiare nga komuniteti i biznesit - Asistencë financiare nga prindërit e fëmijëve, me një kontribut sado modest - Asistencë teknike në disa raste nga vetë fëmijët
<p>BUXHETI I PLANIFIKUAR 100,000 Euro</p>	<p>KOHA E ZBATIMIT 2006 – 2009</p>

QËLLIMI 3. Fuqizimi i sistemit të edukimit në të gjitha nivelet, duke përfshirë këtu edhe themelimin e një bërthame universitare si elementi më i domosdoshëm për aftësimin e komunitetit dhe ngritjen e qëndrueshme ekonomike dhe sociale	
OBJEKTIVI 3.1 Të rritet cilësia e infrastrukturës fizike të sistemit të arsimit në të gjitha nivelet	
PROGRAMI 3.1.1 Programe për ndërtimin dhe/ose përmirësimin e infrastrukturës së çerdheve, kopshteve, shkollave 9-vjeçare dhe shkollave të mesme	Emri i projektit 3.1.1.2 Pajisja e strukturave arsimore ekzistuese me ambientet funksionale të mësimin (laboratore, kabinete etj.)
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Ka shumë elemente të cilët janë të rëndësishëm në procesin e arsimit të fëmijëve. Përveç stafit të kualifikuar dhe efektiv, i cili është kushti primar në këtë proces, një element tjetër i një rëndësie të madhe është edhe ambienti funksional i mësimin, përmendim këtu laboratorët, kabinetet etj. Këto ambiente shërbejnë për plotësimin e kuadrit të mësimin, ndaj mungesa e tyre krijon një pengesë të madhe në realizimin e procesit të mësimdhënies, përvetësimin e koncepteve bazë mësimore si edhe në mosformimin plotësisht të nxënësve në lëndë të veçanta. Ky projekt ka për qëllim pikërisht të eliminojë këtë faktor negativ e pengues për realizimin e planit mësimor dhe të shndërrojë pajisjen me ambientet funksionale të mësimin në një forcë e jo dobësi të çdo institucioni mësimdhënës. Ky projekt do të ndihmojë në realizimin me sukses të procesit të mësimdhënies, duke krijuar kushte lehtësuese si për mësuesit edhe për nxënësit në të njëjtën kohë. Kjo do të sjellë fuqizimin e sistemit të edukimit. Hapat konkrete: - Çdo institucion mësimor do të bëjë një vlerësim paraprak të çdo laboratorit apo kabinetit në zotëron - Pasi të jetë bërë identifikimi i të gjithë bazës ekzistuese, do të listohen të gjitha nevojat për laboratorë dhe kabinete përkatëse; - Kërkesat do t'i komunikohen Drejtorisë Arsimore Rajonale e cila, në bashkëpunim me shkollat përkatëse, do të ndërmarrë realizimin konkret të të gjitha kërkesave dhe nevojave të identifikuara	
OBJEKTIVAT - Identifikimi i kërkesave dhe nevojave për laboratore, kabinete etj. - Hartimi i planeve specifike për çdo objekt arsimor me specialistët përkatës - Pajisja e objekteve arsimore me mjediset e nevojshme funksionale - Krijimi i kushteve të përshtatshme dhe lehtësuese për mësuesit dhe për nxënësit - Mundësi praktike dhe konkretizimi të koncepteve mësimore - Rritje e cilësisë dhe e performancës së procesit mësimor	GRUPET E SYNUARA - Nxënësit e shkollave 9-vjeçare dhe shkollave të mesme - Shkollat - Stafi i mësuesve
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT - Shkollat 9-vjeçare dhe shkollat e mesme - Drejtoria Arsimore Rajonale (DAR) - Fëmijët - Bashkia	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - Ministria e Arsimit - Asistencë financiare nga komuniteti i biznesit - Asistencë financiare nga prindërit e fëmijëve, me një kontribut sado modest - Donatorë
BUXHETI I PLANIFIKUAR 300,000 Euro	KOHA E ZBATIMIT 2006 – 2008

<p>QËLLIMI 3. Fuqizimi i sistemit të edukimit në të gjitha nivelet, duke përfshirë këtu edhe themelimin e një bërthame universitare, si elementi më i domosdoshëm për aftësimin e komunitetit dhe ngritjen e qëndrueshme ekonomike dhe sociale</p>	
<p>OBJEKTIVI 3.2 Të përmirësohen metodologjitë e mësimdhënies në të gjitha nivelet dhe profilet e shkollave bazuar në arritjen e rezultateve: “të mësuarit për jetën”</p>	
<p>PROGRAMI 3.2.1 Programi i integruar për kualifikimin e personelit, përmirësimin e teksteve dhe kurrikulave dhe krijimin e kushteve sa më optimale për nxënësit gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Emri i projektit 3.2.1.7 Të ngrihet një bibliotekë pranë çdo shkolle nëntëvjeçare e të mesme</p>
<p>PËRSHKRIM I PROJEKTIT Një element mjaft i rëndësishëm për sistemin e arsimit është edhe biblioteka. Zotërimi i një biblioteke të pasur, me të gjithë elementet e nevojshëm, përbën një avantazh për sistemin arsimor. Ky projekt synon në ngritjen e bibliotekave bashkëkohore pranë çdo shkolle, e cila do të nxisë nxënësit të lexojnë dhe të fitojnë më shumë dije dhe do të ndihmojë në realizimin më të mirë të procesit mësimor, duke rritur cilësitë e kushteve të realizimit të planit mësimor.</p> <p>Hapat konkrete përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Çdo shkollë do të vlerësojë gjendjen ekzistuese të bibliotekës, duke bërë një inventar për të gjithë librat që ka biblioteka - Do të evidentohen kërkesat me librat përkatës të lëndëve të ndryshme dhe librat jashtëshkollorë të niveleve përkatëse të nxënësve - Pasurimin me libra të bibliotekave dhe ngritjen dhe pajisjen e ambientit fizik me tavolina dhe karrige 	
<p>OBJEKTIVAT</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i situatës së bibliotekave në çdo shkollë dhe raportimi i kërkesave për pasurimin e bibliotekave - Ngritja e mjedisit të bibliotekës ku nxënësit mund të lexojnë - Nxitja e nxënësve për të lexuar sa më shumë duke krijuar kushte për informimin e tyre në fusha të ndryshme - Përmirësimi i metodologjisë së mësimdhënies - Kushte të favorshme për realizimin me sukses të planit mësimor - Kushte më optimale, mundësi për rritje të efikasitetit dhe administrim më i mirë i kohës - Fuqizim i sistemit të arsimit 	<p>GRUPET E SYNUARA</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit e shkollave 9-vjeçare - Nxënësit e shkollave të mesme - Mësuesit e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme - Shoqëria, komuniteti
<p>AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkollat 9-vjeçare dhe shkollat e mesme - DAR (Drejtoria Arsimore Rajonale) - Ministria e Arsimit 	<p>KONTRIBUTE TË MUNDSHME</p> <ul style="list-style-type: none"> - Qeverisja qendrore - Bashkia - Asistencë financiare nga komuniteti i biznesit - Familjet e nxënësve
<p>BUXHETI I PLANIFIKUAR 150,000 Euro</p>	<p>KOHA E ZBATIMIT 2006 -2008</p>

QËLLIMI 3. Fuqizimi i sistemit të edukimit në të gjitha nivelet duke përfshirë këtu edhe themelimin e një bërthame universitare, si elementi më i domosdoshëm për aftësimin e komunitetit dhe ngritjen e qëndrueshme ekonomike dhe sociale	
OBJEKTIVI 3.2 Të përmirësohen metodologjitë e mësimdhënies në të gjitha nivelet dhe profilet e shkollave bazuar në arritjen e rezultateve: “të mësuarit për jetën”.	
PROGRAMI 3.2.2 Programi i integruar për nxitjen e arsimit të mesëm profesional dhe për krijimin e lidhjeve të ngushta ndërmjet arsimit të mesëm profesional dhe atij të lartë profesional.	Emri i projektit 3.2.2.5 Krijimi i lidhjeve mes biznesit lokal dhe shkollave profesionale duke mundësuar që nxënësit e këtyre shkollave të kryejnë praktikën pranë bizneseve vendase (Murialdo, Qendra e re e Aftësimit Profesional – nga Zyra e Punës)
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Praktika si një element shumë i rëndësishëm për konkretizimin e teorisë shërben për të plotësuar formimin e nxënësve në fushat përkatëse të studimit të tyre. Ky projekt ka për qëllim sigurimin e kryerjes së praktikës për nxënës të shkollave profesionale. Zyra e Punës do të jetë aktori kryesor i cili do të organizojë dhe bëjë të mundur praktikën, duke ndërmjetësuar nxënësit dhe bizneset apo institucionet ku do të jetë e mundur kryerja e praktikës. Projekti do të jetë i vlefshëm për të dyja palët: studentët do të konkretizojnë konceptet mësimore, duke sjellë njohuri dhe ide praktike në shkolla, dhe firmat do të mund të identifikojnë studentë të aftë për t'i punësuar pa qenë nevoja të ndjekin procedura më të zgjata për rekrutimin e tyre. Hapa konkrete: - Kontaktimi nga Zyra e punës e përfaqësuesve të shkollave profesionale, p.sh. Murialdo. - Përcaktimi nga shkolla i fushave të praktikës dhe numrit të nxënësve në fushat përkatëse. Përcaktimi i afatit kohor për kryerjen e praktikës. - Kontaktimi nga Zyra e punës i bizneseve apo institucioneve të mundshme për kryerjen e praktikës	
OBJEKTIVAT - Ndërtimi në Zyrën e Punës i një funksioni negociues me bizneset dhe institucione të tjera për realizimin e praktikës në mjediset e tyre nga studentët të shkollave profesionale - Përvetësimi nga afër në praktikë i koncepteve mësimore nëpërmjet kryerjes së praktikës nga studentët - Përfitimi dhe sigurimi i një krahu më të aftë pune për biznesin - Fuqizimi i sistemit të arsimit - Nxitja e marrëdhënieve me përfitim të ndërsjellë ndërmjet shkollave dhe bizneseve	GRUPET E SYNUARA - Nxënësit e shkollave profesionale (Murialdo) - Staf i mësuesve - Komuniteti i biznesit - Institucione të ndryshme
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT - Shkollat profesionale (Murialdo) - Zyra e Punës - Bizneset - Institucionet e ndryshme	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - Pushteti vendor - Specialistë të bashkisë - Asistencë financiare dhe teknike nga komuniteti i biznesit
BUXHETI I PLANIFIKUAR 4,000 Euro	KOHA E ZBATIMIT Janar – vijim 2006

<p>QËLLIMI 3. Fuqizimi i sistemit të edukimit në të gjitha nivelet, duke përfshirë këtu edhe themelimin e një bërthame universitare, si elementi më i domosdoshëm për aftësimin e komunitetit dhe ngritjen e qëndrueshmërisë ekonomike dhe sociale</p>	
<p>OBJEKTIVI 1.4 Të investohet në infrastrukturën fizike për ngritjen e Universitetit të qytetit të Fierit me qëllim krijimin e një tradite në këtë fushë.</p>	
<p>PROGRAMI 3.4.1 Programi për ngritjen e një kampusi universitar.</p>	<p>Emri i projektit 3.4.1.1 Studim mbi kapacitetin e nevojshëm të universitetit të Fierit dhe perspektivën e zhvillimit të tij 3.4.1.2 Studim i detajuar për ngritjen e kampusit universitar bazuar në përcaktimet e planit rregullues</p>
<p>PËRSHKRIM I PROJEKTIT Tradita dhe niveli i lartë i arsimit në Fier përbëjnë themelet për zhvillimin e sistemit arsimor të qytetit. Prirjet e arsimit tregojnë që ka një rritje të rëndësishme të numrit të njerëzve me arsim fillor. Në të njëjtën kohë, ka një rritje në numrin e nxënësve që mbarojnë shkollën e mesme dhe që diplomohen në Universitete. Duke pasur si qëllim përgjigjen e kërkesave në rritje për arsim, institucionalizimi i sipërmarrjeve dhe sigurimi i një rrjedhe të qëndrueshme të ideve për një kampus universitar publik konsiderohen jetikë për të kontribuar në zhvillimin me mbështetje për të gjithë qarkun e Fierit.</p> <p>Një iniciativë e tillë kërkon investime mbështetëse, kështu që Bashkia e Fierit në lidhje me institucione të tjera qendrore i jep një rëndësi të madhe bërjes së një studimi paraprak mbi opsionet e mundshme të realizimit, i cili do të lejojë në një fazë të mëvonshme mobilizimin e fondeve. Ky projekt do të mbledhë të dhëna nga kërkesa aktuale dhe e ardhshme për arsimin nga qarku, si dhe të dhëna lidhur me hapjen e degëve potenciale që mund të krijojnë një sinergji me vizionin për zhvillimin e Fierit dhe të qarkut. Në lidhje me këtë, projekti do të marrë në konsideratë opsione të ndryshme të vendosjes së kampusit universitar, në mënyrë të tillë që të sigurojë mundësi hyrjeje për të gjithë dhe të rrisë zhvillimin social dhe ekonomik të Fierit.</p>	
<p>OBJEKTIVAT</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të kontibuojë në zhvillimin mbështetës për Fierin dhe qarkun - Të përmirësohet infrastruktura fizike dhe e dobët e arsimit - Për të institucionalizuar sipërmarrjet dhe sigurimuar një rrjedhë të ideve të reja 	<p>GRUPET E SYNUARA</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuniteti i qytetit dhe rajonit të Fierit - Komuniteti i biznesit që operon në qytet dhe qark - Institucionet arsimore në Fier dhe në qark
<p>AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bashkia Fier - Qarku i Fierit - Ministria e Arsimit - Komuniteti i biznesit - Donatorë ndërkombëtarë 	<p>KONTRIBUTE TË MUNDSHME</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komuniteti i biznesit në Fier dhe në Qark - NGO-të lokale - Asistencë teknike e siguruar nga ekspertë lokalë
<p>BUXHETI I PLANIFIKUAR 30,000 EURO</p>	<p>KOHA E ZBATIMIT 2005-2006</p>

QËLLIMI 4. Rikonceptimi i mënyrës së menaxhimit të territorit në Bashkinë Fier bazuar në pjesëmarrjen demokratike dhe transparente të gjithë aktorëve të fushës së zhvillimit me qëllim kryesor zhvillimin ekonomik të qytetit.	
OBJEKTIVI 4.8 Të përmirësohet infrastruktura fizike (rrugë, telekomunikacion etj.) për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, nxitjen e biznesit dhe të një transporti publik sa më lehtësues për qytetarët.	
PROGRAMI 4.8.2 Programi për përmirësim në infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e biznesit.	Emri i projektit 4.8.2.5 Investime fizike për përmirësimin e infrastrukturës së telekomunikacionit dhe përhapjen e gjerë të internetit në territorin e Bashkisë
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Informacioni është një ndër elementet më të rëndësishëm në ecurinë dhe realizimin me sukses të strategjisë së zhvillimit të qytetit. Informacioni bëhet tepër i rëndësishëm sidomos për punët krijuese dhe punët ku shkalla e novacioneve është e lartë. Ky projekt synon të përmirësojë infrastrukturën e telekomunikacionit dhe përhapjen e internetit në mjediset e Bashkisë Fier. Pasi të bëhet identifikimi i nevojave të çdo zyre do të ndërmerren të gjitha veprimet me hapat përkatëse për ta realizuar të gjithë projektin. Ky investim do të ndikojë në arritjen e objektivave të vendosura, në mbajtjen e lidhjeve me organizata, institucione e biznese të ndryshme. Do të arrihet që të sigurohet informacioni i nevojshëm në një shkallë të lartë saktësie dhe për një kohë të shkurtër. Kjo do të kontribuojë në përmirësimin e infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e bizneseve, të cilët do të kenë një mënyrë më tepër efektive dhe efçente të komunikimit me Bashkinë. Hapat nëpër të cilat parashikohet të kalojë ky projekt janë listuar më poshtë: - Analizë dhe identifikim i nevojave për shërbim telekomunikimi dhe internet në çdo zyrë në përputhje me qëllimet dhe veprimtarinë e zyrës - Përgatitja e projektit teknik - Përmirësimi i infrastrukturës së nevojshme fizike - Vendosja e linjave telefonike kombëtare dhe ndërkombëtare në zyrat ku është e domosdoshme - Vendosja e një linje satelitore interneti dhe shpërndarje e internetit në çdo zyrë	
OBJEKTIVAT - Rritja e kapaciteteve të specialistëve të Bashkisë Fier - Përmirësimi i mënyrës së komunikimit dhe rritje e saktësisë së informacionit të siguruar - Sigurimi i informacioneve të freskëta dhe në kohë të shkurtër - Vendosja e më tepër kontakteve me organizata, institucione dhe biznese të ndryshme	GRUPET E SYNUARA - Zyrat e Bashkisë Fier - Institucione bashkëpunëtoare me Bashkinë Fier
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT - Bashkia Fier - Specialistë të Bashkisë - Organizata të zhvillimit që mund të sigurojnë asistencë teknike dhe financiare për zbatimin e projektit - Albtelekom	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - Donatorë - Projekte të tjera për përmirësimin e aksesit të informimit dhe komunikimit në bashki
BUXHETI I PLANIFIKUAR 10,000 Euro	KOHA E ZBATIMIT Shkurt – Maj 2006

QËLLIMI 5. Përmirësimi i cilësisë së jetesës nëpërmjet garantimit të një mjedisi të pastër	
OBJEKTIVI 5.1 Të garantohet niveli i ndotësve të mjedisit urban brenda standardeve të përcaktuara	
PROGRAMI 5.1.1. Të sigurohen të dhëna reale aktuale për nivelin e ndotësve	Emri i projektit 5.1.1.1 Sigurimi i ngritjes dhe funksionimit të qendrës monitoruese të ndotësve të ajrit, ujit dhe tokës
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Aktualisht në Fier nuk ekziston një qendër monitorimi për mjedisin. Të dhënat që disponohen mbi gjendjen e elementeve përbërës të mjedisit janë të pamjaftueshme dhe sporadike. Që të mund të ndërtohet një politikë mjedisore që garanton një zhvillim të qëndrueshëm duke respektuar mjedisin, është e domosdoshme ekzistenca e strukturës fizike që mundëson monitorimin e treguesve mjedisorë. Kryerja e monitorimit lejon vlerësimin e respektimin e standardeve dhe aplikimin e politikave të nevojshme. Ngritja e strukturës monitoruese presupozon paisjen me aparaturat e nevojshme dhe personelin e kualifikuar për regjistrimin dhe interpretimin e të dhënave. Në këtë strukturë parashikohet të përfaqësohen institucionet publike lokale dhe qendrore si dhe përfaqësues të komunitetit, për vetë rëndësinë që kjo çështje ka në jetën e përditshme të qytetarëve fierakë. Hapat që parashikohet të kryhen brenda këtij projekti janë listuar më poshtë: - Ngritja e strukturës monitoruese - Evidentimi i aktorëve ndotës më të rëndësishëm - Garantimi i stafit të specializuar - Ndërtimi i stacionit monitorues të pajisur me aparaturat rilevuese të nivelit të ndotësve - Përgatitja periodike e raporteve mbi gjendjen e mjedisit - Informimi i publikut mbi gjendjen e mjedisit dhe sensibilizimi i tij mbi rreziqet që i kanosen	
OBJEKTIVAT: - Ulja e nivelit të ndotësve në qytetin e Fierit dhe përmirësimi i ambjentit - Përmirësimi i cilësisë së jetës për banorët e qytetit të Fierit	GRUPET E SYNUARA - Komuniteti fierak, - OJQ lokale, - Komuniteti i biznesit, - Intelektuale të ndryshëm - ARM Agjensia Rajonale e Mjedisit - Pushteti lokal
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT - Bashkia Fier - ARM - QKSHHK - Drejtoria e shëndetit parësor - OJQ Ambientaliste lokale - Komuniteti	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - Ministria e Mjedisit - Pushteti lokal - Donatorë të ndryshëm
BUXHETI I PLANIFIKUAR 10,000 Euro	KOHA E ZBATIMIT Janar-Qershor 2006

QËLLIMI 5. Përmirësimi i cilësisë së jetesës nëpërmjet garantimit të një mjedisi të pastër	
OBJEKTIVI 5.1 Të garantohet niveli i ndotësve të mjedisit urban brenda standardeve të përcaktuara	
PROGRAMI 5.1.1. Të sigurohen të dhëna reale aktuale për nivelin e ndotësve	Emri i projektit 5.1.1.3 Lobing pranë qeverisë për t'u imponuar kompanive Albpetrol, Armo dhe TEC respektimin e normave ligjore mbi mbrojtjen e mjedisit
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Projekti konsiston në ndërmarrjen e një fushate sensibilizuese intensive, nëpërmjet mediave lokale dhe kombëtare, e cila prek gjendjen mjedisore të rënduar për shkak të derdhjes së ujërave të patrajtuar paraprakisht në lumin Gjanica dhe kolektorin Rroskovec-Hoxhare, dhe prej këtej në lumin Seman e Detin Adriatik. Gjithashtu, kjo fushatë sensibilizuese do të rrisë ndërgjegjësimin e grupeve të interesit mbi dëmet që i shkaktohen shëndetit të komunitetit të zonës së përshkuar, rrjetit hidrografik të sipërpërmendur, faunës dhe florës të këtyre zonave si edhe asaj të basenit të Adriatikut. Hapat që parashikohen të kryhen brenda këtij projekti janë: - Të organizohen manifestime proteste në Fier dhe në zonën e prekur më rëndë nga ndotjet e Gjanicës - Të evidentohet dëmi ekonomik i shkaktuar fermerëve të zonës dhe biznesit në tërësi nga moszhvillimi i turizmit në bregdetin e Semanit për shkak të ndotësve hidrokarburë të pranishëm aty - Të bashkërendohen veprimet e bashkive dhe të komunave të interesuara të qarkut dhe prefekturës, Ministrisë së Mjedisit, ARM, OJQ-ve lokale, komunitetit të biznesit, deputetëve përfaqësues të këtyre zonave dhe shoqërisë civile. - Të ngrihet një komitet ndërinstitucional me pjesëmarrës të shoqërisë civile e komunitetit që të jetë përçues i këtyre shqetësimeve pranë qeverisë duke insistuar deri në një zgjidhje racionale të problemit dhe në zbatimin e parimit "Kush dëmton, paguan".	
OBJEKTIVAT - Të arrihet një shkallë ndërgjegjësimi e komunitetit që të sjellë optimizëm për mundësinë e përmirësimit të mjedisit në Fier - Të organizohet bashkërendimi i punës midis institucioneve shtetërore, OJQ-ve dhe shoqërisë civile për ngritjen e Komitetit të shpëtimit të Gjanicës - Realizimi i manifestimit të protestës për të garantuar të drejtën e të jetuarit në një ambient të pastër dhe të shëndetshëm	GRUPET E SYNUARA - Komuniteti i Fierit - Biznesi lokal - Fermerët e zonës - Turistët që do të frekuentojnë bregdetin fierak
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT - Bashkia, Qarku dhe Prefektura - OJQ - Ministria e Mjedisit - ARM - Alb-petrol - Armo - TEC - Komuniteti i Fierit	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - OJF-të me asistencë teknike dhe financiare - Asistencë financiare nga komuniteti i biznesit - Asistencë teknike nga komuniteti i Fierit Donatorë të ndryshëm
BUXHETI I PLANIFIKUAR 1,500 Euro	KOHA E ZBATIMIT 2006

QËLLIMI 5. Përmirësimi i cilësisë së jetesës nëpërmjet garantimit të një mjedisi të pastër	
OBJEKTIVI 5.1 Të garantohet niveli i ndotësve të mjedisit urban brenda standardeve të përcaktuara	
PROGRAMI 5.1.2 Parandalimi i ndotjeve të tokës, ujit, ajrit	Emri i projektit 5.1.2.8 Ndërtimi, për lagjet "11 Janari" dhe "1 Maj", i kolektorit të ujërave të zeza urbane që aktualisht derdhen në lumin Gjanica
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Duke pasur parasysh se zhvillimi i turizmit detar është konsideruar si një nga potencialet strategjike për zhvillimin socioekonomik të Fierit dhe se aktualisht turizmi pengohet për shkak të ndotjes së zonës bregdetare të Semanit, del domosdoshmëri trajtimi i ujërave të zeza para derdhjes në det. Hapi i parë për trajtimin e ujërave të zeza është ndërtimi i kanaleve kolektore që mundëson konfluencën e tyre në një pikë të vetme ku do të ndërtohet impianti pastrues. Ngritja e kolektorit në fjalë mundëson kapjen dhe dërgimin në pikën e përpunimit të ujërave të zeza të lagjeve që derdhen në lumin Gjanica. Ky projekt do të mundësojë edhe përmirësimin e kushteve ekologjike të lumit Gjanica dhe Seman, gjë kjo e cila do të ketë impakt pozitiv në gjallërimin e jetës së lumit. Hapat që parashikohet të kryhen janë listuar më poshtë: - Hartimi i projektit teknik në Bashkinë Fier në bashkëpunim dhe me komunat që mbulojnë hapësirat ku do të kryhet investimi - Ndërtimi i 4 km kanal përgjatë bregut të lumit deri në pikën e takimit me kolektorët ekzistues - Lidhja me këtë kolektor e ujërave të zeza të lagjes "1 Maj" kodra, duke ndërtuar disa kanale furnizues që përshkojnë lumin në pikat më të përshtatshme (urat)	
OBJEKTIVAT - Eliminimi total i ndotjeve të Gjanicës nga ujërat e zeza në këtë sektor - Promovimi i turizmit në Fier dhe rrethinat e tij	GRUPET E SYNUARA - Komuniteti i Fierit - Biznesi lokal - Turistët që do të frekuentojnë bregdetin fierak
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT - Drejtoria e Shërbimeve, Bashkia Fier - OJQ-të - ARM - Komuniteti i lagjeve të sipërpërmendura - Komuniteti i zonës përgjatë lumit Gjanica	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - OJF-të me asistencë teknike dhe financiare - Asistencë financiare nga komuniteti i biznesit - Asistencë teknike nga komuniteti i Fierit - Donatorë të ndryshëm - Pushteti qendror
BUXHETI I PLANIFIKUAR 400,000 Euro	KOHA E ZBATIMIT 2006 – 2007

QËLLIMI 5. Përmirësimi i cilësisë së banimit nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së mjedisit brenda dhe jashtë qytetit të Fierit	
OBJEKTIVI 5.1 Të garantohet niveli i ndotësve të mjedisit urban brenda standardeve të përcaktuara	
PROGRAMI 5.1.3 Programi për rekuperimin e Gjanicës	Emri i projektit 5.1.3.1 Pastrimi i ujërave nga shkarkimet industriale
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Projekti synon të largojë mbetjet e naftës si fazë e lirë (nafta jo e tretur në ujë, por që noton në sipërfaqen e ujit) nga ujërat e lumit Gjanica. Projekti konsiston në ndërtimin e një barriere betoni mbi lumë në një pozicion të përshtatshëm, që do të mundësojë krijimin e një rezervati dhe ku të mund të realizohet diferencimi gravitacional i fazës së naftës në sipërfaqe. Kjo shtresë e sipërme mund të largohet me anë të një mekanizmi (<i>trailer-boom</i>), që do të mundësonte kapjen e rreth 60,000 litra naftë në vit. Kjo sasi mund të përdoret në Rafinerinë e Fierit. Ky projekt do të kthejë Gjanicën në një element rikreativ dhe në shërbim të qytetit.	
OBJEKTIVAT - Përmirësimi i kushteve mjedisore të qytetit të Fierit dhe rrethinave deri në det - Rigjallërimi i faunës dhe florës në lumin Gjanica dhe përmirësimi i kushteve ekologjike në detin Adriatik - Rikthimi i plazhit të Semanit në kushte optimale nga pikëpamja e ndotjeve për të qenë sa më tërheqës për pushuesit vendas dhe të huaj - Mundësimi i aktiviteteve të biznesit në plazhin e Semanit. - Përmirësimi i biznesit agrar (agrobiznesit) të fermerëve të zonës që do të furnizojë hotelet që do të ngrihen përgjatë plazhit të Semanit.	GRUPET E SYNUARA - Flora dhe fauna e lumit dhe detit adriatik - Turistët që do frekuentojnë plazhin afërsisht 200,000 - Fermërat e zonës së fushave afërsisht 45,000 - Komuniteti Fierak afërsisht 100,000
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT - Pushteti vendor - Komuniteti - Biznesi lokal - Ministria e Mjedisit - Ministria e Energjitikës - Donatorë të huaj	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - OJQ lokale - Shoqata e Ndërtuesve Fier - Albpetrol - Specialistë vendas dhe të huaj të fushës së trajtimit të ujërave
BUXHETI I PLANIFIKUAR 2,000,000 Euro	KOHA E ZBATIMIT Mars 2006-Prill 2007

QËLLIMI 5. Përmirësimi i cilësisë së banimit nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së mjedisit brenda dhe jashtë qytetit të Fierit	
OBJEKTIVI 5.1 Të garantohet niveli i ndotësve të mjedisit urban brenda standardeve të përcaktuara	
PROGRAMI 5.1.3 Programi për rekuperimin e Gjanicës	Emri i projektit 5.1.3.4 Pastrimi i lumit nga mbetjet inerte dhe sistemimi i shpateve
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Lumi i Gjanicës, që nga viti 1982 e deri më sot, në mënyrë të herëpashershme ka dalë nga shtrati duke shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale e ambientale në qytetin tonë. Një nga shkaqet është krijimi i barrierave artificiale nga shkarkimet abuzive të materialeve në lumë, krahas fenomenit të shkarjeve që formojnë ngushtime të seksionit të tij. Për pasojë, në kohë reshesh anormale ndodh përmbytja e disa zonave të qytetit deri në kuotën 16 metra. Projekti synon pikërisht eliminimin e këtyre pengesave dhe garantimin e përcjellshmërisë së lumit duke parandaluar këtë rrezik kaq të madh për jetën e qytetarëve fierakë. Pjesë e këtij projekti është heqja e mbetjeve të ngurta me mjete të mekanizuara, duke i siguruar lumit dimensionin natyral të tij. Gjithashtu, do të sistemohen skarpitetet e lumit duke i betonuar sipas rasteve dhe rrezikshmërisë që paraqesin.	
OBJEKTIVAT - Të pastrohet shtrati dhe shpatet e lumit nga mbeturinat inerte dhe urbane të hedhura abuzivisht në të - Të rishikohen shpatet e lumit duke eliminuar ngushtimet e ndodhura për efekt të shkarjeve të dherave - Sigurimi i shpateve me mure mbajtëse apo veshje betoni për të parandaluar fenomenin e erozionit dhe shembjeve në sektorë të caktuar të tij gjatë intinerarit që përshkon qytetin deri në grykëderdhje	GRUPET E SYNUARA - Komuniteti i Fierit që jeton rreth lumit - Bizneset e ndryshme që zhvillojnë aktivitetin në zonat pranë lumit - Sektori i ndërtimit - Shkollat që gjenden në afërsi të lumit
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT - Bashkia Fier - Drejtorja e Rajonale e Ujërave - Grupe biznesi - Shoqata e Ndërtuesve Fier - Donatorë - Qeveria	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - OJQ lokale - Shoqata e Ndërtuesve Fier - Albpetrol - Specialistë vendas dhe të huaj të fushës së trajtimit të ujërave, ndërtimit, gjelbërimit, hidroteknikës - Bizneset lokale - Ministria e Energjitikës - Ministria e Mjedisit
BUXHETI I PLANIFIKUAR 4,500,000 Euro	KOHA E ZBATIMIT Janar 2006 - 2008

QËLLIMI 5. Përmirësimi i cilësisë së banimit nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së mjedisit brenda dhe jashtë qytetit të Fierit	
OBJEKTIVI 5.1 Të garantohet niveli i ndotësve të mjedisit urban brenda standardeve të përcaktuara	
PROGRAMI 5.1.3 Programi për rekuperimin e Gjanicës	Emri i projektit 5.1.3.4 Veshja e brigjeve të Gjanicës me gjelbërim 5.1.3.6 Krijimi i zonave rekreative dhe sportive përgjatë shtratis të lumit
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Projekti konsiston në gjelbërimin e pjesës së sipërme të lumit Gjanica me bar e pemë dekorative, duke krijuar kështu një zonë atraktive por dhe mjaft të rëndësishme për pastrimin e ajrit. Vendosja e 4-5 urave për këmbësorë mbi lumë do të kontribuojë në aktivizimin e zonës përreth lumit si dhe të lehtësojë lëvizjen për këmbësoret dhe biçikletat që do të ngrihen në sektorët më të përshtatshëm të spondeve. Vendosja e stolave gjatë shëtitores me disa pika shërbimi dhe kende lojërash do t'ia plotësojë vlerat si park rikreativ për banorët e Fierit. Si pjesë e projektit për krijimin e hapësirave rekreative të reja në qytet si dhe të shtimit të sipërfaqeve të gjelbërimit mund të përmendet: <ul style="list-style-type: none"> - Mbjellja afërsisht e 1,500 fidanëve pemë (shelgje, eukalips) - Mbjellja e afërsisht 40,000 m² sipërfaqe me bar - Ndërtimi i 4 km piste për këmbësorë dhe biçikleta, afërsisht 1.5 km gjerësi e shtruar me beton - Ndërtimi i 5 urave lidhëse të brigjeve afërsisht 2 metra të gjerë me strukturë metalike - Vendosja e afërsisht 200 stolave përgjatë pistës 	
OBJEKTIVAT <ul style="list-style-type: none"> - Të krijohet një mjedis çlodhës/argëtues dhe tërheqës për qytetarët - Të rritet sipërfaqja e gjelbër në qytet duke pakësuar sasinë e ndotjes së ajrit - Të ulet ndotja e ujit të lumit Gjanica 	GRUPET E SYNUARA <ul style="list-style-type: none"> - Fëmijët e qytetit - Pensionistët - Komuniteti i Fierit - Biznesmenë të ndryshëm
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT <ul style="list-style-type: none"> - Bashkia - Ndërmarrja e gjelbërimit - Biznese të ndryshme - Donatorët 	KONTRIBUTE TË MUNDSHME <ul style="list-style-type: none"> - OJQ lokale - Shoqata e Ndërtuesve Fier - Specialistë vendas dhe të huaj të fushës së ndërtimit e gjelbërimit - Ministria e Mjedisit
BUXHETI I PLANIFIKUAR 2,500,000 Euro	KOHA E ZBATIMIT Janar 2007 - 2009

QËLLIMI 5. Përmirësimi i cilësisë së jetesës nëpërmjet garantimit të një mjedisi të pastër.	
OBJEKTIVI 5.2 Të rritet sipërfaqja e gjelbër e qytetit nëpërmjet ritrajtimit të hapësirave aktualisht të lira ose të pashfrytëzuara si edhe krijimi i zonave të gjelbra rreth qytetit.	
PROGRAMI 5.2.1 Plani i ri Rregullues i Qytetit	Emri i projektit 5.2.1.2 Ndërtimi i një parku të ri të gjelbër të qytetit
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Aktualisht në Fier nuk ekziston një park urban. Ky projekt konsiston pikërisht në plotësimin e kësaj nevoje duke ndërtuar një park të madh urban në qytetin e Fierit. Së pari, do të përcaktohet pozicioni i dislokimit të parkut. Më pas do të bëhet një studim projektimi për detajimin e brendshëm të parkut ku do të përcaktohen sasia dhe llojet e drurëve, sipërfaqet e mbjella me bar, vendosja e këndeve sportive, rrugicave, stolave dhe bizneseve të ndryshme në shërbim të qytetareve. Ky park do t'i shërbejë përmirësimit të gjendjes së mjedisit, duke funksionuar si një mushkëri e gjelbër për qytetin e Fierit. Parku do të ketë ndikim edhe në përmirësimin e jetës ekonomike dhe sociale. Përveç funksionit çlodhës për qytetarët fierakë, parku do të jetë edhe një mundësi më shumë për zhvillimin e biznesit (fast-food, bar, biznese ambulante etj.). Ndikimi do të jetë edhe në gjallërimin e jetës sociale duke krijuar mundësi për ushtrimin e aktiviteteve të ndryshme sportive dhe kulturore. Impakti pozitiv do të jetë shumë i ndjeshëm veçanërisht për moshën e tretë dhe fëmijët.	
OBJEKTIVAT - Të rritet sipërfaqja e gjelbër në qytet duke arritur nivelin 4-5 m ² /banor - Të përmirësohet ndjeshëm cilësia e ajrit - Të zbuten efektet negative që vijnë nga industria - Krijimi i mundësisë për përmirësim të jetës sportive dhe kulturore - Gjallërimi i jetës sociale - Mundësi për zhvillimin e biznesit	GRUPET E SYNUARA - Fëmijët - Brezi i tretë - Komuniteti i Fierit - Komuniteti i biznesit
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT - Specialistë të bashkisë - Nxënësit e shkollave - Brezi i tretë - Ndërmarrjet e gjelbërimit - OJQ - Komuniteti i biznesit	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - OJF-të me asistencë teknike dhe financiare - Asistencë financiare nga komuniteti i biznesit - Asistencë teknike nga komuniteti i Fierit - Donatorë të ndryshëm - Pushteti qendror
BUXHETI I PLANIFIKUAR 50,000 Euro	KOHA E ZBATIMIT 2006 - 2009

QËLLIMI 6. Rikonceptimi i punës së administratës së bashkisë duke vënë në themel të shërbimeve konsiderimin e “qytetarit-klient”	
OBJEKTIVI 6.1 Të fuqizohen në mënyrë strategjike kapacitetet e burimeve njerëzore në bashki në mënyrë që t’i përgjigjen realizimit të vizionit për të ardhmen e qytetit	
PROGRAMI 6.1.1 Programi për rritjen e kapaciteteve lokale.	Emri i projektit 6.1.1.1 Vlerësimi i nevojave për trajnim
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Hartimi dhe zbatimi i strategjisë së zhvillimit të qytetit shtron si sfidë për administratën e Bashkisë rritjen e kapaciteteve në mënyrë që t’i përgjigjet në kohë dhe me efikasitet realizimit të vizionit dhe objektivave strategjike. Në këtë mënyrë mendimi strategjik në administratën bashkiake duhet të zëvendësojë kryerjen me urgjencë të ndryshimeve që vullshëm po shoqërojnë zhvillimin në Shqipëri. Ky mendim strategjik, i përkthyer në rritjen e aftësive dhe në një performancë më të lartë të burimeve njerëzore, do t’i bëjë punonjësit më efektivë e eficientë në realizimin e detyrave të tyre. Në të njëjtën kohë kjo gjë ndikon edhe në rritjen e shkallës së kënaqësisë dhe rrjedhimisht të motivimit të tyre në punë. Ky projekt ka për qëllim identifikimin e vështirësive dhe sfidave që dalin për zbatimin e strategjisë dhe përshtatjen e tyre me metodat e reja në vendin e tyre të punës. Një grup pune do të formulojë një pyetësor për të matur nevojat e ndryshme për trajnim të stafit. Rezultatet e marra nga ky pyetësor do të jenë subjekt diskutimi me të gjithë stafin e bashkisë, nga ku do të hartohet dhe politika e rritjes së kapaciteteve bashkiake si dhe një plan veprimi për arritjen e këtij objekti. Hapat që parashikohen të kryhen për realizimin e këtij projekti janë listuar më poshtë: - Ngritja e grupit të punës me specialistë të Bashkisë - Hartimi i pyetësorit - Grumbullimi dhe analiza e të gjithë informacionit - Identifikimi i nevojave për trajnim - Hartimi i planit të veprimit për kryerjen e trajnimeve - Përpilimi i një dokumenti i cili të ketë të detajuar punonjësit, aftësitë dhe njohuritë e tyre, detyrat konkrete dhe aftësitë dhe njohuritë që kërkon realizimi më i mirë i projektit, dhe rrjedhimisht nevojat për trajnim - Detajimi i trajnimeve dhe përgatitja e kurrikulave përmes asistencës teknike nga organizata zhvillimi lokale dhe të huaja - Aplikimi për mbulimin e kostove nga organizata zhvillimi lokale dhe të huaja	
OBJEKTIVAT - Rritja e kapaciteteve të administratës lokale të Bashkisë Fier - Zbatimi i Strategjisë së Zhvillimit	GRUPET E SYNUARA - Punonjësit e Bashkisë, që nga nivelet e larta e deri tek specialistët e thjeshtë
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT - Grupi i punës me specialistë të burimeve njerëzore - Seksioni i Programim Zhvillimit dhe Marrëdhëniet me jashtë - Punonjësit e bashkisë, nga nivelet e larta e deri tek specialistët - Organizata të ndryshme trajnimesh	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - Asistencë teknike nga eksperte lokale dhe të huaj - Asistencë financiare e teknike nga organizata të ndryshme që operojnë në këtë fushë
BUXHETI I PLANIFIKUAR (Për t’u përcaktuar nga punonjësit e Bashkisë)	KOHA E ZBATIMIT Janar – Prill 2006

QËLLIMI 6. Rikonceptimi i punës së administratës së bashkisë duke vënë në themel të shërbimeve konsiderimin e “qytetarit-klient”	
OBJEKTIVI 6.1 Të fuqizohen në mënyrë strategjike kapacitetet e burimeve njerëzore në bashki në mënyrë që t'i përgjigjen realizimit të vizionit për të ardhmen e qytetit	
PROGRAMI 6.1.1 Programi për rritjen e kapaciteteve lokale	Emri i projektit 6.1.1.2 Kryerja e trajnimeve të stafit bashkiak mbi konceptet e aplikuar të ZHEL 6.1.1.3 Trajnim i stafit bashkiak në shkrimin e projekt propozimeve 6.1.1.4 Kryerja e trajnimeve për stafin bashkiak dhe sektorin privat mbi Partneritetet Publike-Private 6.1.1.5 Trajnim i stafit bashkiak në menaxhim projektesh dhe në aftësitë menaxheriale
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Nga puna e deritashme për hartimin e strategjisë së zhvillimit të qytetit, është identifikuar nevoja për rritjen e kapaciteteve të specialistëve bashkiakë në fushat e zbatimit të koncepteve të zhvillimit ekonomik lokal, shkrimit të projekt-propozimeve, partneriteteve publike-private (PPP), menaxhimit të projekteve dhe afësive menaxheriale. Për realizimin e procedurës së trajnimeve do të angazhohet Zyra e Programim-Zhvillimit dhe ajo e Marrëdhënieve me Jashtë. Kjo zyrë do të aplikojë aty ku është e nevojshme, do të kontaktojë me organizata të ndryshme dhe do të ndjekë të gjitha procedurat formale të nevojshme deri në realizimin e trajnimeve. Hapat nëpër të cilat parashikohet të kalojë projekti janë listuar më poshtë: - Aplikimi për trajnim në organizata të ndryshme në bazë të nevojave të identifikuara - Zgjedhja optimale e organizatës apo trajnuesve me të cilët do të bashkëpunohet - Vendosja e punonjësve në ato grupe trajnimesh ku ata kanë nevojë dhe ku ky trajnim përbën një element të rëndësishëm në realizimin e detyrave të tyre - Përgatitja e kurrikulave në përputhje me kërkesat dhe nevojat e identifikuara - Kryerja e trajnimeve	
OBJEKTIVAT - Rritje e njohurive dhe e aftësive të punonjësve - Rritje e motivimit të punonjësve - Arritje më e mirë e objektivave të vendosura në çdo zyrë apo sektor - Rritje e efektivitetit dhe e efijencës në punë - Rritje e kapacitetit të burimeve njerëzore - Bashkëpunim dhe lehtësi edhe në marrëdhënie me institucione dhe biznese	GRUPET E SYNUARA - Punonjësit e bashkisë, që nga nivelet e larta e deri tek specialistët e thjeshtë - Qytetarët që do të kenë marrëdhënie me këta punonjës - Bizneset në bashkëpunim me Bashkinë
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT - Bashkia Fier - Specialistë të burimeve njerëzore - Seksioni i Programim-Zhvillimit, Punonjësit e Bashkisë, nga nivelet e larta e deri tek specialistët - Organizata të ndryshme trajnimesh	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - Qeverisja lokale - Specialistë të bashkisë - Asistencë financiare e teknike nga organizata të ndryshme që operojnë në këtë fushë - Asistencë financiare nga komuniteti i biznesit
BUXHETI I PLANIFIKUAR 2,000 Euro	KOHA E ZBATIMIT 2006

QËLLIMI 6. Rikonceptimi i punës së administratës së bashkisë duke vënë në themel të shërbimeve konsiderimin e “qytetarit-klient”	
OBJEKTIVI 6.2 Të nxitet sigurimi i shërbimit cilësor ndaj qytetarëve dhe biznesit dhe të ulet ndikimi i bizneseve informale në ekonominë lokale	
PROGRAMI 6.2.1 Programi për përmirësimin e shërbimeve administrative	Emri i projektit 6.2.1.5 Instalimi i zyrës me një ndalesë në bashki për biznesin “One-Stop Shop”
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Marrëdhëniet dhe kontaktet e pamjaftueshme midis Bashkisë dhe sektorit privat dhe niveli jo i duhur, ka sjellë kërkesën për krijimin e një klime partneriteti midis qeverisjes lokale dhe sektorit të biznesit lokal. Qëllimi i këtij projekti është ngritja e Zyrës me një ndalesë “One-Stop Shop”, e cila do të ofrojë shërbime profesionale për biznesin e vogël dhe të mesëm në menaxhim, financë, marketing dhe menaxhim të burimeve njerëzore. Të gjithë të interesuarit do të kenë mundësinë të marrin informacionin dhe asistencën e duhur për eliminimin e burokracive administrative për liçensimin e bizneseve dhe pagimin e taksave. “One-Stop Shop” do t’u japë asistencë menaxherëve të biznesit në planifikim, do të organizojë trajnime, do të mbështesë komunitetin e biznesit nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta, tryezave të rrumbullakta, konferencave, me përkrahjen e administratës lokale. Si fillim, kostot e kësaj zyre do të mbulohen nga fondi i buxhetit të Bashkisë ose nga donatorë të huaj. “One-Stop Shop” do të bashkëpunojë ngushtësisht me OJF lokale në këshillimin e biznesit si dhe me sektorin bankar, për të arritur në vetëfinancimin e saj nëpërmjet organizimit të seminareve dhe trajnimeve. Ngritja e kësaj strukture do të jetë një faktor mjaft pozitiv dhe përkrahës në mjedisin e biznesit lokal. Impakti i pritsëm kohor afatgjatë do të jetë një numër më i lartë të punësuarish, një ekonomi më e mirë dhe të ardhura lokale më të larta. Realizimi i këtij projekti kërkon ndërhyrje në godinën e Bashkisë dhe një sistem të ri informatizimi, si dhe trajnimin e stafit të Bashkisë.	
OBJEKTIVAT - Sigurimi i një shërbimi më të shpejtë dhe më cilësor për qytetarët dhe biznesin - Përmirësimi i klimës së biznesit duke siguruar shërbime administrative me efikasë për biznesin - Marrëdhënie më të mira ndërmjet administratës vendore dhe biznesit si klient - Rritja e numrit të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme të biznesit duke siguruar asistencë teknike në menaxhim biznesi	GRUPET E SYNUARA - Qeverisja vendore - Investitorë potencialë, njerëz që dëshirojnë të krijojnë biznese të reja, me mundësi financiare të mjaftueshme por pa ide të qarta - Organizata në mbështetje të biznesit dhe komunitetit
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT - Bashkia - Dhoma e Tregtisë - Shoqata të tjera biznesi - Agjencia Rajonale e Zhvillimit - Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave - Organizata ndërkombëtare - Programe të Komunitetit European për zhvillimin e biznesit	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - Grupi i Zhvillimit Ekonomik Lokal në Bashki - Sektori Bankar
BUXHETI I PLANIFIKUAR 20,000 EURO	KOHA E ZBATIMIT 1 vit, 2005-2006

QËLLIMI 6. Rikonceptimi i punës së administratës së bashkisë duke vënë në themel të shërbimeve konsiderimin e “qytetarit-klient”	
OBJEKTIVI 6.2 Të nxitet sigurimi i shërbimit cilësor ndaj qytetarëve dhe biznesit dhe të ulet ndikimi i bizneseve informale në ekonominë lokale	
PROGRAMI 6.2.1 Programi për përmirësimin e shërbimeve administrative	Emri i projektit 6.2.1.8 Ngritja e Zyrës për shërbimin e qytetarëve
PËRSHKRIM I PROJEKTIT Pesë punonjës nga stafi i administratës së Bashkisë do të japin informacionet për regjistrimin dhe liçensimin e biznesit. Kjo zyrë do të shpërndajë informacion për ndryshimet që kanë të bëjnë me legjislacionin, vendimet e Këshillit Bashkiak, vendimet e KRRT dhe procedurat administrative në institucionet e tjera (procedurat e mbledhjes së taksave, kërkesat për VNM, MKZ). Kjo zyrë do të japë të gjithë informacionin që kërkohet nga investitorët e mundshëm, dhe do të presë gjithashtu ankesat që kanë çdo ditë qytetarët e Fierit. Të gjitha shërbimet që ofrohen nga kjo zyrë do të jenë falas. Për realizimin e këtij projekti do të kërkohen ndërhyrje në godinën e Bashkisë dhe një sistem i ri informatizimi si edhe ndërhyrje në trajnimin e stafit të bashkisë.	
OBJEKTIVAT - Rritje e cilësisë së shërbimeve profesionale që bashkia i ofron komunitetit, biznesit dhe OJF-ve - Përmirësimi i marrëdhënieve midis administratës lokale dhe qytetarëve - Shërbime më të shpejta dhe më cilësore të ofruara nga stafi i Bashkisë - Përmirësim i klimës së biznesit duke rritur investimet e brendshme - Rritje e numrit të bizneseve (akses më të shpejtë dhe më të lehtë drejt informacionit) - Krijimi i një baze të dhënash për mbledhjen e taksave në Bashki - Përmirësim i imazhit të Bashkisë	GRUPET E SYNUARA - Qeverisja lokale: administrata - Komuniteti i biznesit - Qytetarët - OJF-të
AKTORË TË PËRFSHIRË DIREKT - Dhoma e Tregtisë - Shoqata të tjera biznesi - Bashkia - Agjensia Rajonale e Zhvillimit - Sektori Bankar - Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave - Organizata ndërkombëtare - Programe të Komunitetit European për zhvillimin e biznesit	KONTRIBUTE TË MUNDSHME - Qeverisja lokale - Asistencë financiare - Mbështetje financiare e drejtpërdrejtë dhe mbështetje politike - Asistencë teknike - Mbështetje e organizatave të biznesit
BUXHETI I PLANIFIKUAR 6,000 Euro	KOHA E ZBATIMIT 2006

EPILOG:

Procesi i Hartimit të Strategjisë dhe Vazhdimësia

Cikle të Reja Energjie

“Qyteti Im, Shtëpia Ime”

Hartimi i strategjisë së zhvillimit të qytetit të Fierit është rezultat i një procesi lokal në të cilin kanë kontribuar një numër i madh pjesëmarrësish. Vullneti dhe roli udhëheqës i Kryetarit të Bashkisë si dhe angazhimi i Këshillit Bashkiak të Fierit kanë luajtur një rol vendimtar në ndërmarrjen e inisiativës dhe fillimin e këtij procesi. Ky angazhim u konkretizua në ngritjen e Grupit të Menaxhimit të Programit të Zhvillimit të Qytetit (GMPZHQ) në Bashki, me funksion koordinimin e procesit dhe nën drejtimin e Kryetarit të Bashkisë. Në fazën fillestare u zhvilluan seanca trajnimesh dhe takimesh pune të përbashkëta me të gjithë stafin drejtues të administratës së bashkisë.

Por, sfida kryesore në pikënisje të procesit ishte se si do të mund të zgjohej interesimi dhe ndërgjegjja kolektive qytetare si dhe të afroreshin mijëra banorët dhe grupet e ndryshme të interesit në qytet për të kontribuar me pjesëmarrjen e tyre në hartimin e strategjisë?

Mekanizmi i pjesëmarrjes

Me qëllim për të gjetur angazhimin e grupeve të interesit dhe qytetarëve në përgjithësi, në fillim të procesit u organizua një cikël i parë takimesh në të cilin u përfshinë gjerësisht përfaqësues nga institucionet publike, biznesi, organizata aktive të shoqërisë civile dhe nga ana tjetër komuniteti i banorëve të qytetit. Nëpërmjet këtyre takimeve u bë e mundur që të informoheshin dhe sensibilizoheshin grupet e interesit dhe komuniteti, të arrihej në një përcaktim të përbashkët të prioritetëve të strategjisë, si dhe të arrihej në gjetjen e angazhimit të pjesëmarrësve në përputhje me rolet e tyre të mundshme.

Ky angazhim për bashkëpunim i pjesëmarrësve u përshtat me kontekstin social dhe institucional në Fier, duke marrë formën e mekanizmit organizativ të paraqitur në Figurën 51. Ky mekanizëm u formalizua nëpërmjet Këshillit Bashkiak, ndërkohë që institucioni i Bashkisë dhe Kryetari i Bashkisë luajtën një rol udhëheqës në procesin e operacionalizimit të tij. Ngritja e mekanizmit dhe strukturave të grupeve të punës

ishte hapi i parë kryesor i cili i hapi rrugën vazhdimit të fazave të mëtejshme të hartimit të strategjisë.

Figura 51: Paraqitja skematike e mekanizmit institucional në Bashkinë Fier

Skema është strukturuar dhe funksionon mbi bazën e katër prioritetëve të strategjisë: zhvillimi urban, zhvillimi ekonomik, mjedisi dhe arsimit dhe kultura. Pjesëmarrës në proces janë institucionet e ndryshme në Fier në nivel vendor dhe qendror si Qarku, Prefektura, përfaqësues të strukturave të tjera qeveritare në nivelin rajonal, bizneset nga sektori privat, organizatat dhe shoqatat joqeveritare si dhe komuniteti. Hartimi i strategjisë është rezultat i bashkëveprimit të këtyre aktorëve, të grupuar në grupe pune (tematike) rreth katër prioritetëve të mësipërme, përfaqësimi dhe kontributi i të cilëve është konkretizuar nëpërmjet takimeve të vazhdueshme në disa nivele sipas hapave të strategjisë. Procesi u zbatua përgjatë një harku kohor rreth 2 vjet, në koordinim me drejtoritë e Bashkisë dhe Njësinë e Koordinimit.

Përgjatë fazës së grumbullimit të të dhënave, takimet u zhvilluan në nivelin e “bërthamave koordinatorë” dhe më pas u kryen takime konsultimi në një rreth më të gjerë të specialistëve më me zë të qytetit të quajtur “grupet e kampioneve”. Nga këto takime u arrit në një vlerësim të gjendjes ekzistuese të qytetit dhe përgatitjen e një profili paraprak të qytetit. Takimet e mëtejshme të këtyre strukturave vijuan me diskutimin për identifikimin e problematikave dhe potencialeve të zhvillimit për secilën fushë, deri në formulimin e një vizioni paraprak, si dhe skenarëve zhvillimit. Ndërkohë, krahas diskutimeve në nivel grupesh/bërthamash tematike, gjatë kësaj periudhe u ndërmorën një seri intervistash në terren, si për shembull me përfaqësues në sektorin privat me qëllim për të plotësuar dhe njohur më nga afër problematikën e sektorëve të veçantë.

Pas konkluzioneve të arritura nga puna e bërthamave dhe grupeve tematike, hapi tjetër i rëndësishëm ishte prioritarizimi i problematikave dhe potencialeve si dhe përcaktimi i ndërhyrjeve konkrete. Gjatë kësaj faze u zhvilluan dy takime të rëndësishme: takimi i përgjithshëm në nivelin e drejtorëve të Bashkisë dhe takimi në nivelin e Komisionit të Koordinimit. Në takimin me drejtoritë e Bashkisë të cilat ishin koordinatorë të grupeve tematike, u rishikuan dhe prioritarizuan problematikat dhe potencialet e identifikuar sipas katër fushave të strategjisë dhe, bazuar mbi këto, u përcaktuan paraprakisht ndërhyrjet në periudhen afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë për secilën fushë.

Diskutimi përfundimtar dhe votimi i ndërhyrjeve konkrete për të katër fushat tematike të strategjisë, lidhur me përfshirjen e tyre në projekt-buxhetet e Bashkisë, u realizua në një rreth më të gjerë në takimin e Komisionit të Koordinimit. Në takim morën pjesë spe-

cialistë pjesëmarrës në grupet tematike, specialistë të tjerë vendorë, anëtarë të këshillit bashkiak, përfaqësues të shoqërisë civile, të institucioneve kryesore të qytetit, të sektorit bankar, të biznesit vendas dhe të komunitetit.

Momenti kulmor në procesin e hartimit të strategjisë ishte organizimi i takimit të Forumit Qytetar. Nga diskutimi i hapur në këtë takim, me pjesëmarrjen më të gjerë të mundshme, u arrit në marrjen e një mendimi dhe konsensusi më të përgjithshëm qytetar mbi vizionin dhe prioritetet e paraqitura të strategjisë së zhvillimit.

Një rol të rëndësishëm që prej fillimit të hartimit të strategjisë ka luajtur gjithashtu komponenti i komunikimit dhe informimit. Për këtë qëllim, njësisia e koordinimit përgatiti në fillim të procesit një strategji (platformë) komunikimi. Përgjatë zbatimit të procesit, sipas fazave të caktuara, janë përdorur mjete dhe forma komunikimi dhe informimi të larmishme. Ndër to vlen të përmenden posterat tematikë mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në hartimin e strategjisë, debatet dhe kronikat e vazhdueshme televizive dhe spotet televizive informative. Me një rëndësi të veçantë ishte java e ekzpozimit publik të strategjisë, duke përfshirë edhe planin rregullues.

Konsiderata të mëtejshme

Tashmë Bashkia Fier zotëron një strategji zhvillimi për qytetin të hartuar nëpërmjet një procesi intensiv planifikimi strategjik me pjesëmarrjen e palëve të interesuara. Bashkia ka hedhur në këtë mënyrë një hap të ri të rëndësishëm përpara dhe përvoja e grumbulluar është mjaft e vlefshme për të vazhduar më tej me

zbatimin e strategjisë. Është pikërisht mekanizmi organizativ me strukturat e ngritura i cili përbën "bërthamën katalizatore të energjisë", që do të mund të krijojë cikle të mëtejshme energjie për zhvillim të mëtejshëm.

Por, sikurse në fillim të hartimit të strategjisë, sërisht shtrohen sfida të reja që lidhen me zbatueshmërinë e kësaj strategjie: si do të mund të garantohet vazhdimësia e strategjisë dhe ato synime të përgjithshme që mishëron hartimi i saj të parashtruara në hyrje të këtij dokumenti? Megjithatë, baza të shëndosha janë hedhur tashmë nëpërmjet procesit të zhvilluar për hartimin e strategjisë, sepse në themel të tij qëndrojnë disa veçori dhe vlera të reja që garantojnë për më tej, si më poshtë:

- **leadership:** angazhimi aktiv në krye të këtij procesi i institucionit të bashkisë, në mënyrë të veçantë i Kryetarit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak nëpërmjet mbështetjes politike, përbën një faktor kyç për vazhdimësinë e strategjisë.

- **legjitimitet:** mbështetja e siguruar e gjerë, mbarëqytetare, politike dhe institucionale nga të gjithë grupet e interesuara që veprojnë në territorin e qytetit të Fierit, nëpërmjet një përfaqësimi institucional dhe mbi baza vullnetare, ka kontribuar në ndërtimin e një strategjie sa më të drejtë dhe të zbatueshme për të gjithë.

- **partneritet:** zhvillimi i procesit ka kontribuar për hapjen e institucionit të Bashkisë ndaj një mentaliteti bashkëpunimi dhe partneriteti gjithnjë e më të madh dhe efektiv me sektorin publik, sektorin privat dhe me komunitetin. Kjo klimë e pozitive është një element kyç për të zgjeruar financimin e strategjisë. Ky ndërveprim ka rritur klimën e mirëbesimit dhe transparencës dhe presionin pozitiv ndërmjet palëve, të nevojshme këto për vazhdimësinë e realizimit të strategjisë.

Kjo strategji ka hyrë tashmë në rrugën e sigurt të zbatimit. Janë disa projekte pilot, të përzgjedhura nga portofoli i projekteve, të cilat kanë hyrë në rrugën e zbatimit të tyre. Së fundmi, nëpërmjet monitorimit dhe rishikimit të vazhdueshëm të strategjisë për ndryshime konstruktive, do të sigurohet që strategjia të gjejë rrugën më të mirë të zbatimit.

Takimet për ngritjen e grupeve tematike – Qershor 2004



Pamje nga Forumi Qytetar – Dhjetor 2005



Pamje nga ekspozita e planit – Dhjetor 2005

Figura 1: Analiza e Ndikimeve të Fuqive, Mundësive, Dobësi dhe Kërcënimeve të Qytetit të Fierit (SWOT)



ANALIZA SWOT PER QYTETIN E FIERIT		
FAKTORE	TË BRENDSHËM	
		<ul style="list-style-type: none"> • Traditë në zhvillimin e ndërmarrjeve të bashëguara nga sistemi komunist • Mangësia e biznesit privat në njohjen menaxhimin e ndërmarrjeve dhe aftësitë
POZITIVË	FUQITË	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesë njohurish, kapacitetesh dhe pushteti vendor dhe sektori privat në zonën e Myzeqesë • Pozicioni i favorshëm gjeografik i qytetit si një kryesore për rrjetin e transportit rrugor dhe hekurudhor kombëtar • Shfrytëzimi i akseve rrugore si pjesë lidhëse me rrugët kryesore nacionale • Prania e Lumit Gjanica dhe hapësirës përgjatë tij si potencial “social-ambiental” i qytetit • Gjendja e mirë dhe teknologjia moderne e telefonisë fikse dhe celulare • Zona industriale të braktisura me infrastrukturë fizike ekzistuese për zhvillimin e biznesit • Prania e hapësirave ende të lira në qendër të qytetit dhe dendësia relativisht e ulët e ndërtimit në zonat periferike • Prania e skeletit rrugor dhe hapësirave potenciale për vazhdimin e tij • Tregtia, si një biznes shumë i suksesshëm në qytetin e Fierit • Klimë e përshtatshme për zhvillimin e agrobiznesit • Potencial dhe kërkesë e lartë për zhvillimin e sektorit të ndërtimit • Afërsia e qytetit me vende të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve argëtuese dhe zhvillimin e turizmit detar, historik, kulturor dhe natyror • Prania e rrjetit hekurudhor • Prania e industrisë së lehtë përpunuese, ushqimore • Popullsia e re në moshë dhe aktive për punë • Prania e institucioneve arsimore parauniversitare publike dhe private • Institucione shtetërore dhe organizata joqeveritare që mbështesin arsimimin dhe kualifikimin e burimeve njerëzore • Rend publik i vendosur dhe nivel i ulët kriminaliteti • Nivel i kënaqshëm pjesëmarrjeje i grupeve të interesit që operojnë në Fier në hartimin e strategjisë së zhvillimit të qytetit • Prania e institucioneve trajnuese dhe kërkimore dhe institucioneve financiare në qytet në mbështetje të zhvillimit të biznesit • Hartimi i dokumentave afatgjatë për zhvillimin e qytetit dhe rregullues, zhvillimi ekonomik, mjedisi dhe arsimit & kultura
		<ul style="list-style-type: none"> • Mungesë njohurish, kapacitetesh dhe njohurisë së punës në sektorin e turizmit • Mungesa e rrjetit të organizuar të se • Nivel i lartë i ndotjes së mjedisit në • Degradimi i “fashës lumore të Gjan
NEGATIVË	DOBËSITË	

QËLLIMI	OBJEKTIVI	PROGRAMI	PROJEKTI
Nr. 1	Fuqizimi i sektorit privat në Fier me fokus kryesor agrobiznesi		

/ HAPA KONKRETË
n dhe turizmin